

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti V (XIX) - Nr. 18 (171) ISSN: 2305-655X

SHKENCA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

18

2017

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI V (XIX) 2017, NR. 18 (171)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2017

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI V (XIX), janar, shkurt, mars 2017 nr. 18 (171)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Ayhan Tekines, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazim, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Dr. Adem Balaban, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti Bedër
Dr. Xhemal Seferti, Jordani
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Kopliku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Sekretar organizativ: Hysni Skura

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Pamje e xhamisë Fatih në kalanë “Rozafa” Shkodër. Foto Sh. Pici, 1928.

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Rr. “G. W. Bush”, Nr. 50, Tiranë

Web: www.zaninalte.al

Mail: info@zaninalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Tradita e mevludit të myslimanët
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë5
2. Meditimi, rruga ndriçuese e besimit në Zot
Dorian Demetja, KMSH18

Studime

3. Kurora mbi krye të përunjur
Fatos A. Kopliku, MS/MA, Washington, DC26
4. Të krishterët! Reflektimi i një myslimani në kohë të trazuar!
Ilir Akshija, M.D., M.Sc39
5. Ekstremizmi midis paragjykitimit dhe stigmatizimit
Doc. Dr. Faredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup53

Gjuhë-Letërsi

6. Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur'anit në Gjuhën Shqipe
Mr. Elez Ismaili, Shkup59

Histori

7. Raporti mes shtypit dhe pushtetit në Shqipëri: miratimi i ligjit osman të shtypit në vitin 1922
Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA70

Jurisprudencë Islame

8. Mbikëqyrja fetare ose Ihtisabi ndaj prindërve – rregullat dhe etika - II
Dr. Sedat Islami, Prishtinë83

Sociologji

9. Për fe dhe atdhe: argumentet e klerit mysliman në debatin mbi modernizimin e Shqipërisë në vitet 20-30

Dr. Enis Sulstarova, Universiteti i Tiranës96

Personalitete

10. Sheuqet Muka109

Retrospektivë

11. Përse studjuesit e dituris e formojnë shumicën e atyne që dyshojnë dhe hezitojnë në çashtje fetare?

H. Ismet Dibra115

12. Abstracts in English121

13. Rregullat e shkrimit128



Tradita e mevludit te myslimanët

Prof. Dr. Qazim Qazimi

Abstrakt

Është realitet i pamohueshëm se festimi i mevludit, ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), nuk ndodhi në kohën e Pejgamberit (a.s.). Madje, ky festim nuk është bërë, as në kohën e Sahabëve, as të Tabiinëve, por as në kohën e Tabi-tabiinëve nuk ndodhi festimi i mevludit në format të cilat i gjejmë dhe i praktikojnë sot myslimanët anë e kënd botës.

Dijetarët myslimanë thonë se: Në këtë natë është e pëlqyeshme të madhërohet Allahu, të këndohen salavate, të jepet sadaka, të bëhen punë të mira etj. Nëse këto punë bëhen për hir të Allahut (sh. sh.), atëherë sevapi është i madh.

Mesazhi i kësaj feste në Përkujtimin e Lindjes së Pejgamberit të fundit, Muhamedit (a.s.), do të ishte: Kthejuni fesë tuaj, burimeve themelore të saj, Kur'anit, haditheve të Muhamedit (a.s.), por edhe traditës sonë të lavdishme, për derisa nuk bie ndesh me principet substanciale islame, sepse aty është shpëtimi ynë, se aty është e ardhmja e këtij populli, se aty është lumturia.

Në historinë e lavdishme të Islamit, është i njohur përkushtimi, nderi e respekti që kanë shprehur besimtarët ndaj Pejgamberit të tyre Muhamedit (a.s.), që në ditët e para, në kohën e sahateve, e në vazhdimësi deri në ditët e sotme. Mënyra e shfaqjes së dashurisë ndaj

Pejgamberit (a.s.), ndër breza, është bërë në forma e trajta të ndryshme. Kronistët shprehën dhe regjistruan me respekt dhe dashuri jetën dhe biografinë e Pejgamberit Muhamed (a.s.) Mjeshtrit e penës, poetët, thurën vargje në prozë e poezi; letrarët shkruan poema, e ode; ulemaja ligjëruan po edhe varguan

kaside, ilahi e mevlude kushtuar jetës, veprës së ndritshme dhe mrekullive të Pejgamberit tonë të fundit, Muhamedit (a.s.)

Dihet mirëfilli nga praktika, por edhe nga tradita shumë shekulle, se mevludi është festë fetare e gjithë myslimanëve, pra edhe te shqiptarët, dhe kremtohet e festohet në çdo përvjetor të Lindjes së Muhamedit (a.s.) Thënë ndryshe, mevludi është historia e lindjes dhe biografia e Muhamedit (a.s.) e thurur në vargje.

Allahu (xh.sh.), përmes Kur'anit, foli, cilësoi, përshkroi atributet, mrekullitë e Pejgamberit, duke e ngritur në piedestalin më të lartë personalitetin e Pejgamberit Muhamed. Madje, ligjërimi kur'anor do të bëhet burimi kryesor dhe pikë rrëfimi për gjithë ata që patën vullnet e dëshirë, që, përmes fjalës së bukur artistike, të shprehin lavdërime për Pejgamberin (a.s.).

Çfarë thuhet në Kur'an për Pejgamberin Muhamed (a.s.)

Duhet ditur se, për lindjen dhe pejgamberinë e Muhamedit (a.s.), ka pasur paralajmërime edhe në librat e shenjta, si në "Inxhilë"- (Bibël), por edhe arabët idhujtarë kanë pasur parandjenja për ardhjen e një Pejgamberi nga mesi i tyre.¹ Në Kur'an shprehimisht thuhet:

1. Shakir El-Bedrij, "Edh-dhikra El-Halidetu li En-Nebijji El-Halidi", botoi "Daru El-Basri", Bagdad, 1969 m - (1388 h.), f. 11.

﴿وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدُ﴾

"Dhe, (kujto) kur tha Isai, biri i Mejremes: O izraelitë, vërtet unë jam i dërguari i All-llabut tek ju për ta vërtetuar Tevratin që ka ardhur para meje dhe për të ju përgëzuar për një pejgamber që do të vijë pas meje, emri i të cilit do të jetë Ahmed (Muhammed)."²

Kështu përgëzoi Isai (a.s.) në "Inxhil"- (Bibël), për ardhjen e Muhamedit (a.s.). Kështu po paralajmërohej lindja e Pejgamberit, për të cilin ndihej nevojë shumë e madhe. Ishte ajo koha e ardhjes së Pejgamberit, për të cilin kishin paralajmëruar edhe pejgamberët e mëparshëm. Thënia e Isait u vërtetua dhe paralajmërimi u realizua me lindjen e Muhamedit (a.s.), për të cilin në Kur'an u tha:

﴿لَقَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ إِذْ بَعَثَ فِيهِمْ رَسُولًا مِنْ أَنْفُسِهِمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِهِ وَيُزَكِّيهِمْ وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَإِنْ كَانُوا مِنْ قَبْلُ لَفِي ضَلَالٍ مُبِينٍ﴾

"Vërtetë All-llahu u ka dhënë besimtarëve një dhuratë të madhe kur u solli një të dërguar nga mesi i tyre i cili ua lexon shpalljet e Tij i pastron nga gjynahet dhe u mëson librin (Kur'anin) e urtësinë edhe pse më parë ata ishin në rrugë të gabuar".³

Pra, dhurata e madhe që iu bëri Krijuesi i Gjithësisë besimtarëve ishte dërgimi i Pejgamberit të fundit, një personalitet që nuk ishte i panjohur për rrethin ku jetonte. Ai ishte nga

2. Kur'ani, sureja Es-Saf, ajeti 6.

3. Kur'ani, sureja Al 'Imran, ajeti 164

mesi i tyre. Ai ishte njeriu që kishte lindur, rritur e edukuar në mesin e tyre. Dhe s'do mend se, kjo që po ndodhte në këtë mënyrë, nuk ishte rastësi, por një premtim që po bëhej realitet dhe po vinte nga mëshira e të Gjithëmëshirshmit:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ﴾

“Dhe Ne nuk të dërguam ty (Muhamed ndryshe) vetëm mëshirë për të gjithë botët”.⁴

Pra dërgimi i Muhamedit (a.s.) ishte nga mëshira e të Gjithëmëshirshmit për njerëzinë, por ardhja e Pejgambrit (a.s.) është edhe pasqyrim dhe realizim i duasë së Ibrahimit (a.s.), nga gjenealogjia e të cilit lindën, erdhën dhe u shpallën tre pejgamberët e feve monoteiste; Musai, të cilit i zbriti Tevrati (Tora), Isai, të cilit i zbriti Inxhili (Bibla) dhe Muhamedit (a.s.), të cilit i zbriti Kur'ani në të cilin gjejmë duanë e Ibrahimit (a.s.) kur ishte lutur:

﴿رَبَّنَا وَابْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ يَتْلُو عَلَيْهِمْ آيَاتِكَ

وَيُعَلِّمُهُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَيُزَكِّيهِمْ﴾

“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre një të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë”.⁵

Në një transmetim të Imam Ahmedit thuhet se, i Dërguari i Allahut (a.s.), është prononcuar vetë për lindjen e tij: *“Unë tek All-llahu kam qenë i dërguari i fundit, kur Ademi ka qenë në procesin e krijimit nga dhen, ndërsa për këtë do t'ju lajmëroj. Me të vërtetë unë jam rezultat i duasë së*

Ibrahimit, njoftimit përgëzues të Isait, (a.s.), dhe pamjes (ruë'ja) të cilën e ka parë nëna ime, sepse nënat e pejgamberëve kanë pasur të shikuar.”

Hasan ibni Thabiti [poet i pranuar nga vetë Muhamedi (a.s.)] thotë: “Kur kisha shtatë apo tetë vjet, aq sa kam mundur të kuptoj dhe të mbaj mend gjithë ato që dëgjoja, në një mëngjes kam dëgjuar një hebre duke thirrur me zë: “O Kurejshitë, a ka lindur mbrëmë ndonjë fëmijë tek ju? I janë përgjigjur: ‘Nuk e dimë’. Hebreu thotë: “... Dëgjoni mirë o Kurejshitë! Sonte tek ju ka lindur Pejgamberi i fundit në botë... Në mes të shpatullave të tij ka një shenjë të zezë, e ajo është vula e tij pejgamberike. Verifikoni, se me të vërtetë në këtë natë ka lindur i dërguari i fundit i këtij umeti.”⁶

Komentatori i Kur'anit, Hafidh Ibni Kethiri, në veprën e tij kapitale “*El-Bidaje ve En-Nihaje* ” ka shkruar një kapitull të veçantë mbi fenomenet, çudirat dhe mrekullitë të cilat ndodhën në natën kur lindi Muhamedi, (a.s.) e ndër të tjera ai ka përmendur edhe:

- Të rënë e porsalindurit (Muhamedit a.s.) me fytyrë për toke (në sexhde).

- Pozita e ulët e yjeve gjatë asaj nate (yjet ju afruan Tokës).

- Dridhja e pallatit të Kisras dhe rrënimi i 14 shtyllave të tij.

- Shuarja e zjarrit që adhurohej

4. Kur'ani, sureja El-Enbija, ajeti 106.

5. Kur'ani, sureja El-Bekare, ajeti 129.

6. Transmeton Hakimi dhe Jakub ibni Sufjani, me sened të mirë (Hadith hasen).

në Persi, zjarr, që ishte ndezur 1000 (njëmijë) vite më parë, e që asnjëherë nuk ishte shuar gjer me lindjen Muhamedit (a.s.).

- Atë natë u thyen idhujt që ishin në brendësi të Qabes e që adhuroheshin nga arabët.

- U shterua e u tha liqeni i quajtur Sava, të cilin e besonin si të shenjtëruar.

- U shfaq “Nurë” (një dritë e madhe) të cilën e pa Amineja, e ëma e Muhamedit.

“Kur nëna e të Dërguarit e ka lindur Muhamedin paskësh pa nurin (dritën) që i ka ndriçuar edhe pallatet e Shamit.”⁷

Poeti shqiptar Tahir ef. Popova, nga Vushtrria e Kosovës, në Mevludin e tij, këtë ndodhi e shpreh kështu:

*Prej Mashrikut deri n'magrib gjithë Dunjasë
I dha hjeshti lemja e k'tij Mustafasë.⁸*

Në “Musnedin” e Imam Ahmedit, transmetohet të ketë thënë Ibni Abbasi: “I Dërguari i All-llahut, (a.s.), në ditën e Hënë ka lindur, në ditën e Hënë është dërguar si pejgamber, në ditën e Hënë është shpërngulur nga Mekka, në

ditën e Hënë ka hyrë në Medine dhe në ditën e Hënë e ka vendosur Haxheru-El-esvedin në vendin e tij me rastin e renovimit të Qabesë.”

H. Abasi (r.a.), i biri i Abdu El-Mutalibit, xhaxhai i pejgamberit (a.s.), në një rast, i është drejtuar Pejgamberit (a.s.) me këto vargje:

Kur ti u linde u shndrit toka
وانت لما ولدت أشرقت الأرض
Me nurin tënd u ndriçuan
horizontet

و ضاءت بنورك الأفق
E ne me atë ndriçim
فنحن على ذلك الضياء
Rrugës së drejtë po ecim.⁹
وفي سبيل الرشاد نخترق

Nisur nga këto vargje të H. Abasit (r.a.) kuptohet se, poezi për Muhammedin (a.s.) janë thurur edhe sa ishte gjallë vetë Pejgamberi (a.s.), madje edhe vetë mevludi, si vepër artistike letrare, është një poemë fetare e shkruar në vargje, është poezi biografike, kushtuar Muhamedit (a.s.).

Pra, nga kjo që u përmend deri më tani, mësuam se i dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), ka lindur në mëngjesin e së hënës, datë 12 (dymbëdhjetë të Rebiu El-Evvelit), në Vitin e Elefantit - عام الفيل më (20 prill të vitit 571 m) në Mekë, saktësisht 50

7. Transmetim i El-Bizzarit dhe Taberanisë ; Hafız ibni Haxheri ka thënë se ky hadith është sahih. Këtë e pohojnë edhe te Hibbani dhe Hakimi.

8. Tahir ef. Popova, në Mevludin e tij, të titulluar “Mendhumetu El-Mevludi fi Efdali El-Mevxhudi bi Lisani El-Arnaut?” në origjinal f. 8, të cilin e shkroi më 1890 dhe e botoi në Stamboll, me lejen e Ministrisë së Arsimit të Turqisë, me nr. 109.

9. Shakir El-Bedri, “Edh-dhikra El-Halidetu li-En-Nebijji El-Halidi”, botoi “Daru El-Basri”, Bagdad, 1969 m - (1388 h.), f. 16-17.

ditë pas ngjarjes së njohur të tentimit të Ebreha-s për rrënimin e Qabesë (Viti i Elefantit), për të cilën flitet në suren 105 të Kur'anit, të quajtur "El-Filë".

Dihet se Babai i Muhamedit (a.s.) quhej Abdullah ibn Mutalib, ndërsa nëna e tij ishte Amine bint Vehb. Lindja e tij, sipas shumicës së historianëve dhe dijetarëve myslimanë, ka ndodhur në agim të ditës së Hënë.¹⁰ Aminja, tashmë e veja e Abdullahut, kishte lindur një djalë me specifika të veçanta, me karakteristika të papara, me fenomene të jashtëzakonshme, thënë ndryshe, kishte ndodhur vetë mrekullia.

Meqë Muhammedi (a.s.) kishte mbetur jetim ende pa lindur, sepse babai, Abdullahu, kishte vdekur disa muaj para lindjes, për rritjen, zhvillimin dhe edukimin e tij do të kujdeseshin e ëma, Amineja, mendojta (gjdhënëseja), Halimja, gjyshi, Abdulmutalibi, xhaxhai, Ebu Talibi dhe ndonjë tjetër prej të afërmeve të tij. Muhamedi (a.s.) nuk pati rast të shkollohet edhe pse në atë kohë, në Mekë, kishte njerëz të ditur dhe që dinin shkrim e lexim. Si i ri, u veçua nga të tjerët me karakter, moral e virtyte të larta.

10. Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu li Ibni Hisham", pjesa e parë, botimi III, Bejrut, 1971 m/1391 h, f. 167.

-Shih Ebu Abdil-lah Ez-Zinxhanij, Tarihu El-Kur'ani, Bejrut, 1969 m - (1388 h), f. 17.

-Shih edhe: Safijurrahman, Nektari i Vulosur i Xhenetit, përkthyer nga boshnjakishtja, "Urtësia" - Shkup, 1997, f. 54.

Që në rininë e hershme, Muhamedi (a.s.) dallohet shumë nga moshatarët e tij në shumë aspekte. Ai u tërhoqi vëmendjen njerëzve për mirë. Të përmendim se kur ai po shoqëronte xhaxhain e tij, Ebu Talibin, për tregti në Sham, në moshën 12 vjeçare,¹¹ Muhamedin (a.s.) e kishte parë një prift i devotshëm i quajtur Behira, të cilin e kishte habitur personaliteti i Muhamedit (a.s.). Me këtë rast Behira kishte porositur Ebu Talibin që të kishin kujdes dhe konsideratë ndaj tij, duke i thënë: "*Nga ky djalosh pritet një punë-mrekulli e madhe, saqë do të përmendet në lindje dhe në perëndim*".¹² Muhamedi (a.s.), në moshë të re, ka qenë edhe bari delesh,¹³ por edhe pjesëmarrës në beteja të ndryshme me xhaxhallarët e tij.¹⁴

Duhet veçuar edhe martesja e Muhamedit (a.s.) me Hatixhen, të bijën e Huvejlidit, që në një farë mënyre, përveç mirëqenies sociale,

11. Ebu El-Fidai Ismail bin Umer bin Kethir El-Kurejshij, "El-Fusulu fi Sireti Er-Resuli", përpunuar dhe korrigjatur nga Ebu Usamete Selim, Es-Selefij, botimi I, libri 1, Kuvejt, 2003 m - (1424 h.), f. 49.

12. Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham", pjesa e parë, botimi III, Bejrut, 1391 h. (1971), f. 191-194.

-Shih edhe: Safijurrahman El-Mubarekfuri, vepër e cituar, f. 21.

13. Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham", pjesa e parë, botimi III, Bejrut, 1391 h. (1971), f. 176.

14. Es-Siretu En-Nebevijetu Li-Ibni Hisham, f. 195-196.

kjo bashkëshortësi siguroi edhe dobi e të mira materiale. Ajo ishte gruaja e parë dhe, për derisa që gjallë ajo, Pejgamberi (a.s.) nuk ka pasur grua tjetër.¹⁵ Të gjithë fëmijët Muhamedi (a.s.) i pati me Hatixhen, me përjashtim të Ibrahimit. Fëmijët e tyre ishin Kasimi, Tahiri, Tajjibi, Zejnebeja, Rukija, Ummi Kulthumi dhe Fatimja.

Prej shumë ndodhive, ngjarjeve dhe aktiviteteve nga jeta e Muhamedit (a.s.), vlen për t'u theksuar edhe zgjidhja e konfliktit, në mënyrë paqësore, në mes të fiseve arabe, në lidhje me vënien e "Haxheri esvedit - (Gurit të Zi)" në themelin e Qabesë. Meqë ishte bërë problem vënia e gurthemelit gjatë rindërtimit të Qabes, Muhamedi (a.s.) ofroi zgjidhjen më të mirë. Propozoi që të gjitha fiset gurin e zi ta bartin me një çarçaf deri te vendi i duhur e pastaj, ai me duart e tij, e vendosi atë në themel të Qabes. Kjo ngjarje ndodhi më 12 Rebiul-Evvel, kur Muhamedi (a.s.) ishte 35 vjet, dhe prej atij çasti i dhanë emërtimin "El-Emin" (Besniku).¹⁶

Po me këtë datë, më 12 Rebiul-Evvel të vitit 610, Muhamedit (a.s.) i erdhi Vahji-shpallja, i zbriti Kur'ani Famëlartë, udhërrëfyes i pakufizuar

15. Grup autorësh, "Es-Siretu En-Nebevijetu", vepër e cituar, Bejrut, 1391 h. (1971), f. 201.

- Shih edhe Safijurrahman El-Mubarekfuri, Nektari i Vulosur i Xhenetit, përkthyer nga boshnjakishtja, Urtësia-Shkup, 1997, f. 61.

16. Po aty, f. 204, 209.

në kohë dhe hapësirë, jetë e gjallëri, drejtues, ligj e mirëqenie për mbarë njerëzinë, standard për çdo vend e kohë, i paprekshëm e i pa abroguar kurrë.

Po me këtë datë, në paraditen e së hënës, më 12 Rebiu El-Evvel, Muhammedi (a.s.), ndërroi jetë, duke lënë pas Kur'anin e Madhërishëm, që iu shpall nga Allahu, dhe Hadithet e Muhammedit (a.s.), traditën e tij, që e bënë të pavdekshme jetën dhe veprën e tij.

E gjithë kjo, lindja, jeta, dhe veprimtaria tij, periudha para pejgamberillëkut të Muhamedit (a.s.), ka rëndësinë dhe domethënien e vet, por ajo që pati jehonë anë e kënd botës, ajo që e bëri të përjetshëm e që të mos harrohet kurrë, është shpallja e tij Pejgamber nga Allahu (xh. xh.) dhe zbritja e Kur'anit, që po ashtu ndodhi më 12 të Rebiu El-Evvelit.

Pejgamberia e Muhamedit (a.s.)

Gjithçka sa u përmend deri tani, në lidhje me Muamedin (a.s.), jep të kuptohet se kemi të bëjmë me një njeri jonormal, por jo edhe të mbinatyrshëm, por kur Muhamedi (a.s.) mbushi dyzet vjet, saktësisht më 1 shkurt 610, fillon zbritja e Vahjit dhe që atëherë ai, Muhamedi (a.s.), bëhet Pejgamber i shpallur.¹⁷

Akti i Vahjit (frymëzimit), që vjen nga jashtë, është një dhunti

17. Ebu Abdil-lah ez-Zinxhanij, Terihu El-Ku'rani, Bejrut, 1388 (1969), f. 21.

hyjnore e Allahut (xh.sh.), që i fal peygamberit të Tij.

Në ditët kur Muhamedit (a.s.) po i afrohej koha e zbritjes së vajit (shpalljes), qëndronte i vetmuar dhe larg kontaktit me njerëz, shkonte dhe strehohej e izolohej nga të tjerët te një shpellë në malin Hira, në afërsi të Mekës.

Dihet mirëfilli se Muhamedi (a.s.) nuk dinte shkrim e lexim, prandaj, edhe me rastin e shpalljes, kur Xhibrili i kërkoi Muhamedit (a.s.) që të lexonte, përgjigjja e Pejgamberit ishte se nuk di të lexojë.¹⁸ Mirëpo, pas një trysnie të fortë të Xhibrilit mbi Muhammedin dhe pas përgatitjes së tij fizike e psikike, ju shpallën ajetet e para të Kur'anit, dhe me këtë akt, Muhamedi (a.s.) u bë Pejgamber i shpallur:¹⁹

﴿اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ * خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ * اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ * الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ * عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ﴾

*“Lexo në emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrin e nënës). Lexo, se Zoti yt është më bujari! I Cili e mësoi njeriun (të përdorë) lapsin. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte...”*²⁰

Ky akt ndodhi natën e Kadrit, më 1 shkurt të vitit 610.

Shëmbëlltyra e Pejgamberit në çdo fushë e në çdo aspekt të jetës,

vlerat universale njerëzore, virtytet sublime, janë ato që e karakterizojnë personalitetin e Pejgamberit (a.s.) dhe e bëjnë të dashur. Është dëgjuar nga Aisheja, gruaja e Muhamedit (a.s.), të ketë thënë se: *“Karakter-morali i tij ka qenë Kur’ani i Madhbërishëm”*, që do të thotë se ç’do fjalë e vepër e tij ka qenë në harmoni e përputhshmëri të plotë me Kur’anin Famëlartë, në të cilin i thuhet:

﴿وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ﴾

“Vërtet ti (Muhammed) je në Piedestalin më të lartë të moralit”.²¹

Dymbëdhjetë vitet e qëndruara në Meke, gjatë pejgamberllëkut, ishin të vështira dhe, pas tyre, jeta në Mekë ishte e padurueshme. Kështu që më 622 .9 .20 edhe vetë Pejgamberi, në fshehtësi, së bashku me Ebu Bekrin u detyrua të largohet nga Meka dhe të emigrojë në Jethrib (Medine).

Muhamedi (a.s.), poetët dhe poezia

Është i pakontestueshëm fakti se, Muhammedi (a.s.), ndaj poezisë si art, pati qëndrim afirmativ. Faktet tregojnë se Pejgamberi (a.s.) ua lejoi njerëzve poezinë, e cila, me të drejtë, llogaritet si mbretëresha e arteve, madje ai e dëgjoi me ëndje, nxiti për vargimin e saj dhe shpërbleu për të, gjë për të cilën dëshmojnë provat dhe kjo mund të argumentohet.

Muhammedi (a.s.) dëgjonte poezi nga poeti Nabiga Dhujaniu,

21. Kur’ani, sureja El-Kalem, ajeti 4.

18. Safijurrahman El-Mubarekfuri, vepër e cituar, f. 65

19. Muhammed Alij Es-Sabunij ” vepër e cituar, botim II, f. 12.

20. Kur’ani, sureja El-Alek, ajeti 1-5.

por edhe nga Ka'ib ibni Zuhejri e dëgjoi me vëmendje *"Kasidetu El-Burde"*²² dhe kur arriti te vargjet:

"Pejgamberi është dritë, me të cilën ndriçohemi,

Luan, nga shpatat e zhveshura të Indisë."

Pejgamberi ndërhyri duke e korrigjuar dhe i tha: *"nga shpatat e All-llahut"*, e Ka'ibi e përmirësoi vargun.²³

Muhamedi (a.s.), për hir të fjalës së bukur artistike, Ka'ib ibni Zuhejrin, e nderoi duke i hedhur mbi supe Burden e vet (një lloj manteli) dhe që atëherë kjo poemë është emërtuar *"Kasidetu El-Burdeti"*.²⁴

Për poezinë, Pejgamberi (a.s.), që atëherë thoshte: *"Poezia është një gjë që të bukurën e bën me të bukur dhe të keqen e bën më të keqe"* (transmetim i Buhariut).

Më sa përmend nga hadithet e sipërcituara, kuptohet se të thurësh poezi e ta lavdërosh Pejgamberin (a.s.) nuk ka asgjë të keqe, nuk është asnjë lloj "bid'atun" novatorizmi-risie, siç pretendon e dëshiron dikush ta klasifikojë, por është një vazhdim i një tradite të mirë dhe, gjithsesi, ka

22. Ibni El-Kajjem El-Xhevziyyetu, "Medariku Es-Salikinë", pjesa e I-rë, botoi "Daru Ihjai Et-turathi El-Arabij", Bejrut-Liban, 1999 m. (1419 h.), f. 370.

23. Transmetuar edhe në historinë e Ibni Hishamit.

24. Dr. Shevki Dajf, "El-Asru El-Islamij", botimi i XIII-të, Kajro, 1963, f. 83.

mbështetje në literaturën burimore islame dhe është edhe miratim i Pejgamberit (a.s.).

Për personalitetin e Pejgamberit (a.s.), si drejtues shpirtëror-fetar, si njeri i qytetëruar me karakter e moral të lartë, si strateg ushtarak, si udhëheqës politik e si burrë shteti që mund të shërbejë si shembull përgjithmonë dhe kudo, kanë folur Kur'ani, shumë hadithe, por edhe personalitete myslimane dhe jomyslimane me pozitë ndërkombëtare e ndër ta edhe Majkëll Hart, i cili thotë: *"Muhammedi është personalitet prijatar si nga aspekti religjioz, ashtu edhe nga ai politiko-shoqëror, respektivisht, si forcë lëvizëse e çlirimeve arabe. Më të drejtë ai mund të mbajë vendin e parë si udhëheqësi politik më me ndikim në histori"*.²⁵

Fenomeni i Mevludit dhe këndimi i tij

Pejgamberin (a.s.) e kanë lavdëruar dhe vazhdojnë ta lavdërojnë fetarët e devotshëm, dijetarët, por edhe shkrimtarët, të cilët, me shkrimet e me këndimet e tyre artistike, në forma të ndryshme, kanë shprehur devotshmërinë dhe respektin e duhur për Pejgamberin (a.s.).

Dihet se Esh-Shejh Ebu El-Hattab bin Dihjete, në fillim të shek. të VII-të hixhri, shkroi një

25. Majkëll Hart, "100 personalitete më me ndikim në histori", Tetovë, 1997, f. 13.

poemë (Mevludin e parë) për Sulltan Mudhaffer Kevkeburin, rreth lindjes së Pejgamberit (a.s.), të titulluar “*Et-Tenviru fi Mevlidi-El-Beshiri En-Nedhiri*”,²⁶ dhe për këtë vepër Sulltani e shpërbleu shkrimtarin me 1.000 dinar (monedha ari).

Prej mevludeve më të njohur dhe më të përdorur, te turqit, është “*Vesiletu En-Nexhat*” (Mjeti për shpëtim), që e përpiloi poeti turk Sulejman Çelebi në qytetin Bursa, në vitin 1409 m., pastaj pason mevludi i autorit kurd Mela Bate, i cili njihet edhe me emrin Mulla Hasan Ertushi.²⁷

Edhe shkrimtarët shqiptarë, të letërsisë Islame, kanë shkruar Mevlude origjinale apo përkthime, që nga shek. XIX. Të theksojmë, se te shqiptarët, shumica e këtyre mevludeve janë shkruar në periudhën e Rilindjes Kombëtare, nga personalitete dhe dijetarë të shquar e të dëshmuar, si në rrafshin fetar, po ashtu edhe në rrafshin kombëtar. Duhet theksuar se, deri sot, njihen mbi 30 mevlude të shkruara nga personalitete të njohura në fusha të ndryshme të fesë dhe të letërsisë, të cilët, me mjeshtërinë e tyre dhe në mënyrë artistike e shembullore, thurën lavde e konsiderata, si për

askënd tjetër, për të Dërguarin e Zotit, Muhamedin (a.s.) Mevludi i parë besohet të jetë ai poetit të madh- Hasan Zyko Kamberi, por mevlude kanë shkruar edhe Muhamed Çami, Ismail Flloqi, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Tahir efendi Popova etj. Shkrimtarët shqiptarët kanë vazhduar të shkruajnë mevlude edhe gjatë shekullit XX-të.

Manifestimi i mevludit novatorizëm (risi e pranueshme)

Është realitet i pamohueshëm se festimi i mevludit, ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), nuk ndodhi në kohën e Pejgamberit (a.s.). Madje, ky festim nuk është bërë, as në kohën e Sahabëve, as të Tabiinëve, por as në kohën e Tabi-tabiinëve nuk ndodhi festimi i mevludit në format të cilat i gjejmë dhe i praktikojnë sot myslimanët anë e kënd botës.

Janë një numër i konsiderueshëm dijetarësh selefi klasikë, por edhe disa bashkëkohorë, të cilët, manifestimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), e konsiderojnë si një risi-novatorizëm i papranueshëm, madje edhe i dëmshëm. Ka nga ata që festimin e vlerësojnë si një rebelim ndaj traditës burimore islame. Nisur nga kjo, ata më tërë forcën dhe me gjithë bagazhin e tyre fetar, shkencor e intelektual, janë angazhuar në ndalimin e këtij manifestimi. Prej dijetarëve bashkëkohorë që janë

26. El-Imam El-Hafidh Ebu Ismail bin Kethir Ed-Dimashkij “El-Bidajetu ve En-Nihajetu” pjesa e XIII-të, botoi “Mektebetu El-Iman”, f. 131-132.

27. Shih Feridudin Aydin “Festimi i mevludit dhe kultura e imitimit” AlbIslam, botuar më 1 Mars 2009.

kundra festimit të Ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) po veçojmë: Shejh Abdu El-Aziz bin Abdil-lah bin Baz,²⁸ shejh Ibrahim bin Salih Al Shejh, Dr. Muhammed Sa'd Esh-Shuvej'ir, shejh Abdull-llah bin Abdu Er-Rahman bin Bessam, shejh Abdull-llah bin Hamid, Dr. Es-Sadik Es-Sudduk, shejh Ebu Er-Rezak Ufejfi, shejh Muhammed bin Salih El-Uthejmin dhe shejh Abdull-llah bin El-Muni', por edhe dijetarë të tjerë.

Pra nisur nga kjo, edhe tek ne, dikush e quan manifestimin e Ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) si një risi, fenomen i papranueshëm, mëkat, rebelim ndaj fesë Islame. Sipas kësaj logjike, nëse festimi i ditës së mevludit është "bid'atun" (novatorizëm) i papranueshëm në Islam, gjithnjë sipas tyre, atëherë nga ky veprim jep të kuptohet, se lavdërimi i Pejgamberit (a.s.) është "bid'atun" i papranueshëm. Por, ky qëndrim gjithsesi se bie ndesh me thënien e Pejgamberit (a.s.):

"Kush më përçjell (zon) një Salavat të vetëm, All-llahu do ti përçjell atij dhjetë salavate", që do të thotë se ka sevape të dhjetëfishuara.

Nga një transmetimi i Ebi Katadetes mësohet se i Dërguari i All-llahut (xh. sh.) është pyetur për agjërimin e ditës së Hënë, përgjigjja e Pejgamberit ishte se: *"Ajo është dita në të cilën kam lindur dhe dita në të cilën jam dërguar si pejgamber."* (transmetim

28. التحذير من البدع ص 4-3.

i Muslimit), e që nënkupton se Pejgamberi (a.s.) e ka veçuar ditën e Hënë dhe nuk e ka ndaluar agjërimin e asaj dite.

Për përshëndetje dhe lavdërim (çuarje salat e selam) Pejgamberit jemi të porositur edhe në Kur'an:

﴿إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا﴾

"Vërtet All-llahu xh. sh. dhe melekët e Tij bien salavat (lavdërojnë) pejgamberin (a.s.). O ju të cilët keni besuar, lavdërojeni dhe ju atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndetni me selam."²⁹

Festën e Mevludit, sipas burimeve historike, i pari e aplikoi halifi Fatimij Ubejdijj-El-Muiz Lidinil-lahi, në Egjipt, së bashku me disa festa të tjera të shpikura.., dhe kjo ndodhi në vitin 362 h.³⁰ Për një kohë festa e Mevludit ka pushuar së festuari, për tu rikthyer në qytetin Musul të Irakut nga shejh Umer bin Muhammed El-Mul-la, një dijetar i shquar për devotshmëri dhe bamirësi.³¹

Manifestimi i mevludit, në mënyrë të organizuar e masive ripërsëritet në muajin Rebiu El-Evvel aty nga mbarimi i shekullit të VI-të dhe fillimi i shek VII-të h. Ky manifestim u organizua në mënyrë spektakolare nga sundimtari

29. Kur'ani, sureja El-Ah'zab, ajeti 56.

30. ص. ٤٤ الشيخ محمد بخيت المطيعي مفتي الديار المصرية. سابقاً في كتابه: (أحسن الكلام فيما يتعلق بالسنة والبدعة من الأحكام)

31. أبو شامة في كتابه: «الباعث على إنكار البدع والحوادث».

i atëhershëm i Irbilit (qytet në veri të Irakut), Mbreti Mudhaffer Kevkeburi-(ملك المظفر أبو سعيد كوكبوري), njëri ndër sundimtarët e famshëm, shumë bujar e humanist i madh. Vetë autori i poemës “*Et-Tenviru fi Mevlidi-El-Beshiri En-Nedhiri*”, ibni Dihjete është dëgjuar të këtë thënë se: “*Kam lexuar mevlud përpara sulltan El-Mudhafferit në vitin 625 h. në gjashtë mexhlise.*”³²

Për sa i përket turqve, Dita e Mevludit, për të parën herë, u festua në periudhën e Sulltan Muratit III (1574 m. – 1595 m.). Ishte ky sulltani i dymbëdhjetë në radhë nga osmanlinjtë, për të cilin thuhet se bënte shpenzime marramendëse për këso festimesh.³³ Në Turqi, që të gjithë; turq arabë, kurdë, e çerkezë e këndojnë mevludin në gjuhët e tyre.

Te shqiptarët kjo kremte festohet në forma dhe organizime të ndryshme, por në rastet më të shpeshta, kjo ndodh edhe me këndimin e ndonjërit prej mevludeve të shkruar apo të adaptuara në gjuhën shqipe, apo disa pjesë të tij, qoftë kjo në xhami, institucione kulturore e fetare, apo edhe në shtëpi private etj.

Në këtë rast, patjetër duhet përmendur thënia e Abdull-llah ibni

Mesudit: “*Atë që myslimanët e shohin se është vepër e mirë, që duhet të bëhet, edhe All-llahu xh.sh e konsideron si të mirë. Atë që myslimanët e shohin si të keqe, e të mos veprohet, edhe All-llahu xh.sh e konsideron si të keqe*”. (transmetim i Ahmedit)

Bazuar në këtë thënie të sahabiut të respektuar, del se një veprim, punë, fenomen i ri, po qoftë edhe “Bid’atun” risi –(novatorizëm) që nuk bie ndesh me burimet kryesore të Islamit; Kur’an, Hadith e të tjera...dhe që është i pranueshëm, i mirë e i dobishëm për shumicën e myslimanëve, atëherë ajo është një “Bid’atun haseneh” (Risi e mirë) novatorizëm i dobishëm për myslimanët dhe lejohet të aplikohet.

Tani, duke ditur se lavdërimi dhe përshëndetja (çarja salavatë dhe salam) e Pejgamberit (a.s.) është porosi e Kur’anit, Sunetit (traditës pejgamberike) dhe detyrim fetar, të shpresojmë se edhe festimi i Mevludit është “bid’atun haseneh”, një fenomen- novatorizëm (një risi e mirë me premisa fetare) dhe ky është një realitet që e jetësojmë edhe në trevat tona, gjithandej ku jetojnë shqiptarët myslimanë. Këtë lavdërim të Pejgamberit (a.s.), në këtë formë, dogmatikët e klasifikojnë si një lloj “rebelimi” ndaj traditës pejgamberike. Vlerësim të kësaj natyre dhe të këtij niveli, në ditët e sotme, mendojnë, mund të shprehin vetëm ata të cilët nuk kanë kapacitete të mjaftueshme intelektuale për ta

32. El-Imam El-Hafidh Ebu Ismail bin Kethir Ed-Dimashkij “El-Bidajetu ve En-Nihajetu” pjesa e XIII-të, botoi “Mektebetu El-Iman”, f. 131-132.

33. Këto të dhëna janë marrë e nga numri më i ri i revistës AlbIslam, i botuar më 1 Mars, botoi “Mektebetu El-Iman”, 2009, f. 131-132.

vlerësuar një vepër artistike fetare, siç është Mevludi dhe, në anën tjetër, për të pranuar realitetin se mevludi është një manifestim me karakter krejtësisht fetar, pa abuzime të principeve islame tek ne.

Nuk ka dyshim se një numër i madh i dijetarëve dhe fukahave-juristëve myslimanë e kanë lejuar, madje një numër prej tyre e preferojnë festimin e ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.), duke e vlerësuar atë si një risi të pranueshme dhe një traditë të mirë, që ka filluar nga shekulli i IV-të h. e në vazhdimësi dhe këtë çështje e kanë mbështetur edhe një numër i konsiderueshëm prej selefistëve tradicionalistë. Nga ata që janë pro manifestimit të mevludit po përmendim selefistët fukaha-juristë të Sheriatit:

El-Hafidh Ebu Shammeh Shihabu Eddin Abdu Er-Rahman Esh-Shafii (v. 655 h.) i njohur si Imamm En-Nuveviu, eruditi Muhammed bin Abdil-lah ibni El-Haxh El-Fasij El-Kajrevani Et-Telmisani El-Malikij (v. 714 h.), Ibni Et-Tejmijeti³⁴, Ebu Abdullah Muhammed Ibni Ibad (v. 730 h.) El-Hafidh Ibni Haxher El-Askalani, (v. 852 h.), El-Alusij, Dr. Ahmed Esh-Sherbasi-ish myftiu i Az'herit, El-Hafidh Shemsu Eddin Essehavi (v. 876 h.), El-Imam El-Kastalanij (v. 922 h.)³⁵, Nureddin El-Halebij (v. 1014 h.), Ahmed Zejjin Dehalan (v.

1066 h.)³⁶, Eh-Shejh Reshid Rida (v. 1255 h.)³⁷.

Ibni Tejmije pasi flet rreth krijimit të gjithësisë nga Allahu (xh. sh.) flet dhe për Pejgamberin (a.s.)³⁸

Besimtarët, Pejgamberin (a.s.), duhet ta përmendin gjithmonë, por ka raste kur përmendja e tij bëhet më e vlefshme dhe më e pranueshme. Njëri nga këto raste mendohet të jetë nata e Mevludit.³⁹

Ibni Tejmije është prononcuar qartë në favor të manifestimit Mevludit: *“Ta madhbërosh Mevludin dhe ta pranosh atë si festë! Ndodh që këtë ta bëjnë disa njerëz dhe në këtë punë ka shpërblim të madh, duke pasur parasysh qëllimin e mirë të tyre dhe duke parë se këtë punë e bëjnë për të nderuar Pejgamberin e All-llahut xh. sh.”*⁴⁰

Dijetarët myslimanë thonë se: Në këtë natë është e pëlqyeshme të madhërohet Allahu, të këndohen salavate, të jepet sadaka, të bëhen punë të mira etj. Nëse këto punë bëhen për hir të Allahut (xh. sh.), atëherë sevapi është i madh. (Ibni Battall Maliki).

36. انظر السيرة النبوية والآثار المحمدية المطبوع على هامش السيرة الحلبية.

37. فتاوى الشيخ رشيد رضا، ج. ٤، ص. 1243.

38. Ibn Tejmije, “Mexhmuu El-Fetava”, v. 11, f. 97.

39. Ibn Tejmije, “Iktidau Es-Sirati El-Mustekim”, f. 297.

40. Ahmed bin Abdu Es-Selam Ibni Et-Tejmijeti, “Iktidau Es Sirati El-Mustekim”, pjesa e II-të, botoi “Daru El-Asimeti”, botimi i VII-të, Rijad, 1998 m. (1419 h.), f. 126.

34. اقتضاء الصراط المستقيم، ص 297.

35. شرح القسطلاني على صحيح البخاري.

“Festimi i ditëlindjes së Pejgamberit (a.s.) nuk duhet të përzihet me gjëra haram, me veprime e punë të ndaluara dhe të papëlqyeshme” (Sherh Sunen ibni Maxhe)

Mexhlisi (grumbullimi) në natën e Mevludit, ku përmendet Allahu (xh. sh.), të çuarit salavatë e selam për Pejgamberin (a.s.), të ushqyerit e të varfërve është gjithmonë sevap, por, nëse këtyre të mirave u shtohet edhe ndonjë gjë prej haramit, atëherë edhe gjynahu është shumë më i madh.

Nga gjithë ajo që u përmend më lart në lidhje me manifestimin e mevludit, bazuar në argumente dhe kundërargumente, kujtojmë se manifestimi i mevludit nuk është i patjetërsueshëm, por është pjesë e traditës dhe kulturës tonë fetare-shpirtërore, është një mirësi (mustehab) që myslimanët, kudo që janë, e në veçanti në këto troje tona, ta shënojnë ditëlindjen e Pejgamberit (a.s.), sepse praktika po tregon se, në mungesë të festimeve islame dhe nevojës së begatisë shpirtërore, te myslimanët, e në veçanti rinia, po orientohet në festa krejtësisht të huaja e që nuk kanë asgjë të përbashkët me identitetin e tyre fetar.

Është obligim fetar për dijetarët myslimanë që, edhe kur

kundërshtohen, të mos përjashtohen dhe të mos shkaktojnë plasaritje apo thyerje të pariparueshme. Duhet të kemi parasysh se, respektimi i mendimit të tjetrit, të bazuar në argumente, është parim islam dhe kulturë e komunikimit, ndërsa injorimi i mendimit të kundërt nuk është as mençuri, as etikë dhe as filozofi e “Daves” thirrjes islame.

Mesazhi i kësaj feste në Përkujtimin e Lindjes së Pejgamberit të fundit, Muhamedit (a.s.), do të ishte: Kthejuni fesë tuaj, burimeve themelore të saj, Kur’anit, haditheve të Muhamedit (a.s.), por edhe traditës sonë të lavdishme, për derisa nuk bie ndesh me principet substanciale islame, sepse aty është shpëtimi ynë, se aty është e ardhmja e këtij populli, se aty është lumturia.

Është realitet i pamohueshëm se, vetëm falë Islamit, që në princip nuk ka dhunë, shqiptarët e ruajtën identitetin; gjuhën, kulturën lëndore dhe shpirtërore, në etnosin e tyre dhe masa dërmuese e tyre u shpëtuan pa u greqizuar, pa u sllavizuar pa u latinizuar, ose pa u turqizuar. Dhe krejt në fund të themi se asnjëherë nuk ka pasur dhe nuk do të ketë civilizim të mirëfilltë dhe popull të qytetëruar pa fe e atdhe.

Meditimi, rruga ndriçuese e besimit në Zot

MA. Dorian Demetja
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Abstrakt

Të medituarit rreth krijesave të Zotit, është një ritual që largon preokupimet dhe shqetësimet, sepse pas kësaj, njeriu e ndjen se kjo botë, me gjithë hallat e saj, është shumë e vogël në krahasim me universin, e ndjen se problemet dhe vuajtjet janë shumë të vogla në krahasim me madhësinë e universit dhe të Krijuesit.

Në botën e tij të brendshme, njeriu është një krijesë që ka nevojë të emocionohet çdo ditë, madje disa herë në ditë. Porë në këtë këndvështrim, detyra jonë në këtë mes është të mos rrimë larg shokëve të mirë, sepse shoku i mirë, në çdo kohë, me këshillat dhe porositë e tij të dobishme, mund të na zgjojë emocione dhe të na e ngrejë zemrën peshë.

Në çdo kohë, lutja jonë, me të cilën i drejtohem Allahut, duhet të jetë që të na mbrojë nga e keqja e egos dhe e djallit, në mënyrë që të mund ta vazhdojmë jetën në atmosferën e mirësisë hyjnore. Njëkohësisht lusim Allahun (x.b.sh.), që nëpërmjet meditimit, t'i kuptojmë dhe t'i konceptojmë mirë, në pikëpamje shumëdimensionale, mesazhet e Islamit dhe, duke i përfaqësuar në mënyrë dinjitoze, të fitojmë kënaqësinë e Krijuesit tonë.

Dhe thuaj: Lavdëruar qoftë Allahu, i Cili nuk pati fëmijë dhe nuk ka për Të shok në sundimin dhe, sa i përket aftësisë, nuk ka nevojë për ndihmëtarë, dhe madhëroje Atë me madhërinë që i takon¹.

Allahu është më i madhi, Ai është i Lartësuar, Ai është i Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti, Ai është Krijuesi, Formëdhënësi, i Cili, nëpërmjet fuqisë së Tij, e krijoi dhe e modeloi njeriun në formën më të bukur. Allahu është i Gjithëdituri, Ai është i Drejti dhe Sovrani Absolut, i Cili e themeloi pemën e universit për gjashtë ditë në përputhje me parimet e urtësisë dhe dëshirës së Tij.

Zoti e ka krijuar njeriun me kapacitete të ndryshme fizike, emocionale, intelektuale dhe shpirtërore. Njëkohësisht kur e krijoi, nuk e la kuturu që rrugën ta gjejë vetë, por, nga mesi i njerëzve, Ai dërgoi profetë për të përcjellë mesazhet e Veta dhe për të bërë të qartë qëllimin e krijimit të njeriut, të ardhjes së tij në këtë botë. Përveç kësaj, në mënyrë të paimponuar, Allahu i ka dhënë vullnet të lirë njeriut që ta zgjedhë vetë rrugën e tij. Në të gjithë këtë proces, roli i njeriut është shumë i vogël, por Zoti e ka bërë vullnetin tonë një kusht elementar për te rruga e drejtë. Njeriu merr vetëm iniciativën, të

tjerat janë dhurata hyjnore. Mjafton iniciativa jonë për kafshatën e bukës dhe proceset e shijimit, bluarjes, tretjes etj.; janë dhurata nga Zoti, të cilat veprojnë në mënyrë automatike. Pra, vetëm një shtypje butoni kah ana e besimit, bëhet shkak për ndezjen e dritave të udhës së drejtë.

Njeriu duhet të trokasë në derë me cilësinë e të kërkuarit diçka. Si rruga e drejtë, ashtu edhe ajo e gabuar janë nga krijimi i Zotit. Allahu udhëzon ose jo, por edhe kjo ka pretekstet e veta. Për shembull ç'mund të thuhet për iniciativën e njeriut që shkon në xhami apo në biseda fetare dhe për atë që shkon në pijetore apo në shtëpi publike?! Kjo do të thotë që njeriu ka në dorë një gjë aq të vogël, saqë nuk mund t'i bëhet shkak i vërtetë as për ta udhëzuar, as për ta devijuar. Këtë nënkupton edhe ajeti: **“Atë që e udhëzon Allahu, ai është vërtet udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesësh për të ndihmës që do ta udhëzonte”**².

Në Kur'an thuhet: **“Në krijimin e qiejve e të tokës, në zëvendësimin reciprok të natës me ditën ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt”**³. Me të vërtetë, në lindjen dhe perëndimin harmonik të hënës e diellit, në rregullsinë marramendëse sipas së cilës ndodhin dukuritë, ka shembuj domethënës për ata që

2. El-Kehf, 17.

3. Al 'Imran, 190

1. Isra, 111.

thellohen në mendim. Në lidhje me çështjen e meditimit, ky ajet është një argument i qartë. Ky dhe shumë ajete të tjerë të ngjashëm, që konsiderohen një portë e hapur për meditimin dhe arsyetimin, kanë rëndësi shumë të madhe për të treguar se cilat janë dimensionet e jetës së besimtarit në Islam.

Vetëm se, në fillim, është e nevojshme të dihet se ç'është meditimi. Pikësëpari, meditimi duhet të mbështetet në një informacion fillestar. Ndryshe, me një meditim të varfër, të rëndomtë dhe të pa orientuar, nuk mund të arrihet askund. Një meditim i tillë i mbyllur, me kalimin e kohës sjell ngopje, mërzi dhe lodhje dhe pastaj njeriu arrin deri në atë gradë sa të mos mendojë më dot. Fillimisht, njeriu duhet ta njohë mirë subjektin mbi të cilin do të meditojë, si dhe specifikat që do të përbëjnë bazë për meditim, domethënë duhet t'i serviret ose të ketë në dispozicion një informacion të qëndrueshëm, në mënyrë që të mundet të mendojë rregullisht e sistematikisht. Nëse njeriu i njeh qoftë edhe pak lëvizjet dhe ciklin e trupave qiellorë, marrëdhëniet e tyre me njeriun, lëvizjen dhe veprimtarinë e grimcave që përbëjnë trupin e njeriut; kur mendon rreth tyre; ky mendim mund të quhet meditim. Vërtet ka pasur njerëz që i kanë ardhur rreth e rrotull materies dhe ekzistencës së saj, por kurrë nuk kanë mundur

ta njohin të vërtetën e saj. Ndërsa ata që, duke vështruar lëvizjet e hënës e të diellit, ndiejnë diçka, dhe përpiqen po kështu të thonë diçka, nuk janë mendimtarë, por poetë apo ëndërrimtarë, që shprehin frymëzimet dhe iluzionet e tyre. Pra, nuk është e mundur të quhen meditues, ata që se vrasin mendjen për të vërtetën. Për shembull, në shprehjet e poetëve të dashuruar pas natyrës, njeriu bëhet sikur po ndien parajsën, sikur po ndodhet në mesin e saj, shushurima e ujërave që rrjedhin, fëshfërima e gjetheve të pemëve, kënga e zogjve... Kënaqen me ato që shohin dhe i servir kjo botë, por nuk shkojnë përtej saj. Në të gjitha anët e mendimeve të tyre mbi jetën ka një ngecje, një shteg të mbyllur dhe ajo çka këta quajnë meditim, nuk është gjë tjetër veç një mendim dhe ankth i pashpresë. Sigurisht që një meditim i tillë nuk ka asnjë dobi!

Për të medituar, së pari duhet një e dhënë fillestare, duhen analiza (sineteza) të reja në përputhje me bazën, me mendimin për të kërkuar të vërtetën. Personi që mendon me këtë sistem, mund të arrijë konkluzione gjithnjë të reja e të vazhdueshme. Pastaj, duke i bërë këto konkluzione bazë për hapa të tjerë, mendimi mund të bëjë përpara dhe me kohë njeriu thellohet e dimensionohet në meditimin e tij.

Si bazë fillestare në procesin e të menduarit, mund të radhisim

specifika të tilla si leximi, aftësimi për të kuptuar librin e gjithësisë dhe vështrimi i ekzistencës nën objektivin e Kur'anit që konsiderohet interpretuesi më i mirë i saj. Ndryshe, konstatime të tilla si ylli polar qëndron këtu, dielli perëndon kështu, vështrimi në fytyrën e materies pa ndonjë synim të përcaktuar e në mënyrë vulgare, jo vetëm që nuk mund të jenë meditim, por as që ekziston mundësia për të arritur diku me këtë lloj meditimi. Edhe fitimi i ndonjë të mire prej tij, është çdo herë diçka e diskutueshme. Kjo nënkupton që njeriu meriton disa gjëra sipas mundit që ka dhënë. Duke arsyetuar mbi këtë bazë, njeriu pa meditimin në fjalë, e ka kryer detyrën e adhurimit të Zotit si rob i Tij, pavarësisht se në ç'formë, dhe konsiderohet të ketë kaluar në disa lloj marrëdhëniesh me Të. Vetëm se nuk ka mundur të përftojë gjërat që prodhohen prej meditimit.

Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.) thuhet:

”فَكْرُهُ سَاعَةٌ خَيْرٌ مِنْ عِبَادَةٍ سِتِّينَ سَنَةً“

“Meditimi i një ore, është më i vlefshëm sesa adhurimi (vullnetar) i gjashtëdhjetë viteve”⁴. Domethënë, në sajë të një ore meditimi, te njeriu shfaqet besimi i plotësuar, në shpirtin e tij përshndrisin dritëzat që e afrojnë atë me njohjen dhe të ndierët e Zotit. Ndërkohë në zemër shfaqet dashuria hyjnore dhe njeriu arrin një kënaqësi shumë të madhe

4. Isbahani, Kitabu'l-Adhame, v. I, f. 299.

shpirtërore. Mirëpo, një pyetje na vjen ndërmend: A e zëvendësojnë meditimin ajetet kur'anore që nxisin për meditim dhe lutjet e bëra në heshtje? Ashtu si në leximin dhe kuptimin e Kur'anit, Fjalës së Krijuesit, edhe kjo varet nga të qenët i vetëdijshëm për çka po bën. Lutja e vetëdijshme, përgjërimi i vetëdijshëm disa herë në botën e brendshme të njeriut, mund të hapë edhe drynat më të ndryshkur. Nëse ato s'kuptohen dhe njeriu nuk thellohet në to, nuk ka meditim. Ka të mirë, por jo meditim. Meditimi vjen nga të vrarët e mendjes. Meditim do të thotë të bashkosh dukuri të reja me ato ekzistueset dhe t'i analizosh ato. Që të arrijmë të meditojmë, duhet të kemi parasysh se sa e vëmë në punë zemrën dhe shpirtin, se sa qëndrojmë dhe kërkojmë mbi objektin që merret për meditim, se sa i thellojmë dhe i përforcojmë marrëdhëniet me Zotin. Fatkeqësisht gjëja më e paktë e më e rrallë në ditët tona është meditimi!

Meditimi i Profetit Ibrahim (a.s.)

Të medituarit rreth krijesave të Zotit, është një ritual që largon preokupimet dhe shqetësimet, sepse pas kësaj, njeriu e ndjen se kjo botë, me gjithë hallet e saj, është shumë e vogël në krahasim me universin, e ndjen se problemet dhe vuajtjet janë shumë të vogla në krahasim me madhësitë e universit dhe të Krijuesit. Meditimi është një ritual

që praktikohet nga të gjithë profetët.

Ibrahimi (a.s.) që në moshë të re, nuk pajtohet me gjendjen ekzistuese besimore të popullit të tij dhe duke medituar, ai tentoi ta njohë Krijuesin Absolut. Natyra e tij e pastër, intelekt i tij i fuqishëm dhe besimi i tij i sinqertë, bënë që ai ta fitojë dritën e Allahut: **“Dhe kështu ne i treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të tokës që të jetë i bindur mirë”**⁵.

Kureshtja e tij për të vërtetën, e provokuar me shikimin e yllit në qiell të hapur, e shtyu të thotë: **“Ky është Krijuesi im!”**⁶, dhe të heq dorë nga ky “krijues” porsa ta konstatojë perëndimin e yllit duke thënë: **“Nuk i dua ata që perëndojnë”**⁷.

Ngjashëm ndodhi edhe me Hënën e Diellin. Meqë populli i tij në Haran e adhuronte Hënën e Diellin, Ibrahimi (a.s.) i qorton: **“O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i konsideroni rival Atij! Unë po e kthej fytyrën time, si besimtar i vërtetë, nga Ai i cili i ka krijuar qiejt dhe Tokën, dhe unë nuk jam nga idhujtarët”**⁸.

Këtu shohim meditimin e Profetit Ibrahim (a.s.), i cili me thellësinë e mendimit të tij dhe duke u bazuar në logjikën e gjërave, e kupton shumë mirë se çdo send, që lind e perëndon, lëviz në rrugën e

përcaktuar nga një fuqi më e madhe, e cila i vë në lëvizje këta trupa. Dhe kjo fuqi i përket të Plotfuqishmit.

Përcjellja e mesazhit dhe reagimi i Ibrahimit (a.s.)

Ndër adhuruesit e idhujve ishte edhe babai i Ibrahimit (a.s.), Azeri. I vetëdijshëm për gjendjen e babait, ai, me gjithë fuqinë e besimit, i drejtohet: **“O babai im, përse e adhuron atë që as nuk dëgjon, as sheh, as që mund të të shërbejë për diçka?”**⁹

Më tej, në suren El-En'am, me dëshpërim e brengosje Ibrahimi (a.s.) i drejtohet babait të tij, Azerit: **“... Vallë idhujt i konsideron për zota? Shoh se ti dhe populli yt vërtetë jeni në mashtrim të qartë”**¹⁰.

Edhe pse në shikim të parë Ibrahimi (a.s.) shfaq vrazhdësi dhe rreptësi ndaj idhujve, ai shpërthen nga dhembshuria, butësia, kujdesi ndaj të gjithëve, e sidomos ndaj babait. Ai edhe pse tregonte bindje ndaj babait, në çështjen e besimit e këshillonte, sepse besimi i kapërcen lidhjet biologjike: **“O babai im, mua më ka ardhur dije që ty nuk të ka ardhë, ndaj më paso dhe unë do të udhëzoj në rrugë të drejtë.”**¹¹ **“O babai im, kam frikë se nga Mëshiruesi do të vijë dënimi ...”**¹²

5. El-Enam, 75.

6. El-Enam, 76.

7. El-Enam, 76.

8. El-Enam, 78-79.

9. Merjem, 42.

10. El-Enam, 74.

11. Merjem, 43.

12. Merjem, 45.

Mirëpo, babai refuzon thirrjen e të birit, madje refuzimi i tij karakterizohet edhe me presion: **“A i mohon ti zotat e mi o Ibrahim? Nëse nuk heq dorë sigurisht do të gurëzoj, prandaj për një kohë të gjatë hiqmu sysh”**¹³.

Edhe pse kërcënimi ishte real, Ibrahim (a.s.) nuk hoqi dorë nga kujdesi për babanë e tij. Madje premtoi se do t'i lutet Zotit për të: **“Selam (paqe) mbi ty. Do ta lus Krijuesin tim të të falë, sepse Ai është shumë i mirë ndaj meje”**¹⁴.

Shembulli i sjelljes së Ibrahim (a.s.) ndaj babait të tij mohues, tregon njeriun plot besim, dhembshuri e shpresë, por edhe këmbëngulës në idealet e tij; besimin në Zotin Një dhe të Vetëm.

Meditimi i Profetit Muhamed (a.s.)

Meditimi është i tillë që të afron më shumë me Zotin, i forcon lidhjet e tua me Zotin dhe të bën prej të dashurve të Tij.

Meditimi ndahet në dy pjesë: E para, të njohësh dhe të besosh se Zoti ekziston, gjë që e besojnë shumica e njerëzimit. E dyta, të njohësh cilësitë e Zotit, madhështinë e Tij, të njohësh autoritetin, ta duash dhe të jesh në vazhdimësi i lidhur me Zotin. Dallimi i njerëzve në këtë pjesë, varet sipas meditim të tyre

13. Merjem, 46.

14. Merjem, 47.

lidhur me krijesat e Zotit në univers.

Profeti Muhamed (a.s.) çdo ditë shkonte në shpellën Hira dhe mendonte për veprat dhe shenjat e mëshirës së Allahut Fuqiplotë. E shikonte Qaben, vështronte thellë në dimensionet e qiellit e përkujtonte thellësitë e tokës, deteve, shkretëtirave, maleve dhe luginave. Kur i shihte gjithë këto madhështi, thellohej në mendime rreth fuqisë së paskajshme të Zotit. Në çdo gjë që shihte vërente urtësinë dhe madhështinë e pafundme hyjnore.

Tregon gruaja e tij, Hatixheja (r.a.): “...më pas ai (profeti) filloi të pëlqente vetminë, shkonte në shpellën Hira dhe adhuronte Zotin natën...”¹⁵

Transmeton Aishja (r.a.): Profeti (a.s.) u ngrit dhe filloi të falej. Gjatë këndimit të Kur'anit qante. Ra në ruku dhe qau, u ngrit prej saj dhe vazhdonte të qante. Ra në sexhde dhe qau, u ngrit nga sexhdja dhe qau. Vazhdoi të falej në atë formë, derisa erdhi Bilali për të thirrur ezanin e sabahut. Kur e pa duke qarë, Bilali e pyeti: “Çfarë të ka bërë të qash, o i dërguari i Allahut?!” Profeti (a.s.) ia ktheu: *“E si të mos qaj o Bilal, ndërkohë që sontë më janë shpallur këto ajete: “Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe*

15. Buhari, Bedju'l-Vahj, v. I, nr. 3.

që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) **“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit”**¹⁶. Pastaj, Profeti (a.s.) shtoi: *“I mjeri ai që i lexon dhe nuk mediton rreth tyre”*.¹⁷

Një numër i madh sahabesh i kanë dhënë rëndësi ritualit të meditimit duke treguar se ‘meditimi është drita e besimit’.

Kur Omer ibnu Abdul Aziz u pyet: “Cili është adhurimi më i mirë?” u përgjigj: “Të meditosh mbi krijesat e Zotit.”

Transmetohet nga Ibni Abasi se ai ka thënë: “Dy rekate të thjeshta, por me meditime, janë më të vlefshëm sesa falja gjithë natën, nëse zemra është indiferente”.¹⁸

Pendesa dhe vetëllogaria si fryt i meditimit

Pas kryerjes së një mëkati, njeriu e shkëput lidhjen me Krijuesin e tij. Kjo ndodh sepse krijesa po humb dashurinë e Krijuesit, sepse njeriu me mëkatin që bëri, hodhi një hap për t’iu larguar Allahut (xh.sh.). Mungesa e vëmendjes dhe nënvleftësimi i gjynaheve është mëkati më i madh... Parë në këtë këndvështrim, nuk

duhet të harrojmë dhe duhet të jemi të vëmendshëm që, nëse bëjmë një gjynah, të mos vazhdojmë të bëjmë të dytin... sepse gjynahu është si shkëndijë dëmtuese, që ndërpret lidhjen e njeriut me Zotin dhe është një goditje e rëndë për besimin. Madje, në këtë pikë, Said Nursi thotë se *“brenda çdo gjynahu ka një rrugë që të çon në mohim”*. Për rrjedhojë, njeriu duhet të bëjë teube sa më parë, duke ndjerë brenda vetes një pendesë të sinqertë. Nëse gjynahu është një shformim në krijim, pendimi dhe pendesa janë rikthim në origjinalin e krijimit.

Gjynahu duhet ndjerë në shpirt si një ankth, ndërsa ndërgjegjja duhet të ndjejë urrejtje, neveri dhe përbuzje ndaj atij gjynahu. Nëse njeriu nuk shqetësohet e nuk vuan për shkak të gjynahut, edhe sikur ta shprehë me gojë si rutinë, kjo lloj pendese nuk është pendesë, ajo mbetet thjesht një varg fjalësh të padobishme. Siç thotë edhe Profeti (a.s.): *“En-nedmu (en-nedametu) teubetun* - Ndjenja e pishmanllëkut, shenja e pendesës, *në vetvete, është teube”*.

Kur ne dalim prej rrugës së Tij, Zoti na i mbyll të gjitha dyert e kalimet nga të cilat Ai sheh kah ne. Por kur ne ndjejmë pendesë dhe fillojmë të marrim në llogari veten tonë e themi: Pse e bëra këtë? Pse veprova kundër urdhëresave të Krijuesit tim? Kjo do të thotë që ne filluam ta korrigjojmë veten dhe, sapo të fillojmë të meditojmë mbi

16. Al ‘Imran, 190-191

17. Sahih Buhari, nr. 4569; Sahih Muslim, nr. 763.

18. Isbahani, Kitabu’l-Adhame, v. I, f. 297, nr. 42.

këtë gjë, sapo nisim të angazhohemi nën shtypjen e ndjenjës së pendesës, menjëherë shohim se kanë nisur të hapen të gjitha “portat e dritaret”.

Shkurt, nëse ne mbajmë lidhje të vazhdueshme me Zotin tonë, edhe Ai nuk do të na braktisë në dorë të djallit, të armikut tonë. Personit, i cili e rinon vazhdimisht lidhjen me Zotin e vet me anë të meditimit, djalli nuk gjen dot rrugë për t’i shtënë dyshim e lëkundje. Për këtë arsye, duhet të kërkojmë rrugët për rinovimin e vetes. Kjo mund të bëhet disa herë me anë të meditimit, disa herë me anë të mendimit për vdekjen, disa herë me anë të leximit, disa herë duke kënduar Kur’an... Nuk ka ndonjë kufi për këtë gjë, por ne kemi shumë nevojë për këtë, po aq sa kemi nevojë për ajrin, ujin dhe bukën.

Në botën e tij të brendshme,

njeriu është një krijesë që ka nevojë të emocionohet çdo ditë, madje disa herë në ditë. Parë në këtë këndvështrim, detyra jonë në këtë mes është të mos rrimë larg shokëve të mirë, sepse shoku i mirë, në çdo kohë, me këshillat dhe porositë e tij të dobishme, mund të na zgjojë emocione dhe të na e ngrejë zemrën peshë.

Në çdo kohë, lutja jonë, me të cilën i drejtohem Allahut, duhet të jetë që të na mbrojë nga e keqja e egos dhe e djallit, në mënyrë që të mund ta vazhdojmë jetën në atmosferën e mirësisë hyjnore. Njëkohësisht lusim Allahun (xh. sh.), që nëpërmjet meditimit, t’i kuptojmë dhe t’i konceptojmë mirë, në pikëpamje shumëdimensionale, mesazhet e Islamit dhe, duke i përfaqësuar në mënyrë dinjitoze, të fitojmë kënaqësinë e Krijuesit tonë.

Kurora mbi krye të përunjur

Fatos A. Kopliku, MS/MA
Washington, DC

Abstrakt

Historiani më i madh amerikan i religjioneve Huston Smith, i cili ndërroi jetë para pak ditësh, hyrjen e kapitullit mbi Islamin te libri, tashmë klasik, “Religionet e Botës: Traditat e Tona Madhore të Urtësisë” e fillon, siç shprehet ai vetë, me një “anomali”: “Nga të gjitha religjionet jo-perëndimore, Islami është më i afërti ndaj Perëndimit – nga ana gjeografike, dhe ideore; ndodhet në familjen abrahamike të feve dhe nga ana filozofike i zhvilloi idetë e grekëve (të lashtë)”. Megjithatë, - thotë Smith -, për Perëndimin Islami është më i vështiri të kuptohet, në përputhje me përvojën, e cila ironizisht na mëson se afria nuk garanton mirëkuptim. Numri më i madh i grindjeve ndodh brenda vetë familjeve. Islami e Perëndimi janë fqinj, - vazhdon Smith -, e si rrjedhojë kanë ndarë kufij, çka u ka hapur rrugë shpesh ngatërresave e luftërave. Nëse ndjekim narrativin e Smith-it, ne shqiptarët nuk jemi një, por një nga kufijtë shekullorë mes Islamit e Perëndimit. Kufijtë me të vërtetë bëhen kollaj burim konfliktesh, por edhe aq kollaj mund të shndërrohen në ura mes atyre që i ndajnë, mjafton të jenë të pranishme dëshira dhe përpjekja e singërtë.

Në këtë shkrim dëshirojmë të krabasojmë një aspekt thelbësor mes Islamit e Krishterimit, religjionit, që më shumë se çdo gjë, ka latuar, në mos krijuar, Perëndimin. Ky krabasim është mes Shën Marisë dhe Profetit Muhammed ﷺ, dhe besojmë se ndihmon në ndërkuptimin mes dy religjioneve pasi është i llojit thelbësor, e si i tillë shmang rrezikun e ngujimit në sipërfaqësoren, rrjedhojë e natyrshme e theksimit të tepruar të krabasimit formal. Gjithashtu, një krabasim i këtij lloji i kundërvibet pretendimit modern se larmia e formave në fë është dëshmi e sajimeve njerëzore e rrethanore, diçka që shpesh u serviret studentëve si fakt i kryer, mbështetur e ilustruar me krabasime sipërfaqësore.

Krahasimi është i mundur, patjetër, mes Profetit të Islamit ﷺ dhe Krishtit, Kur'anit dhe Ungjillit, shoqërisë hebraike në sundimin romak në shekullin e I-rë dhe asaj fisnore arabe gjashtë shekuj më vonë, e kështu me radhë. Mirëpo këto krahasime, edhe pse pa diskutim me vlerën e vendin e tyre, nuk do ta meritonin plotësisht të queshin 'thelbësore', sepse përqendrohen te dukuritë sipërfaqësore, të dukshme, që i përkasin formës. Lëvozhga e dukurive dhe e kontingjencave për nga vetë natyra e gjërave e fsheh thelbin, por në të njëjtën kohë edhe e mbron atë. Thelb që mund të mbijetojë pa lëvozhgë nuk ka.

Historiani më i madh amerikan i religjioneve Huston Smith, i cili ndërroi jetë para pak ditësh, hyrjen e kapitullit mbi Islamin te libri, tashmë klasik, “*Religjionet e Botës: Traditat e Tona Madhore të Urtësisë*” e fillon, siç shprehet ai vetë, me një “anomali”: “Nga të gjitha religjionet jo-perëndimore, Islami është më i afërti ndaj Perëndimit – nga ana gjeografike, dhe ideore; ndodhet në familjen abrahamike të feve dhe nga ana filozofike i zhvilloi idetë e grekëve (të lashtë)”. Megjithatë, - thotë Smith -, për Perëndimin Islami është më i vështiri të kuptohet, në përputhje me përvojën, e cila ironikisht na mëson se afria nuk garanton mirëkuptim. Numri më i madh i grindjeve ndodh brenda vetë familjeve. Islami e Perëndimi janë fqinj, - vazhdon Smith -, e si rrjedhojë kanë ndarë kufij, çka u ka hapur rrugë shpesh ngatërresave e luftërave.¹ Nëse ndjekim narrativin

e Smith-it, ne shqiptarët nuk jemi një, por një nga kufijtë shekullorë mes Islamit e Perëndimit. Kufijtë me të vërtetë bëhen kollaj burim konfliktesh, por edhe aq kollaj mund të shndërrohen në ura mes atyre që i ndajnë, mjafton të jenë të pranishme dëshira dhe përpjekja e sinqertë.

Në këtë shkrim dëshirojmë të krahasojmë një aspekt thelbësor mes Islamit e Krishterimit, religjionit, që më shumë se çdo gjë, ka latuar, në mos krijuar, Perëndimin. Ky krahasim është mes Shën Marisë dhe Profetit Muhammed ﷺ, dhe besojmë se ndihmon në ndërkuptimin mes dy religjioneve pasi është i llojit *thelbësor*, e si i tillë shmang rrezikun e ngujimit në sipërfaqësoren, rrjedhojë e natyrshme e theksimit të tepruar të krahasimit formal. Gjithashtu, një krahasim i këtij lloji i kundërvihet pretendimit modern se larmia e formave në fé është dëshmi e sajimeve njerëzore e rrethanore, diçka që shpesh u serviret studentëve si fakt i kryer, mbështetur e ilustruar me krahasime sipërfaqësore.

Krahasimi është i mundur, patjetër, mes Profetit të Islamit ﷺ dhe Krishtit, Kur'anit dhe Ungjillit,

1. Huston Smith, *The World Religions: Our Great Wisdom Traditions* (San Francisco: Harper Collins, 1991), f. 221. Kjo enciklopedi ka shitur mbi dy milionë kopje anembanë botës.

shoqërisë hebraike nën sundimin romak në shekullin e I-rë dhe asaj fisnore arabe gjashtë shekuj më vonë, e kështu me radhë. Mirëpo këto krahasime, edhe pse pa diskutim me vlerën e vendin e tyre, nuk do ta meritonin plotësisht të quheshin ‘thelbësore’, sepse përqendrohen te dukuritë sipërfaqësore, të dukshme, që i përkasin formës. Lëvozhga e dukurive dhe e kontingjencave për nga vetë natyra e gjërave e fsheh thelbin, por në të njëjtën kohë edhe e mbron atë. Thelb që mund të mbijetojë pa lëvozhgë nuk ka.

Pse është thelbësor? Siç e kemi shpjeguar më në detaj në një shkrim të mëparshëm², në Islam Kur’ani, Fjala e Zotit, vjen si libër, ndërsa në Krishterim Fjala e Zotit është Krishti që “u bë mish e erdh ndër ne” (Gjoni 1:14). Nga ky këndvështrim rrjedh natyrshëm krahasimi mes Profetit Muhammed ﷺ dhe Shën Marisë, si marrësit e Fjalës Hyjnore. E nënvizojmë se krahasimi nuk është në rolin e Profetit si legjislator, burrë shteti, apo strateg ushtarak, role këto me natyrë të jashtme, jo të brendshme. Në këtë pikë Profeti i Islamit ngjason me profetët e Dhiatës së Vjetër, ose me avatarin Krishna në Hinduizëm. Edhe mes Krishtit e Profetit, paqja qoftë mbi ta, ka pikëtakime thelbësore, por

është temë që kërkon trajtim më vete.

Pse krahasimet formale kanë kufizime? Marrim për shembull fjalët ‘bukë’ në shqip dhe ‘book’ në anglisht. Për nga shqiptimi, të dyja tingëllojnë gati njëllor, por kuptimi është krejt tjetër. Në anglisht ‘book’ do të thotë libër, por është fjala ‘bread’, që edhe pse tingëllon krejt ndryshe nga fjala ‘bukë’ në shqip, bart në fakt të njëjtin kuptim. Ose, nëse topi përfundon në rrjetë në një lojë futbollit zakonisht do të thotë gol dhe avantazh, por nëse përfundon në rrjetë në një set voleybollit do të thotë pikë për kundërshtarit. Ç’lidhje ka, mund të thotë dikush, krahasimi i shqiptimit të fjalëve në gjuhë të ndryshme, apo i rrjetave në futboll e voleyboll, me religjionet? Larmia e formave është e gjithëpranishme, qoftë në gjuhë, në sport, art, arkitekturë, në raca, në qytetërime... e doemos edhe në religjione. Do të ishte i çuditshëm pretendimi se këto të fundit bëjnë përjashtim në këtë pikë. Shembujve të mësipërm mund t’u shtohen të tjerë, që tregojnë se përqendrimi te krahasimet formale mund të na çojë lehtësisht në keqkuptim, duke na e penguar depërtimin te thelbësorja. Trëndafil (kuptimi) nuk mund të këputet nga germat t, r, ë, n, d, a, f, i, l (forma), siç thotë Mevlânâ Xhelâledîn Rumîu (vd. 1273).³ Sidoqoftë, parimisht

2. Fatos A. Kopliku, “Fjalë e Zbritun, Gjuhë e Naltsueme”, *Zani i Naltë*, nr. 16 (169), verë 2016, ff. 30-44. Po ashtu, në Judaizëm p.sh., Fjala vjen si libër.

3. *Mesnevî*, shqip. Mithat Hoxha (Shkup: Logos-A, 2010), Libri I, 3455.

kuptimet s'para shterohen nga format që i manifestojnë. Duke pasur parasysh këtë, edhe krahasimi mes religjioneve sjell më tepër mirëkuptim e ndërvlerësim, kur format nuk merren si kriteret e vetme, e as si pikënisje, por kuptimi e thelbi që ato bartin.

Dritë nga drita që hedh ti

Kur kryengiëlli Gabriel (Xhebrail) i sjell lajmin Virgjëreshës, ajo e pyet se si mund të mbesë shtatzënë përderisa “nuk njeh burrë”,⁴ ndërsa Profeti ﷺ urdhrit të Xhebrailit që të lexojë (*ikra*) i përgjigjet “nuk di të lexoj”⁵; pra, është i paprekur nga dija njerëzore, i pamësuar (*ummi*).⁶ Ç'do të thotë kjo ngjashmëri?

Një kartë e bardhë është vetiu “ftesë” për njeriun të

shpalosë mendimet e talentet e tij. Afërmendsh, kushdo do të ngurronte të shkruajë shkrim përmbi shkrim – fjalët humbin qartësinë dhe autorësia megjulohet. Nëse shkrimet mbi kartën e shpirtit tonë janë diktuar nga cytjet e dëshirat e egos, atëherë aty nuk mbetet “ftesë” për shkrimin e hirit Hyjnor (*barakah*).⁷ “Dlirë shpirtin, o ti miku besëdëlirë, Që kështu të gjes pastaj të Zotit hirë!”, thotë Naimi ynë.⁸ Rumīu rrëfen historinë me artistët grekë e ata kinezë, që garojnë se kush krijon dhomën më të bukur. Kinezët krijojnë një dhomë të mrekullueshme me qindra forma e ngjyra, me dragonj e feniksë, ndërsa grekët lëmojnë muret aq sa bëhen pasqyrë e reflektojnë mrekullueshëm format dhe ngjyrat e mjeshtërve kinezë. Kësisoj, vazhdon Rumīu, një shpirt i dëlirë, një zemër e qëruar, kthehet në pasqyrë, që fton drejt saj bukuritë e Emrave Hyjnorë. Sado e fortë të jetë drita, ajo nuk mund të pasqyrohet nga një pasqyrë e nxirë.⁹

Edhe pse dëlirësia e marrësit të Fjalës Hyjnore qëndron në rang sipëror, në thelb parimi mbetet i njëjti. Vlen të përmendet se, sipas burimeve tradicionale myslimane, kur Profeti ﷺ ishte fëmijë, dy

4. Luka 1:34; shih edhe Kur'ani 19:20.

5. Shih Martin Lings, *Muhammedi: Jeta e tij sipas burimeve më të hershme*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Shkup: Logos-A, 2011), kreu XV. Në fakt fjala “recitoj”, “këndo”, e “lexoj”, në shoqëritë paramoderne janë pothuajse e njëjta gjë. Leximi pa rimë e melodi ishte diçka e pazakontë. Në shqip një jehonë e zbehtë e kësaj kohe akoma ruhet sepse “shkrim e këndim” do të thotë “shkrim e lexim”, që tregon se këndimi e leximi janë e njëjta gjë; diçka e natyrshme kjo për shoqëritë paramoderne ku historia e njeriut është në gojën e rapsodëve e poetëve. Divorci i këtyre fjalëve është një dukuri e vonë.

6. Term që haset disa herë në Kur'an; 7:157, 3:20, 62:2.

7. Trajta në shqip (dhe turqisht) është *bereget*, dhe akoma ruan kuptimin e diçkaje që është më shumë se një e mirë materiale.

8. Poezia “Zoti” në *Ëndërrimet* (Tekhajjulât), shqip. Vexhi Buharaja (Tiranë: Fondacioni ‘Saadi Shirazi’, 2005).

9. *Mesnevi*, Libri I, 3466-3499.

engjëj ia hapën kraharorin e ia lanë zemrën me borë,¹⁰ një tjetër simbol i dëlirësisë. Sejjid Husein Nasr, profesor i Studimeve Islame në Universitetin “George Washington”, komenton kështu: “Profeti i Bekuar duhet të jetë i pamësuar për po atë arsye që Virgjëresha Marie duhet të jetë e virgjër. Përçuesi njerëzor i Mesazhit Hyjnor duhet të jetë i kulluar e i panjollësor. Fjala Hyjnore mund të shkruhet vetëm në rrasën e dëlirë dhe “të paprekur” të marrësit njerëzor. Nëse kjo Fjalë duhet të jetë trupore, dëlirësia simbolizohet nga virgjëria e nënës që lind Fjalën, e nëse duhet të jetë në formë libri, kullueshmëria simbolizohet nga natyra e pamësuar e personit të zgjedhur për ta shpallur këtë Fjalë mes njerëzve. Me kurrfarë logjike s’mund të hidhet poshtë natyra e pamësuar e Profetit, duke mbrojtur ndërkafq virgjërinë e Maries. Të dy simbolizojnë një aspekt të thellë të këtij misteri të shpalljes dhe, me t’u kuptuar kjo, nuk mund të pranohet njëri e të kundërshtohet tjetri.”¹¹

Nuk është e çuditshme që këto realitete të mohohen nga njerëz që mohojnë në parim shpalljet, profetësinë, Zotin... Çfarë është e çuditshme është mohimi i

profetësisë së Muhamedit ﷺ nga disa autorë të krishterë, shoqëruar nga sugjerimet se Kur’ani është sajim i tij, apo huazim nga të krishterët e hebrenjtë arabë që jetonin në Arabinë e asaj kohe. Po zbatuam këtë linjë arsyetimi, atëherë Krishti ka huazuar nga rabinët e lashtësisë, ose Moisiu nga priftërinjtë e Egjiptit të lashtë, e kështu me radhë. Kjo është në fakt mënyra se si shpjegohet nga shumë akademikë ateistë apo agnostikë realiteti i feve; një konglomerat huazimesh e sajimesh. Mirëpo, një i krishterë a hebre që e kupton realitetin e religjioneve metafizikisht e intelektualisht, s’mund të përdorë kesi arsyetimi arbitrar ndaj Profetit të Islamit, duke kursyer sakaq Krishtin apo Moisiun, pa njëfarë hipokrizie shpirtërore apo mospërputhjeje intelektuale. Nga pikëpamja tradicionale një profet nuk i detyrohet gjë kujt përveç Zotit. Dituria që ai merr nuk është nga librat, as nga mendimrrahjet me dijetarë, por është drejtpërdrejt shpalosje hyjnore që manifestohet përmes tij në rendin tokësor.

Natyrë e Zonjës së Papërlyeme dhe e Profetit Muhammed ﷺ si rrasa e dëlirë dhe “e paprekur” e marrësit njerëzor, në të njëjtën kohë, trupëzon aspektin e përsosurisë pasive e femërore,¹² dorëzimin e plotë ndaj

10. Lings, *Muhamediz*, kreu VIII.

11. Sejjid Husein Nasr, *Ideale dhe Realitete të Islamit*, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2008), ff. 57-58. Shih edhe Annemarie Schimmel, *Mystical Dimensions of Islam* (NC: The University of North Carolina, 1975), f. 218.

12. Për atë se si ky aspekt kozmologjik shpaloset në marrëdhëniet gjinore në Islam të shihet Sachiko Murata, *The Tao of Islam* (NY: State University of New York, 1992);

Vullnetit Hyjnor, duke shërbyer si pasqyrë e Tij. Këtu, “femëror” nuk duhet kuptuar si epitete biologjik e gjinor, por parimor. Çdo njeri, burrë apo grua, bart parimin mashkullor e femëror në vetvete; *jīng* dhe *jang*, *mysterium tremendum* e *mysterium fascitans*¹³, apo *xheṭāl* e *xhemāl* sipas kozmologjive të Lindjes së Largët, Krishterimit dhe Islamit, përkatësisht. Shpirti i Shën Marisë dhe i Profetit të Islamit ﷺ ishin kupa e zbrazët në të cilën u derdh nektari i Fjalës Hyjnore, fyelli, të cilit Bariu i ra, duke sjellë Meloditë Qiellore në tokë, karta e bardhë mbi të cilën Zoti vendosi të shkruajë Fjalën e Tij...

Profeti ﷺ shpesh e quante veten ‘*abdAllah*, që do të thotë “shërbëtor” ose “rob i Zotit”.¹⁴ Kujtojmë se ngjyrosja pozitive e togfjalëshit ruhet plotësisht në shqip; një njeri “rob Zoti” është pa dyshim për t’u marrë shembull e admiruar, pasi ai që është rob i Vullnetit të Tij s’mund të jetë rob i egos së vet, e si rrjedhojë është i çliruar nga teprimet e kapriçot që karakterizojnë manifestimet e saj. As nuk është e rastësishme renditja e fjalëve në formulën e dëshmimit

(*shehādeti*): “Dëshmoj se nuk ka zot veç Zotit, dhe Muhamedi është shërbëtori (*abd*) dhe i dërguari (*resūl*) i Tij”. Një i dërguar i Zotit s’mund të jetë i tillë pa qenë më parë shërbëtor i Tij. Kjo është e logjikshme: nuk ndodh që një mbret të emërojë si zëdhënës të vetin një rebel.

Në një hadith të njohur, Profeti a.s. thotë se “tri gjëra nga bota juaj më janë bërë të denja për dashuri (*hubbiba ilejja*): gratë, parfumet, ndërsa freskinë e syve e kam në namaz.” Prapë, renditja është domethënëse nëse lexuesi i kushton vëmendje gjuhës së simboleve në përgjithësi dhe perspektivës islame në veçanti. Frithjof Schuon, një figurë e rëndësishme intelektuale dhe shpirtërore e shekullit të kaluar, thotë se, kur flet për gratë, Profeti ﷺ flet për natyrën e vet të brendshme, përsosurinë e dëlirësisë. Ndërkohë, parfumet përbëjnë aromën që rrezaton nga kjo përsosuri, ndjesinë ndaj të shenjtës, harmoninë, freskinë dhe hirin hyjnor (*barakah*). Kurse namazi, adhurimi, nuk është tjetër veçse “përkujtim i Zotit” (*dhikr*), që në vetvete përbën arsyen themelore të çdo dashurie të mundshme, përderisa është dashuria për Burimin e çdo gjëje.¹⁵

15. Tayeb Chouiref, *The Spiritual Teachings of the Prophet ﷺ: Hadith with Commentaries by Saints and Sages of Islam*, trans. Edin Q. Lohja (KY: Fons Vitae, 2011). Shih edhe Frithjof Schuon, *Dimensions of Islam*, trans. P. N. Townsend (Lahore: Suhail Academy, 1970), kreu VII.

si dhe Zailan Moris “Matanë velit: vështrimi sufi i grave dhe i feminitetit”, në *Islami, fundamentalizmi dhe tradhëtimi i Traditës*, ed. Joseph E. B. Lumbard, shqip. & par. Edin Q. Lohja (Shkup: Logos-A, 2016), kreu VII.
13. Shih veprën nga teologu i shquar gjerman Rudolph Otto, *The Idea of the Holy*, trans. John W. Harvey (Oxford University Press, 1958).

14. Shih *Sahīh al-Bukhārī*, nr. 3445.

Në psikologjinë tradicionale islame, shpjegon autorja Zailan Moris, “shpirti është mashkullor ndërsa vetja femërore. Në gjuhën arabe, *er-rūh* është emër i gjinisë mashkullore, ndërsa *en-nefs* i femërores. Shpirti është dielli mikrokozmiq, simboli i Intelektit hyjnor, ndërsa vetja është hëna mikrokozmiqe, simboli i Vetes hyjnore.”¹⁶ Sipas Profetit ﷺ, përmendja e Zotit (*dhikër*) është mënyra e pastrimit të zemrës¹⁷, që e kthen atë në pasqyrë, në një hënë që rrezaton dritën e Fjalës Hyjnore. Nuk janë të rastësishme përshkrimet e shokëve të Profetit ﷺ që krahasojnë çehren e tij me atë të një hëne të

16. Moris në *Tradhëtimi i Traditës*, kreu VII. Kujtojmë se botëkuptimi klasik e sheh njeriun të përbërë nga shpirti-*rūh*, vetja-*nefs* dhe trupi-*xbism*, që përkojnë me termat *pneuma*, *psike* dhe *hyle* në greqisht, ose nga *intelektus*, *anima* dhe *corpus* në latinisht. Zoti është edhe Absolut edhe I Pafundmë, Madhështia (*el-xhelāl*) e Bukuria (*el-xhemāl*). “Në natyrat e tyre të kryehershme, burri dhe gruaja janë simbole pozitive të Zotit. Absolutshmëria dhe Madhështia e Zotit pasqyrohen më drejtpërdrejt nga burri, ndërsa Pafundësia e Bukuria hyjnore nga gruaja. Trupi mashkullor shpreh Transcendencën, ndërsa femërori Imanenten. Burri i Kryehershëm është simboli i Zotit të tij, ndërsa gruaja simboli i Mëshirës hyjnore. Megjithatë, që prej rënies së njerëzimit nga gjendja edenike në një çast harrese, çdo burrë është edhe rebel ndaj Perëndisë, uzurpuesi që synon të vërë veten në vendin e Zotit të tij, dhe çdo grua burimi i joshjes që shpërhap veten njerëzore dhe e tërheq larg nga soditja e Perëndisë.” Moris, *vep. cit.*

17. *Shu`ab el-imān*, 1:396, nr. 522.

plotë (*bedr*), dhe ndër më të njohurat përshkrime në botën islame gjendet në vargjet e himnit të mirëseardhjes së Profetit ﷺ në Medinë.¹⁸ Hëna e plotë është një simbol femëror i shpirtit në përsosurinë e vet pasive, çka na çon prapë te qasja e hadithit të lartcituar mbi natyrën e brendshme të Profetit ﷺ, krejt pasive ndaj Fjalës Hyjnore – *Ai nuk flet sipas dëshirës së vet*, thotë Kur’ani [53:3]. A thua është rastësi që në poezinë e tij “Hëna” Naimi i drejtohet asaj me këto vargje:

Ty nga Dielli të vjen dritëza e dëlirë

Kurse unë dritn’ e fshehtë kam përpirë

Mendja ime rreth e rrotull po të vjen tashti

Ndofta dritë gjën në dritën që hedh ti.¹⁹

Nga ana tjetër, Shën Maria thotë se fryma e saj “ngazëllon në Perëndinë... sepse Ai e shikon me pëlqim ultësinë e shërbëtores së Tij” (Luka 1: 47-48). Ashtu sikurse Profeti ﷺ është rob (*‘abd*) i Zotit,

18. “*Tala’a l-bedru ‘alejnā*” – “Hëna e plotë u ngrit mbi ne” thonë vargjet e para duke iu referuar të Dërguarit. Për krahasimet e Profetit me hënë e plotë shih p.sh. *Saḥīḥ al-Bukhārī* 3552, 3556. Shpirtirat e eulijave, po ashtu, krahasohen me hënë e plotë ngaqë ata konsiderohen njerëz të përsosur (*al-insān al-kāmil*), pasqyra të Emrave Hyjnorë.

19. Naim Frashëri, *Ëndërrimet (Tekhajjulat)*, shqip. Vexhi Buharaja (Tiranë: Fondacioni ‘Saadi Shirazi’, 2005).

para se të nderohet si i dërguar (*resul*) i Tij, po ashtu është kjo përulësi që e lartëson Virgjëreshën në “Mbretëreshë të mbretëreshave”, siç thotë Shën Alberti i Madhi²⁰. “Nanë virgjineshë... mbi çdo krijesë e prunjtë e madhështore”²¹, janë fjalët që Dante i vë në gojën e Shën Bernardit drejtuar Shën Marisë. Prapë, prunjësia – siç e ka shqipëruar mjeshtërisht Pashk Gjeçi – përulja ndaj Zotit, është ajo çka e madhëron. Sipas Himnit të Marisë (Luka 1:46-55) është Zoti Ai që lartëson të përulurit (*et exaltavit humiles*). Të kihet parasysh se bëhet fjalë për një përulje të virtytshme, për një shfaqosje të vullnetshme karshi Zotit, për një varfëri shpirtërore. “I varfër” është kushdo që s’ka dëshira, pra nuk është rob i tyre, “i pasur” është kushdo që i ka ato; dëshirë për pushtet, famë, pasuri... Kur Krishti thotë se “është më lehtë të përshkohet deveja nëpër vrimë të gjilpërës se i pasuri të hyjë në Mbretërinë e Hyjit” (Mateu 19:24) bëhet fjalë, pikësëpari, për pasurinë e dëshirave, jo vetëm atë materiale, përndryshe s’do të kishim kurrë raste monarkësh apo fisnikësh, profetë a shenjtorë.

Në kohët e sotme ka një

20. St. Albert the Great, Mariale, CLXII, 13-14 (Collection *Les Maîtres de la Spiritualité chrétienne*, trans. Albert Carreau, Paris 1942). Cit. nga *The Essential Titus Burckhardt*, ed. William Stoddart (IN: World Wisdom, 2005), ff. 125-126.

21. *Komedia Hyjnore*, përkth. Pashk Gjeçi, Kanga XXXIII.

keqinterpretim të theksuar të lirisë, e cila nënkupton lirinë për të ndjekur dëshirat, lirinë për të bërë çfarë të duam. Por, në fakt, nuk jemi ne që zotërojmë dëshirat, por janë vetë ato që na prangosin e na bëjnë rob të tyre. Bindja ndaj normave e udhëzimeve Hyjnore na fton të çlirohemi nga dëshirat e t’i përshtatemi natyrës së gjërave ashtu siç janë e jo siç duken. Nuk mund të akuzohet një atlet se nuk është i lirë të pijë duhan, apo të zgjohet a flejë kur të dojë. Ndjekja e regjimit, disiplinës i jep lirinë për kryerjen e maratonës. Liria e duhanpirjes për një maratonomak do të thotë mbetje në mes të rrugës, mosarritje në finish... Po liritë që serviren sot si vlëra, ç’efekt kanë vallë për maratonën e shpirtit tanë?

Tashmë, duhet të jetë e qartë përse ultësia e shërbëtorisë janë cilësi, parakusht qoftë për Virgjëreshën, qoftë për Profetin ﷺ, për të qenë të denjë si bartës të Fjalës Hyjnore. Si rrjedhojë e shfaqosjes së tyre karshi Fjalës Hyjnore, natyra e brendshme e Profetit përkon me atë të Virgjëreshës së Shenjtë (*Batül*), sepse ashtu siç Krishti ishte brendësia e saj, po ashtu Kur’ani ishte natyra e Pejgamberit ﷺ. Marrëdhënia mes Nënës së Shenjtë dhe Fëmijës shpaloset qartë edhe në ikonat tradicionale, veçanërisht ato ortodokse, që njihen me emrin “Zonja Jonë e Shenjës”.²² Aty

22. Sipas vargut biblik: *Prandaj vet Zoti do t’ju japë një shenjë: Ja e virgjëra do të mbetet me*

Virgjëresha rri me fytyrë direkt përballë shikuesit, me pëllëmbët e duarve drejt qiellit në lutje, dhe medaljonin e Krishtit fëmijë në gjoks. Virgjëresha simbolizon shpirtin në dëlirësinë e vet të qëmotshme, ndërsa Fëmija është fara e Fjalës Hyjnore që është mbjellë në të.²³ Ndërsa, kur e pyeten Aishenë, gruan e të Dërguarit ﷺ, për karakterin e tij, ajo iu përgjigj: “Natyra e tij ishte Kur’ani”,²⁴ dhe asnjë ekzegjeti tradicional të Kur’anit s’i ka shpëtuar fakti se Kur’ani përshkruan veten, *Kur’an i Madhnueshëm (‘azīm)* [15:87], dhe natyrën e Profetit ﷺ, *Vërtet, ti ke një karakter të madhnueshëm (‘azīm)* [68:4], me të njëjtën fjalë.²⁵

barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel (Isaia 7:14).

23. Të shihet Titus Burckhardt, *Sacred Art of East and West*, trans. Lord Northbourne (Bedfont, Middlesex: 1967), ff. 70-74. Arti i ikonave të Krishtit e Shën Marisë për nga rëndësia krahasohet me kaligrafinë kur’anore, sepse Krishti është Fjala në Krishterim, ndërsa Kur’ani është fjala në Islam. Flasim për artin e ikonave sipas kanoneve tradicionale, në veçanti ato ortodokse, e jo imazhe natyraliste të Krishtit siç shihen në Perëndim gjatë Rilindjes e në vijim.

24. *Sahīḥ Muslim*, 746a; *Nisā’i*, 1601; *Aḥmed* 10, 25240.

25. Ky realitet i brendshëm i të Dërguarit të Zotit i njohur si “*Nūr Muḥammedī*” njehsohet me dritën e Fjalës Hyjnore nga ekzegjetë klasikë si ‘Umer ez-Zemakhsherī si referencë ndaj vargut kur’anor *Një dritë ka ardhë ndër ju prej Zotit* [5:15]. Shih komentimin e këtij ajeti në *The Study Quran: A New Translation and Commentary*, eds. Seyyed Hossein Nasr, Caner K. Dagli,

Një tjetër ngjashmëri është vendi ku Profeti ﷺ dhe Virgjëresha fillimisht vizitohen nga kryeengjelli. Në rastin e Pejgamberit ﷺ, i shqitur tërësisht nga jeta e përditshme, ai ishte në meditim jashtë Mekës në shpellën Hira. Ndërsa Shën Maria (Hazreti Merjem) rrinte e veçuar në adhurim të vazhdueshëm në një guvë-hijerore. Shpella ose guva tradicionalisht simbolizon zemrën²⁶, duke kthjelluar më tej lidhjen mes botës së brendshme dhe manifestimit të saj në atë të jashtme – përkujtimi i Zotit po ndodhte pikësëpari në zemër, dhe përkujtimi në guvë e shpellë ishte manifestim i atij realiteti të brendshëm. Pra mund të thuhet se Profeti i Bekuar ﷺ dhe Virgjëresha e Shenjtë e mirëpritën Fjalën e Zotit shpirtërisht në zemër e fizikisht në guvë. Theksojmë se, në kontekstin kur’anor, *mihraḥ* në xhami është simboli i guvës ku Virgjëresha e Shenjtë u tërhoq në *halvet*²⁷, duke përkujtuar Zotin, dhe ku kryeengjelli Xhebrail i solli

Maria Massi Dakake, Joseph E. B. Lumbard, Mohammed Rustom (Harpercollins, 2015).

26. René Guénon, *Fundamental Symbols: The Universal Language of Sacred Science*, trans. Alvin Moore, Jnr (Cambridge, UK: Quinta Essentia, 1991), ff. 145-147.

27. Trajta e mësipërme në shqip dhe turqisht vjen nga *khalva* në arabisht. Ajo është një disiplinë intensive shpirtërore përqendruar në adhurim, lutje, e përkujtim (*dhikr*), veçuar nga kontaktet me njerëzit. Mund të zgjasë nga disa orë, deri në disa ditë (me raste edhe 40 ditë). Është praktikë që haset në religione të ndryshme, jo vetëm në Islam.

lajmin. Ky simbol është i pranishëm në *Mibrabin Zekerijā* në Xhaminë Aksā të Jeruzalemit dhe në veçanti në mihrabet e xhamive osmane, duke filluar me atë të Aja Sofias, pasi shumë nga ata u stolisën me fjalët *sa herë Zekerijā hynte në hijerore*,²⁸ fragment nga vargu kur'anor [3:37] që i referohet kësaj ngjarjeje.²⁹

Shkurtimisht ia vlen të përmenden edhe dy pika thelbësore ngjashmërie, të cilat në fakt meritojnë trajtim në vetvete. Virgjëresha e Bekuar identifikohet edhe me Shën Sofian, personifikim i vetë Diturisë, i Urtisë, sepse sipas teologëve klasikë ajo e zotëron atë në sajë të përsosurisë së saj shpirtërore.³⁰ Është një përsosuri e tillë realiteti edhe pas thënies së njohur të Profetit ﷺ “Unë jam qyteti i diturisë, Aliu është porta e tij”,³¹ ku ai identifikohet me vetë diturinë. Dituria Hyjnore si objekt i njohjes ka një anë thelbësisht

femërore, në kuptimin më të lartë parimor, për arsye që i cekëm më lart. Gjithashtu, Kur’ani i drejtohet Profetit *Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët* [21:107], dhe një nga emrat me të cilët ai quhet është edhe *Miftah Rahmet Allah*, “Çelës i Mëshirës së Zotit”, ndërsa Virgjëresha njihet edhe si *Mater Misericordiae*, “Nënë e Mëshirës”.

Përfundime

Sinqeriteti për nga natyra nënkupton thellësi e kthjelltësi, e për këtë arsye autori beson se një dialog, për të qenë vërtet i tillë, nuk mund të përjashtojë sinqeritetin. Ka pak vlerë dialogu me myslimanë nëse *a priori* profetësia e Muhammedit ﷺ nuk njihet dhe Islami shihet si një konglomerat herezish e huazimesh, duke bartur kështu paragjykimet e keqinterpretimet shekullore, në veçanti të shprehura në veprat e akademikëve orientalistë.³²

28. *Kullema dakhala alejha Zekerijā*. Shih Patrick Laude, *Louis Massignon: The Vow and the Oath*, trans. Edin Q. Lohja (London: The Matheson Trust, 2011), ff. 36-37.

29. Shih Titus Burckhardt, *Arti i Islamit: Gjuba dhe Kuptimet*, shqip. Vehap S. Kola (Shkup: Logos-A, 2012), ff. 90-93.

30. *The Essential Titus Burckhardt: Reflections on Sacred Art, Faiths, and Civilizations*, ed. William Stoddart (IN: World Wisdom, 2003), f. 126.

31. Reza Shah-Kazemi, *Justice and Remembrance: Introducing the Spirituality of Imam ‘Alī* (NY: I.B. Tauris & Co. Ltd, 2006), f. 11, cit. nga al-Hākim al-Nīsābūrī, *al-Mustadrak ‘alā’-ṣaḥīḥayn* (Beirut, 2002), f. 929, nr. 4694.

32. Shih Edward Said, *Orientalism* (Pantheon Books, 1978); Enis Sulstarova, Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi tek Kadareja (Tiranë: Dudaj, 2007). Çfarë e komplikon çështjen edhe më tej në Ballkan është demonizimi në mënyrë institucionale i sundimit osman, i cili lidhet ngushtë me praninë e Islamit në këto troje. Ndryshe nga Islami që formoi një shtet, shoqëri, e qytetërim të vetin sapo zuri rrënjë, Krishterimi u lind gjatë sundimit romak dhe për tre shekuj u persekutua nga ky sundim. Trashëgimi e kësaj është një nevojë për të identifikuar pothuajse

Gjithashtu duhet të kuptohet se edhe pse murgëria, asketizmi, shqitja nga bota, janë karakteristika që hasen rëndom ndër profetë e shenjtore të feve të ndryshme, e në veçanti asaj të krishterë, ato nuk janë të vetmet e as të domosdoshmet. Një monark apo një luftëtar profet nuk përbën pamundësi, përndryshe nuk do të kishim Hz. Sulejman (Solomon) apo Hz. Dawūd (David), apo Krishna e Rama nëse konsiderojmë Hinduizmin, paqe qoftë mbi gjithë ata.

Nga ana tjetër, myslimanët *deri diku* e kanë më të lehtë pranimin e vlefshmërisë së religjioneve të tjera, dhe kjo kryesisht pasi Sheriati, ligji islam, urdhëron jo vetëm moscenimin, por edhe mbrojtjen e objekteve të kultit të krishtera në një shtet mysliman. Urdhëresat direkt apo indirekt përfshijnë edhe sinagogat, tempujt zoroastrianë, hindu, budistë, e me radhë.

domosdoshmërisht një shtypës, diçka e cila, nganjëherë, në Ballkan, merr intensitet të tillë sa harrohet Krishti e Zoti dhe duket se parakushti për të qenë i krishterë është urrejtja ndaj turkut shtypës. Sipas Schuon-it, prania e Islamit në Ballkan ka ruajtur në mënyrë providenciale Krishterimin nga elemente pagane të antikitetit jo plotësisht të neutralizuara në masa, të cilat, me Rilindjen e prapa, gradualisht gërryen jetën organike të krishterë në Perëndim, aq sa ky i fundit konsiderohet të jetë tashmë në epokën post-kristiane. Shih Frithjof Schuon, *Spiritual Perspectives and Human Facts*, trans. Mark Perry, Jean-Pierre Lafouge, James Cutsinger (IN: World Wisdom, 2007) ff. 68-69.

Kujtojmë se Profeti nuk bëri as edhe një lëshim për sa i përket politeizmit të arabëve dhe idhujt u shkatërruan pa asnjë kompromis duke filluar nga ata të Qabesë, por me përjashtimin shumë të rëndësishëm të ikonës së Virgjëreshës dhe Krishtit fëmijë, siç na tregon Azrakī.³³ Lista e gjatë e shembujve do të na largonte nga tema, por mund të themi se do të ishte absurde të mendohet se Zoti urdhëron ruajtjen e respektimin e religjioneve të tjera nëse këto janë pa vlerë.³⁴ Dëlirësia në qëllim e dituria janë udhërrëfyesit e besueshëm drejt njohjes e respektimit të këtyre vlerave.

Dialogu me traditat e tjera duket luks kur shihet një intolerancë pa precedent mes vetë myslimanëve

33. Al-Azrakī, *Akhbar Makka*, vol I, ff. 168-169, cit. nga eseja e G. R. D. King, "The Paintings of the Pre-Islamic Ka'ba" në *Muqarnas, Volume 21: Essays in Honor of J. M. Rogers*, ed. Gülru Necipoğlu, Doris Behrens-Abouseif, Anna Contadini (Brill, 2004), f. 223.

34. Shih *Universal Dimensions of Islam: Studies in Comparative Religion*, ed. Patrick Laude (IN: World Wisdom, 2011). Figura madhore si *Ṣalāḥ* ed-Dīn Ejjūbiu (v. 1193), çliruesi i Jeruzalemit, apo Emiri 'Abdul-Kādir (v. 1883), udhëheqësi i rezistencës ndal kolonializmit francez, e kanë zbatuar dhe jetuar këtë urdhëresë, dhe nëse sot ka disa që pretendojnë se Islami është i mbyllur ndaj dialogut, atëherë do të ishte hap i mirëpritur studimi i jetës e veprës së burrave të tillë. Shih të Reza Shah-Kazemi, "Nga shpirtshmëria e xhihād-it tek ideologjia e xhihadizmit", në Lumbard (ed.), *Tradhëtimi i Traditës*, kreu VI.

sot, ndërsa ymmeti islam është i rrethuar nga një mori sfidash politike, shoqërore, ekonomike. Sipas doktrinës islame, të metat thelbësore të njeriut janë harresa (*nisjān*) e shkujdesja (*ghafllet*), falë të cilave zë rrënjë injoranca, që është pa dyshim shkaku rrënjësor i sfidave që përmendëm më lart, pa harruar e zbutur aspak faktorët e jashtëm si kolonializmi apo makinacionet e shumëllojshme ndërhyrëse. Por është venitja, apo edhe harresa, e trashëgimisë intelektuale e shpirtërore që, si pasojë, ka sjellë një prirje për ta reduktuar Islamin në urdhëresa e ndalesa, në ritual, ndërsa faltoret në palestra ritualesh – diçka e pranishme edhe në religjione të tjera. Kjo është shoqëruar edhe me një mungesë respekti, njohjeje e tolerance ndaj formave tjera të religjioneve, përfshirë edhe larminë brenda vetë Islamit.

Mirëpo, besojmë se sot, dialogu mes feve është jo i nevojshëm, por i domosdoshëm. Për shekuj me radhë krahasimet mes religjioneve kanë qenë të panevojshme sepse çdo religjion ka qenë i mjaftueshëm për t'iu përgjigjur ithtarëve të vet, nga më të thjeshtit deri te më të sofistikuarit. Edhe sot, çdo religjion është po aq i mjaftueshëm, porse dikur bota e një feje të caktuar merrej si vetë bota, ndërsa me kontaktet e zgjeruara është shtruar çështja e feve të tjera...

Kjo larmi, siç e thamë, përdoret si argument kundër vlefshmërisë së

feve e vetë Zotit qoftë nga individë nën petkun e objektivitetit akademik, qoftë nga interpretime të cekëta personash, që kërkojnë të mbrojnë fenë e tyre, duke mohuar me çdo kusht të tjerat. E vërtetë, këta të fundit nuk e mohojnë direkt Zotin si të tillë, por i vënë kufij Pafundësisë e Fuqisë së Tij për të manifestuar Emrat e Tij e Rrugën drejt Tij në forma të ndryshme përveç asaj të fesë së tyre. Të dyja palët i mbështesin argumentet e tyre në ilustrime e krahasime sipërfaqësore. Por nuk mund të zhvillojmë amnezi selektive e të “çlirojmë” veten nga përgjegjësia për të respektuar fetë e tjera apo, edhe më keq, të hedhim baltë mbi to në emër të devotshmërisë. Krishti është “Udha dhe e Vërteta” (Gjoni 14:6), nëse marrim një shembull nga Bibla, por Udha dhe e Vërteta nuk është vetëm Krishti. Vetë Shën Agustini tregon se “ajo çka tani quhet fë e krishterë në të vërtetë njihet nga të lashtit, e as ka munguar ndonjëherë që nga fillimi i racës njerëzore, gjer kur erdhi Krishti vetë... e që atëherë fëja e vërtetë që kishte ekzistuar që më përpara filloi të quhet e krishterë.”³⁵ Kur’ani thotë se *po të donte, Zoti do t’ju kishte bërë një komb të vetëm, por deshi t’ju sprovovë në atë që ju dha, ndaj matuni me njëri tjetrin në punë të mira. Kthimi*

35. *The Retractions (The Fathers of the Church, Volume 60)*, trans. Sister Mary Inez Bogan (Catholic University of America Press, 1968), f. 52.

juaj është te Zoti, dhe Ai do t'ju tregojë të vërtetën në lidhje me dallimet tuaja [5: 48]. Shembuj e udhëzime të ngjashme, që nuk mungojnë aspak, duhet të jenë themelet e çdo dialogu.

Ekstremi tjetër është sinkretizimi *alla-new age* ku merren e arnohen bashkë copa doktrinash religjioze në emër të gjithëpërfshirjes, tolerancës, e paqes duke neglizhuar tërësisht format e një fëje, të cilat janë providencialisht të pazëvendësueshme në rangun e vet. Pavarësisht qëllimit të mirë, përpjekje të tilla thjesht dëmtojnë edhe më tej tërësinë e çdo religjioni autentik, pasi bazohen në sentimentalizma e jo në dituri dhe nuk mund të ndihmojnë në një dialog të frytshëm mes religjioneve. Prandaj, besojmë, dialogu duhet doemos të respektojë format, por

edhe të cekë thelbet³⁶ për t'ia zgjeruar kështu mundësinë drejtëkuptimit të ndërsjellë. Besojmë se ky shkrim mbi Virgjëreshën e Shenjtë e Profetin a.s. ofron kontribut sado modest në këtë drejtim dhe urojmë se do të ndiqet nga të tjerë. Shpresojmë se në të ardhmen dikush do të shkruajë një tjetër enciklopedi mbi religjionet e botës si prof. Smith, në të cilën kufijtë e Islamit e Krishterimit do të përmenden si vende urash, jo konfliktesh, e ato të hedhura nga shqiptarët myslimanë e të krishterë do të kenë patjetër vendin e nderuar e merituar mes tyre.

36. Dialogu në kësaj detajesh s'është domosdoshmëri për çdo besimtar, madje as nevojë. Në fakt shumë besimtarë në mënyrë intuitive e kuptojnë shpalosjen e së Vërtetës e Mëshirës në forma të ndryshme dhe u japin respektin e duhur besimeve dhe besimtarëve të tjerë.

Të Krishterët! Reflektim i një myslimani në kohë të trazuar!

**Ilir Akshija, M.D., M.Sc.
Qendra Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”,
Departamenti i Statistikës, Tiranë**

Abstrakt

Komshiu im i krishterë! Kjo shprehje mund të ketë qenë diçka jo e zakonshme për shumicën e myslimanëve për shekuj të tërë. Homogjeniteti brenda krahinave ka qenë i zakonshëm, madje edhe brenda të ashtuquajturave mëballa në sistemin osman të mileteve, ndërkohë që vija gjeografike e ndarjes së Islamit me Krishterimin ka qenë e lëvizshme dhe shpeshbërë një front i vërtetë lufte. Në një situatë të tillë, ndërveprimi në nivel individual i myslimanëve me të krishterët ka qenë, deri diku, i kufizuar. Rritja e mundësive dhe shpejtësisë në komunikacion së bashku me paqen relative të disa dekadave pas Luftës së Dytë Botërore ka sjellë lehtësimin e tejkalimit të distancave të largëta dhe rritjen e numrit të kontakteve ndërmjet banorëve të të gjithë planetit. Myslimani dhe i Krishteri jetojnë dhe punojnë në të njëjtin ambient, dhe në hapësirën kibernetike ky fenomen është i paprecedent në histori. Diferenca e zgjedhjes së përkatësisë fetare në një ambient të qytetëruar është e pamundur të neglizhohet ndërkohë që situatat globale nuk janë të qeta. Respektimi i besimeve reciproke kërkon minimalisht njohje reciproke dhe gjithashtu duhet të diben disa kufij që duhen respektuar patjetër dhe kufij të tjerë që janë subjekt diskutimi të vazhdueshëm. Diskutimet ndërfetare janë në njëfarë mënyre domosdoshmëri, sepse mbyllja në vete dhe ekzistenca paralele pa komunikim mund të çojë në keqkuptime, që do të zgjidheshin menjëherë nëpërmjet njohjes së tjetrit. Ky diskutim është aktual në nivel global, në nivel liderësh fetarë dhe patjetër në nivel individual në përditshmërinë tonë.

Fjalë kyçe: Mysliman, i Krishterë, bashkëjetesë, tolerancë, njohje, kufij.

Skenari i parë, është skenari i luftës dhe përpjekja për ti nënshtruar. Gjatë zbatimit të këtij plani mund ta humbasim luftën dhe të nënshtrohemi, por ne nuk e kemi problem, sepse qëllimet tona janë aq të larta sa që rënia dëshmor ose fitorja janë alternativat e mundshme.

Skenari i dytë, është skenari i bindjes. Ne nuk kemi nevojë për luftë. Bota ka arritur në një stad të tillë civilizimi që lufta duhet tejkaluar. Arma jonë madhështore është bindja sepse edhe argumentet tona janë hyjnore dhe ne jemi njerëzit e duhur për ti transmetuar.

Këta mund të jenë dy skenarë ekstremë, që mund të imagjinohen në përballjen e myslimanëve me fqinjët e tyre të krishterë. Të dy janë skenarë të padrejtë dhe utopikë, pavarësisht se ka njerëz që flasin për to në formën e tyre të pastër, nuk mendoj se i besojnë plotësisht. Skenari i parë zgjedh luftën si të vetmen mundësi për të transmetuar të vërtetën, një metodë kjo krejt e ndryshme me atë të profetit Muhamed (a.s.), dhe e dyta është utopike e madje mendjemadhe, sepse udhëzimi nuk varet nga thirrësi por nga Allahu (xh. sh.), ndërkohë që gjërat nuk mund të jenë më mirë edhe se në kohën e profetit (a.s.).

Por paraseti drejtohem të tjerëve për ti këshilluar a mund të gjykojmë për dobësitë e myslimanëve të sotëm. Injoranca, varfëria dhe përçarja, janë

tre armi të supozuar, dhe këto, jo vetëm për myslimanët.¹ Këto tre tema në Islam janë të mirënjohura. Lufta kundër varfërisë ekstreme është një nga rekomandimet bazë të Islamit dhe madje shikohet edhe si rrezik potencial për *kufër*. Ndërkohë që, lufta e Islamit me injorancën është totale, madje duke e quajtur periudhë të injorancës kohën para shpalljes së Kur'anit. Gjithashtu rreziku i përçarjes së Ymetit të Muhamedit (a.s.) ka qenë i pranishëm që në shekujt e parë të Islamit, duke nxjerrë si imperativë të përhershme dallimin e interpretimeve serioze dhe të dobishme nga ato të rrezikshme dhe qëllimkëqija.

Po e filloj nga e treta. Atëherë, le të fillojmë numërimin e përçarjeve brenda rrezes së Islamit vetëm në Shqipëri. Përcaktimet nga grupe të ndryshme fillojnë nga ndarja syni dhe shia, sipas medhhebeve, në grupacione sipas tarikateve, selefistë, vehabistë, pro shteteve të caktuara, pro personave të caktuar, pro filozofive të caktuara dhe plot *pro* të tjera. I rreshtova në mënyrë të rastësishme si më erdhën në mend pa i përmendur të gjithë dhe pa i klasifikuar sipas vendosjes në spektrin e veprimit dhe mendimit, jo nga pamundësia, por që të mos i jap mundësi as vetes të paragjykoj në mënyrë të organizuar. Aspekti tjetër është injoranca, e cila nuk është

1. Gylen M. Ese, Perspektiva, Opinione. Tiranë: Prizmi; 2008, 130.

e matshme por di të them që në Tiranë, ka jo më shumë se dy librari me literaturë fetare për publikun. Nuk mund të them për konsumin e literaturës fetare dhe informacionit që njerëzit marrin, sepse ka burime të tjera si literatura e shkollave dhe shkarkimet nga interneti. Gjithashtu ka një mori videosh nga 3-10 minuta në *YouTube*. Gjithsesi fakti që ka kaq pak librari në një prefekturë me rreth 750.000 banorë si Tirana është një tregues serioz, sidomos po të merret guximi të krahasohet me numrin e personave që janë praktikantë të rregullt të Islamit. Meqenëse për të përshkruar injorancën dhe përçarjen zgjedha Shqipërinë, pavarësisht se, as nuk mund të vlerësohet në pak rreshta, dhe as nuk kam të drejtë të drejtoj gishtin, e njëjta situatë duket se është gjithandej. Më tepër qëllimi është të marrja e guximit për ti pranuar si dobësi në një kohë që do të vendosesh përballë perëndimit të shkolluar dhe deri diku të bashkuar.

Disa prej diversiteteve brenda Islamit janë pasuri, ndërkohë që disa të tjera janë përçarje e pastër e ndodhur nga padija, ose e instaluar me qëllim të keq, por prapë në një ambient ku mbizotëron padija. Një gjë është të akuzosh myslimanët për dështimin e tyre dhe një gjë krejt tjetër është të përpiqesh të identifikosh zërat përçarës, që zgjedhin injorancën si kontingjentin më të mirë në të cilin mbështeten për të mbytur, shpesh jo vetëm në

mënyrë figurative, zërat e së vërtetës brenda këtij komuniteti. Prandaj e quaj të arsyeshme të bëj këtë dallim me rëndësi. Këto fatkeqësi potencialisht mund ti prekin.

Ndërkohë që po të kalojmë tek aspekti ekonomik, disa të dhëna do të flisnin më së miri. Po të shikojmë popullatën myslimane në botë nuk mund të zbulohet lehtë situata e tyre ekonomike. Zakonisht mediat e përqendrojnë vëmendjen e tyre në zonat me evenimente, që të tërheqin vëmendjen e publikut dhe rrisin shikueshmërinë dhe aty ku paguhen të fokusohen. Mbretëria e Arabisë Saudite, si vend ku ndodhet Meka dhe Medina, është gjithmonë në fokus të informacioneve, pa harruar pasuritë e saja natyrore dhe gjeopolitiken. Por ky vend ka vetëm disa milionë banorë dhe, pavarësisht rëndësisë së padiskutueshme, për nga popullata nuk krahasohet me vende të tilla si Bangladeshi ku jetojnë 147,4 milionë myslimanë. Por sa është raporti i informacionit që marrim zakonisht për të gjithë këta njerëz në raport me bombardimin e përditshëm me fotot e mrekullueshme të Dubait, Emiratet e Bashkuara Arabe?! Pothuajse nuk merret asnjë informacion. Pak rëndësi ka në diskutimin tonë arsyeja e këtij disproporcioni në informim, rëndësi ka që një grumbull kaq i madh myslimanësh jetojnë në një vend ku GNI (per capita) është 780 USD në vit dhe ka një normë alfabetizimi tek të rriturit prej 56.8%.

Tabela në vazhdim dhe paraqitjet grafike bëjnë një përmbledhje të disa të dhënave për 10 vendet me popullsi më të madhe myslimane në botë dhe krahasohet vetëm një indikator ekonomik, GNI (gross national income) per capita 2011, me 10 vende të tjera ku janë futur të gjithë anëtarët e G8-s dhe Spanja me Izraelin. Janë zgjedhur këto vite për të dhënat për arsye se referencat janë më të mirat ndërkohë që të tjerat janë zakonisht projeksione. Nga paraqitja grafike është përjashtuar India për arsye se numri shumë i lartë i popullsisë i zhvendos vendet e tjera duke humbur qartësinë e paraqitjes grafike.

Pas një vështrimi brenda vetes

duke u bazuar në konkluzionin fillestar të konsiderimit të fatkeqësive që kanë kapluar popullatën myslimane në botë, mund të marrim guximin të analizojmë marrëdhëniet me fqinjët tanë ‘ehli kitabë’ apo ithtarë të librit.

Tab. 1 Vendet me numrin më të madh të myslimanëve, dhe një krahasim i GNI dhe normës së alfabetizimit me 10 vende të zhvilluara.

Popullata në grafik paraqet popullatën e plotë të vendeve në studim, ku përfshihet popullata myslimane dhe ajo jomyslimane, për të cilën janë llogaritur indikatorët e tabelës. Ka një korrelacion negativ

Vendi	Popullata (në milionë) ¹	GNI (per capita (\$) 2011) - Atlas method* ²	Norma e alfabetizimit tek të rriturit (2010) ³
Indonezi	205,3	2,940	92.6
Pakistan	178,2	1,120	54.9
Indi	163,2	1,420	62.8
Bangladesh	147,4	780	56.8
Egjypt	79,5	2,600	72.0
Nigeri	74,7	1,280	61.3
Iran	74,6	4,520	85.0
Turqi	75.0	10,410	95.0*
Algjeri	35.0	4,470	80.2*
Marok	32.0	2,970	56.1
Fed. Ruse***	143	10,650	
Itali	60,7	35,320	
Japoni	127,8	44,900	
Kanada	34,5	45,550	
UK	62,7	37,780	
USA	311,6	48,620	
Gjermani	81,8	44,230	
Francë	65,4	42,420	
Spanjë	46,2	30,930	
Izrael	7,8	28,930	




Fig. 1 Vendi që zënë 10 vendet me numrin më të madh të myslimanëve në numrin e përgjithshëm të tyre në botë.




Fig. 2 Popullata dhe GNI (Gross National Income) per capita 2011 sipas vendeve në studim.

ndërmjet numrit të popullsisë dhe GNI (per capita), $r = -0,257$, $n = 20$, $p = 0,274$. Megjithatë lidhja nuk është sinjifikante nga ana statistikore.

Pas kësaj paraqitje të shkurtër të situatës në gjeografinë e popullatës myslimane, vlerësimi i së cilës është i domosdoshëm për njohjen deri diku të vetes dhe të ambientit që do të jetë vazhdimisht në marrëdhënie me një grup tjetër të madh, siç janë të Krishterët, mund të fillojmë të shikojmë disa fakte të pritshme historike të marra nga hadithet dhe të vlerësohen në kontekstin aktual dhe të përdorshmërisë së tyre në jetën e përditshme.

Ardhja e Muhamed Mehdiut (a.s.) dhe Isait (a.s.)

Fillimish do të rreshtoj disa hadithe që do na interesojnë gjatë diskutimit në vazhdim. Hadithet për këtë temë janë të shumta por do të kufizohemi vetëm tek ata që janë të lidhur drejtpërdrejt me temën tonë. Nuk do të merremi as me paraqitjen fizike dhe as me rrjedhën e ngjarjeve që lidhen me këta personazhe, duke u fokusuar vetëm te pikat që mund të shërbejnë për të sqaruar marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve në kohën para ardhjes së Muhamed Mehdiut (a.s.) dhe Isait (a.s.), në kohën që jetojmë.

[392] 244 - (...) Tregohet se Ebu Hurejra (r.a.) ka thënë: “I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Si do të

jeni ju kur i biri i Merjemes (Isai) të zbresë mes jush dhe imami juaj do të jetë njëri prej jush?”²

[395] 247 - (156) Xhabir ibn Abdullahu ka thënë: “Kam dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: ‘Një grup prej Ymetit tim do të vazhdojë të luftojë për të vërtetën deri afër Ditës së Ringjalljes. Isai, i biri i Merjemes do të zbresë dhe prijësi i tyre do ti thotë: ‘Hajde dhe na prij në namaz’ por ai do të thotë. ‘Jo, ju jeni prijës të njëri tjetrit’, ky është nderimi i Allahut për këtë Ymet.”³

2222. Tregon Ebu Hurejra (r.a.) : “I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: “Për Atë, në Duart e të Cilit është shpirti im, me siguri që biri i Merjemes (Isai (a.s.) së shpejti do të zbresë mes jush (Myslimanëve) dhe do të gjykojë njerëzit me drejtësi me Ligjin e Kuranit (si sundues i drejtë) dhe do të thyejë kryqin, do të vrasë derrat dhe do të heqë Xhizjen (taksën që u merret jomyslimanëve, që janë nën mbrojtjen e qeverisjes myslimane). Kjo xhizje nuk do të pranohet nga Isai (Jezusi) (a.s.). Pastaj do të ketë bollëk parash dhe askush nuk do të pranojë të marrë lëmoshë.”⁴

2. Muslim ibn al-Hajjaj al-Qushayri, Zai A, Khattab N, Khattab H, Abu Khalil. Şaḥīḥ Muslim. Volume 1. Riyadh: Darussalam; 2007, 247.

3. Muslim ibn al-Hajjaj al-Qushayri, Zai A, Khattab N, Khattab H, Abu Khalil. Şaḥīḥ Muslim. Volume 1. Riyadh: Darussalam; 2007, 248.

4. Bukhari M. Khan M. The translation of

4283. Tregohet nga Aliu (r.a.) se Profeti (a.s.) ka thënë: “Edhe sikur të ketë mbetur vetëm një ditë nga Kijameti. Allahu do të dërgojë një njeri nga familja ime i cili do ta mbushë botën me drejtësi ashtu siç ishte e mbushur më parë me padrejtësi.” (Hasen)⁵

4286. Është treguar nga Muadh ibn Hisham (ai tha) : “Babai im më ka treguar mua, nga Katade, nga Salih Ebi Al-Khalil, nga një shok i tij, nga Umm Selemeh, e shoqja e Profetit (a.s.), ka transmetuar se Profeti (a.s.) tha: “Do të ketë një grindje pas vdekjes së një Kalifi dhe një burrë nga Medina do të ikë drejt Mekës. Disa nga banorët e Mekës do të vijnë te ai dhe do ta nxjerrin kundër dëshirës së tij dhe do t’i zotohen për besnikëri atij mes Këndit (Gurit të Zi) dhe Mekamit. Një ushtri nga Shami do të dërgohet kundër tij, por do të gëlltitet nga toka në shkretëtirën në Al-Baida, në mes Mekës dhe Medinës. Kur njerëzit ta shohin këtë, të devotshmit nga Shami dhe njerëzit më të mirë të Irakut do të shkojnë tek ai dhe do t’i zotohen për besnikëri atij. Pastaj do të ngrihet një burrë nga Kurejshët, dajat e të cilit janë nga fisi Kalb, do të shfaqet dhe do të dërgojë një ushtri

the meanings of Sahih Al-Bukhari. Volume 3. Riyadh, Saudi Arabia: Dar-us-Salam; 1997, 235-236.

5. Abu Daud Sulayman ibn al-Ashath al-Sijistani, Zai A, Qadi Y, Abu Khalil. English translation of Sunan Abu Dawud. Volume 4. Riyadh: Darussalam; 2008, 508.

kundër tij, por ai do t’i mposhtë ata. Ajo ushtri e mundur do të jetë forca e Kalbit. Të humburit janë ata që nuk do të jenë të pranishëm kur të shpërndahet pasuria e Kalbit. Ai (Mehdiu) do ta shpërndajë pasurinë dhe do të sundojë mbi njerëzit sipas Sunetit të pejgamberit. Islami do vendoset në tokë dhe ai do të qëndrojë për shtatë vite, pastaj ai do të vdesë dhe myslimanët do t’ia falin xhenazen”. (Da’if)⁶

Në fund të hadithit që tregon rreth takimit të Profetit (a.s.) dhe Umerit (r.a.) me Ibn Sajadin është ky dialog; ‘Umer ibn Hatabi tha: O i Dërguar i Allahut, më lejo ta vras. I Dërguari i Allahut tha: Nëse ai është kush ti mendon se është, ti asnjëherë nuk do mundësh ta vrasësh atë.”⁷ Umeri mendonte se mund të ishte Dexhali.

Shfaqja e figurave historike si domosdoshmëri

Ardhja e profetëve nuk është një fenomen rastësor. Për të gjithë ata misioni është i ngjashëm, por ka specifika që i dallojnë nga njëri tjetri, duke kulmuar me ardhjen e Muhamedit (a.s.). Është folur

6. Abu Daud Sulayman ibn al-Ashath al-Sijistani, Zai A, Qadi Y, Abu Khalil. English translation of Sunan Abu Dawud. Volume 4. Riyadh: Darussalam; 2008, 509-510.

7. Muslim ibn al-Hajjaj al-Qushayri, Zai A, Khattab N, Khattab H, Abu Khalil. Şahih Muslim. Volume 7. Riyadh: Darussalam; 2007, 318.

gjerësisht për rrethanat historike të ardhjes së Profetit (a.s.) dhe as armiqtë e Tij nuk do të merrnin guximin ta mohonin. Të gjithë këta personazhe konkretizohen në vende dhe kohë të caktuara. Muhamedi (a.s.), ndërmjet veçantive të Tij të shumta, karakterizohet nga universaliteti dhe plotësimi që sjell figura e Tij. Plotësohet feja dhe mesazhi i drejtohet gjithë njerëzimit. Në Mekën si udhëkryq i kontinenteve “të lashta”, kjo “Kërthizë e Botës”, që ishte më se e përshtatshme për shtabin kryesor, i cili do t’i shërbente një lëvizjeje me përmasa universale, vjen ky profet për mëshirën e mbarë njerëzimit^{8,9}. Megjithatë, Ai (a.s.) mbetet personazh tejhistorik dhe në shumë raste i pakuptueshëm në madhësinë e tij dhe afërsinë e Tij me Allahun xh.sh. Një ndër ekstremet e afërsisë së Tij me Allahun xh.sh. është nata e Israsë dhe Miraxhit. Një përmbledhje e kësaj pakuptueshmërie nga mendja e njeriut të zakonshëm mund të ilustruhet me fjalët e Kadi Ijadit (vd. 544/1149); “Allahu thotë: **“Ai (Muhammedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.” (Kur’an; 53:18)**”¹⁰ Të kuptuarit

e zakonshëm nuk është i aftë të kapë detajet e asaj çfarë i është treguar dhe humbet në përpjekjen të përcaktojë se çfarë ishte në të vërtetë kjo shenjë e madhe.”¹¹

Duke gjurmuar këto karakteristika të Muhamedit (a.s.) si shembull, duhet të kërkojmë edhe karakteristikat e figurave të tjera të pritshme, sigurisht duke i parë në kontekstin e karakteristikave të tyre specifike. Figura e Muhamed Mehdiut (a.s.) shfaqet në një moment kur bota është e mbushur me padrejtësi dhe shërben si një pikë kthese për ta mbushur atë me drejtësi; gjithashtu Isai (a.s.) rishfaqet si bashkëkohës i të parit dhe gjithashtu si armik dhe ekzekutor i Dexhalit (antikrishtit). Analiza e asaj kohe dhe ndodhive madhore që priten është jashtë mundësive dhe objektivit tonë, por përmendja e tyre ka për qëllim njohjen e tyre, me aq sa mundemi, duke njohur në këtë mënyrë edhe kufizimet tona. Këta personazhe madhorë të historisë së njerëzimit kanë detyrat e tyre dhe është praktikisht e pamundur, me gjithë dëshirën e mirë, të pretendohen objektiva, që në mënyrë të qartë u janë deleguar atyre.

Disa gjetje të thjeshta mund të shikohen nga hadithet në lidhje me figurat e Muhamed Mehdiut (a.s.) dhe Isait (a.s.). I pari është një njeri që e

8. Hamidullah M. Muhammedi Alejhisselam, Jeta 1. 1st ed. Shkup; 2011, 32.

9. Gavoçi V. Pejgamberi Muhammedi A.S. - Jeta dhe vepra. 1st ed. Shkup; 1994, 43.

10. Të gjitha ajetet e Kur’anit janë marrë nga “Përkthimi me komentim i H. Sherif Ahmetit.” OPGBG-“Rilindja”-Prishtinë. 1990.

11. Muhammad, Messenger of Allah: Ash-Shifa of Qadi Iyad. Madinah Press, 2011, 190.

refuzon autoritetin deri në momentin e fundit, vjen në kohë lufte dhe përçarje të madhe dhe grupet që i afrohen për ta mbështetur janë nga njerëzit mirë të asaj kohe. Isai (a.s.) vendoset në namaz pas tij dhe nuk vjen me ndryshime të sheriatit, por me detyrat e caktuara të përmbledhura në vazhdim. Përmbledhtas, sipas këtij opinion, i pari vjen edhe si faktor unifikues për myslimanët, që bashkohen rreth tij, dhe Isai (a.s.) zgjidh problemet ekzistuese besimore në mesin e komunitetit të krishterë, përveç plotësimit të objektivave të tjera që ka.

**Derri, kryqi dhe xhizja,
problemët e pazgjidhura deri
në kohën e fundit, dhe vrasja e
Dexhalit**

Zakonisht, dhe me të drejtë, thirrësit për paqe ndërmjet Islamit dhe Krishterimit gjejnë pikat e përbashkëta dhe fushat e mundshme të bashkëpunimit. Në këtë këndvështrim janë arritur suksese të padiskutueshme dhe do të ketë përderisa ka njerëz, nga të dyja palët, që kërkojnë paqen. Ndërkohë që, në diskutimin tonë, fokusin do ta zhvendosim në një kohë tjetër, që nuk mund të dihet a është nesër apo pas shumë vitesh. Në këtë kohë kemi dy personazhe dhe dy popullata, Muhamed Mehdiu (a.s.) dhe Isai (a.s.), myslimanët dhe të krishterët. Pyetja është tashmë jo

se çfarë i bashkon këto dy grupe të mëdha, por çfarë i ndan me siguri deri në atë kohë.

Meqenëse subjekt i diskutimit janë çështjet e hadithit që flet për kryqin, derrin dhe xhizjen, në vazhdim janë paraqitur referencat e marra nga Kur'ani për këto subjekte.

“Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau.” (Kur'an; 4:157)

“(All-llahu) Ua ndaloi juve vetëm të ngordhtën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që therret (ngrihet zëri me të) jo në emër të All-llahut.” (Kur'an; 2:173)

“...derisa ta japin xhizjen në dorë...” (Kur'an; 4:157)

Në të tre këto aspekte myslimanët janë të pozicionuar në mënyrë përfundimtare. Urdhëresa apo sqarimi vjen direkt nga libri i shenjtë Kur'ani dhe është i shprehur në mënyrë eksplicite. Isai (a.s.) nuk është kryqëzuar, mishi i derrit është haram dhe xhizja duhet paguar. Të gjithë mund të pranojnë me lehtësi dy qëndrimet e para, por xhizja është një marrëdhënie e drejtpërdrejtë dhe nuk mund të përjetohet në mënyrë të pavarur nga dy grupet. Pretendimi i sotëm është nga ana e të krishterëve që xhizja është një taksë poshtëruese dhe i kthen ata në qytetarë të dorës së dytë. Në historinë e qytetërimit Islam njihen raste kur xhizja është mbledhur dhe, në pamundësi të mbrojtjes në vazhdim të qytetit

nga ushtria myslimane, paratë e xhizjes janë kthyer me argumentin e pamundësisë së zbatimit për mbrojtjen e qytetarëve të krishterë nga ushtria myslimane në tërheqje. Njëra palë e quan si fyerje dhe pala tjetër e konsideron se duhet zbatuar si urdhër Kur'anor dhe gjithashtu justifikon me mospjesëmarrjen në përgatitjen e ushtrisë mbrojtëse. Ndoshta kemi humbur diçka edhe nga interpretimet e mëparshme, e ndoshta kërkohen modalitete të reja sipas kohës që jetojmë. Këto janë specifika të ixhtihadit, por ajo çfarë është e sigurt është pamundësia e myslimanëve për të abroguar xhizjen. Koha mund të jetë afruar shumë që ajo mund të abrogohet si taksë, çfarë do të thotë që po përjetojmë një moment të tillë të historisë së njerëzimit që xhizja kërkohet të hiqet. Por myslimanët e kanë të pamundur të abrogojnë një urdhëresë Kur'anore. Isai (a.s.) vjen me autoritetin e një prej profetëve më të mëdhenj; gjithashtu ne nuk e dimë se si do të jetë gjendja e njerëzimit në momentin që Ai (a.s.) e abrogon atë, ndoshta e gjithë popullsia e tokës është në fenë e drejtë dhe nuk ka kush, kujt t'ia marrë xhizjen. Këto, gjithsesi, janë arsyetime hipotetike.

Po pse përmenden vetëm këto tre ndërhyrje nga ana e Isait (a.s.)? As kësaj nuk mund ti japim përgjigje përfundimtare, por në kuadrin e shikimit të problemit me syrin e bashkëjetesës ndërmjet Myslimanëve

dhe të Krishterëve mund të themi që këto probleme do të ngelin të pazgjidhura deri në atë kohë. Me gjithë pozicionin këmbëngulës dhe të pandryshueshëm të myslimanëve edhe të krishterët me sa duket nuk do të lëshojnë pe në këto pika. Në njëfarë mënyre këto mund të quhen pikat e pazgjidhshme. Këtë pazgjidhshmëri mund ta shikojmë nga ana praktike sipas dy pozicioneve të mundshme; njëri është që myslimanët duhet të përpiqen vazhdimisht t'i mposhtin të krishterët në këto pika, dhe nga ana tjetër mund të shihen si një kufi që nuk do të mund ta kapërcejnë edhe sikur të bëjnë përpjekje pa fund. Nëse quhet e pazgjidhshme mjafton që ti tregohet palës tjetër qëndrimi yt, duke sqaruar prejardhjen e tij dhe duke i qëndruar konsekuent, por duke qenë njëkohësisht koshient për kufizimet e ndërhyrjes tënde. Nëse një i krishterë do të 'dorëzohej' në këto tre pika a do të quhej më një i krishterë tipik sipas modelit që ne sot njohim? Mendoj se kjo është pika më delikate e të gjithë diskutimit dhe prandaj do të kërkoj ndihmë nga një hadith i cituar më sipër. Profeti Muhamed (a.s.) i thotë Umerit (r.a.) që nëse ai është se çfarë ai mendon se është (për personazhin që Umeri mendonte se mund të ishte Dexhali dhe kërkonte leje ta vriste) ti nuk mund ta vrasësh. Pra, edhe një personazh kaq madhështor si hazreti Umeri (r.a.) ishte i kufizuar në pamundësinë e një veprimi, që i

ishte taksur për ta kryer Isait (a.s.). Në rrugë të drejtë apo të gabuar qofshin të krishterët, mesa duket edhe këto tre çështje janë lënë në dorë të profetit Isa (a.s.).

Kjo nuk është një fatkeqësi për marrëdhëniet dypalëshe. Ky është fat i mirë, të kemi një lajm të tillë që na tregon kufijtë tanë që nuk mund të tejkalohen as nga dëshira e as nga mundësitë. Ndërkohë që krijohet një hapësirë e pafund bashkëpunimi. Në hadith dhe me sa kam njohuri edhe në hadithe të tjera, nuk përmendet diçka e ngjashme as për alkoolin dhe drogat, as për bixhozin dhe fajdenë, as për moralin dhe familjen, as për magjinë dhe smirën. Lista mund të jetë e gjatë me argumente rreth të cilave Myslimanët dhe të Krishterët kanë ose mund të kenë në të ardhmen qëndrim të njëjtë ose së paku të ngjashëm. Në planin social dhe ekonomik Kur'ani ju lejon mysli-manëve ushqimet nga të krishterët, gratë nga të krishterët dhe tregtinë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë përderisa ata jetojnë në paqe dhe në respekt të njëri tjetrit. A nuk janë këto fusha të mundshme bashkëpunimi nga ku të dy palët mund të reagojnë së bashku dhe duke qenë një zë më i fuqishëm ku padiskutim fitojnë dy palët? Problemi i drogave në Shqipëri është i mpreshtë, sepse nuk ka vetëm konsumatorë por edhe prodhues dhe trafikantë të tyre. Qëndrimi i dy grupeve religjioze është i njëjtë dhe

mendoj edhe i suportuar në publik nga qeveritë. Zakonisht shikojmë reagime, ose të profesionistëve të shëndetësisë, ose të shoqërisë, që lidhen me dëmin e përdorimit të drogave. Por, sa qëndrime publike kundër prodhuesve dhe trafikantëve ka? Nuk e di në të vërtetë sa ka, por një reagim sinkretik do ta bënte reaguesin shumë më të guximshëm ndaj këtyre strukturave të kriminit të organizuar, edhe ndërkombëtar. Jam i sigurt që asnjëherë, as Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe as Komunitetet e Krishtera, Ortodokse dhe Katolike, nuk do të bëhen palë as me krimin dhe as me vesin, prandaj nuk do gjenden asnjëherë në llogore të ndryshme për këto çështje, dhe duke u gjendur në të njëjtën llogore gjëja më e arsyeshme që mund të bëjnë është të gjejnë mirëkuptim dhe të identifikojnë armikun e përbashkët. Kjo tashmë ka ndodhur, por mbetet bashkimi i përpjekjeve.

Konkluzione

Qëndrimet ndërmjet besimeve fetare janë fenomene në nivel global apo ndërkombëtar, por gjithashtu edhe ndërmjet individëve të përkatësive të ndryshme. Në një kohë që struktura e shoqërisë është shumë e ndryshueshme, njerëzit duhet të jenë të qartë për raportet që duhet të kenë me të tjerët, ata që nuk i përkasin grupit të tyre, qoftë kombëtar, fetar apo edhe përkatësi

të tjera më pak të rëndësishme. Qëllimi i mirë për të ruajtur raporte të ndërsjella komunikimi dhe bashkëpunimi është i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm. Këto raporte duhen studiuar, që të mos jenë raporte të ndërtuara mbi komplekse inferioriteti apo superioriteti. Gjatë kërimit gjeta një fjalë, *tesamuh*, përdorur në Islam për të shprehur një koncept më të gjerë se toleranca, ku njeriu nuk e detyron veten për të bashkëjetuar me të tjerët por e pranon tjetrin si pjesë të realitetit dhe pajtohet me të.¹² Një ndërhyrje e shikoj të arsyeshme, ndërkohë që ky koncept përdorej me sukses në kohën e Perandorisë Osmane ku njerëzit ishin të ndarë në *milete*, apo njësi shoqërore të bazuara te përkatësitë fetare, sot ndodhemi përballë një fenomeni global të përzierjes, qoftë reale e qoftë virtuale. Problemet shfaqen edhe ndërmjet komuniteteve të përkatësive të ndryshme por edhe ndërmjet pjesëtarëve të së njëjtës përkatësi, gjë për të cilën jemi dëshmitarë. Anëtarët e komunitetit tjetër duhen pranuar siç janë, duke i toleruar ata; me të ndryshmit brenda të njëjtit komunitet duhet bashkëjetesë. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një mendim ndryshe dhe të dy palët ecin paralelisht me njëri tjetrin, në rastin e dytë kemi të bëjmë me variacione të të njëjtit model. Në të dy rastet duhet të ketë

njohuri për të shmangur përplasjet e padëshiruara dhe të panevojshme në praktikë.

Në rastin e kundërshtive mes grupeve të së njëjtës përkatësi fetare, konkretisht Islamit, nëse disa detyrime madhore si nderi, prona dhe jeta respektohen, ndryshimet e tjera, që nuk të nxjerrin nga rrethi i fesë përkatëse, nuk ka pse të jenë më shumë se objekt diskutimi. Një shembull interesant për ilustrim është edhe përsëritja e fjalëve të kiametit, apo leximi i tyre vetëm njëherë, një fenomen që e hasim të ndryshëm në xhami të të njëjtit qytet. Ky ndryshim në përsëritje ka të bëjë me personat të cilëve i drejtohet, shkallës së përqendrimit të tyre bazuar në statusin e tyre fetar, duke përfunduar që, përsëritja e fjalëve të ikametit nga dy herë është e vlefshme edhe për personat e mëdhenj, sepse sahabet e bënë një gjë të tillë.¹³ Gjithashtu njohja e kufijve nëpërmjet njohjes së vetes dhe të tjetrit, në raport me anëtarët e përkatësive të tjera, jo vetëm që garanton paqe, por lejon edhe prezantimin e suksesshëm të besimit të tjetri, pavarësisht nëse ai e pranon apo jo. E rëndësishme është që ai nuk ndjehet i kërcënuar në të

13. Karaj E. Metoda e Imam Sha'raniut në zgjidhjen e kontradiktave juridiko-fetare në veprën el-Mizan [Internet]. Zani i Nalte. 2016 [cited 16 December 2016]. Available from: <http://zaninalte.al/2015/10/metoda-e-imam-sharaniut-ne-zgjidhjen-e-kontradiktave-juridiko-fetare-ne-vepren-el-mizan-2/>

12. Nesimi Q. Ortodoksizmi tek shqiptarët. Shkup: Logos-A; 2011, 33.

drejtën e tij së pari, dhe së dyti rriten shanset të dëgjojë. Një i paditur nuk ka mundësi ta prezantojë si duhet fenë e tij dhe grupet e përçara nuk kanë besueshmëri në transmetimin e së vërtetës. Pra, është një moment që, në aspektin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë grupit të përkatësisë, kërkon mjaft impenjim.

Duke ju rikthyer skemës fillestare të diskutimit ku armiq të vërtetë janë injoranca, varfëria dhe përçarja, mund të themi me sinqeritet që, kur lufta bëhet domosdoshmëri, të varfër mund të shkohet në luftë, por nuk mund të fitohet. Kjo forcë nuk kërkohet vetëm si mjet për të arritur fitore, por si mbartëse e një qëndrimi që, edhe kur lufta kërkohet për një kauzë të drejtë, njëra dorë qëndron te shpata dhe tjetra qëndron e zgjatur për pajtim. Fitore më e madhe se vrasja e armikut do të ishte pajtimi sipas parimeve të një drejtësie transcendentale. Myslimanët dhe të Krishterët duke e njohur veten dhe njëri tjetrin më mirë, ndoshta do të kuptojnë se janë më afër njëri tjetrit se me shumë grupe të tjera, që aktualisht i konsiderojnë si miq të afërt. Njohja mund të përkthehet shumë mirë në bashkëjetesë. Një qëndrim i tillë ka qenë karakteristik për Profetin Muhamed (a.s.) dhe një nga veprimet e Tij më simbolike, po e lë të shprehur me fjalët e Hafiz Ibrahim Dalliut (vd. 1371/1952)

në lidhje me pritjen e dërgatës së Nexhranit nga Profeti (a.s.);

“Kta përfaqësues ishin të tanë katolik

U pritën me nderime aty si miq
N’xhamië të Resulit u përbojtën
kta

Dhe si mbas fes s’vet m’u fal leje
ju dha.”¹⁴

Dikush mund të thotë që e gjitha kjo që është shkruar më sipër nuk trajton në mënyrë të drejtpërdrejtë njeriun dhe botën e tij të brendshme dhe as luftërat e tij të padukshme. Kjo është e vërtetë! Do të doja të përmend në fund, edhe për ta çdramatizuar sado pak një qëndrim të këndshëm në lidhje me qëndrimet jo vetëm bardh e zi ndaj pjesëtarëve të besimit të krishterë. Personi që fliste për raportet ndërmjet Myslimanëve dhe të Krishterëve, pasi kishte sqaruar idetë e tij, thotë që unë jam mysliman, jam i martuar me një grua të krishterë, veprim i cili është i lejuar në Islam, dhe nuk mundem që çdo ditë në mëngjes të zgjohem nga gjumi dhe fytyrës së parë që shikoj, që është fytyra e gruas sime, ti them; “Mirëmëngjesi armik!”

14. Dalliu H. E lemja e të madhit Pejgamber dhe jeta e atij a.s., 2nd ed., Tiranë, 2016, 180.

Shënim: Fusnotat e mëposhtme i përkasin tabelës nr. 1, të këtij artikulli.

1. Kettani H. 2010 world Muslim population. In proceedings of the 8th Hawaii International Conference on Arts and Humanities 2010 Jan.

*GNI (gross national income) is gross domestic product (GDP) plus net receipts of primary income (employee compensation and investment income) from abroad. GDP is the sum of value added by all resident producers plus any product taxes (less subsidies) not included in the valuation of output.

GNI per capita is gross national income divided by mid-year population.

The Atlas method is a method used by the World Bank to estimate the size of economies in terms of gross national income(GNI) in U.S. dollars.

Definicionet janë marrë nga, Global Finance Magazine - GDP-GNI-Definitions [Internet]. Global Finance Magazine. 2016 [cited 28 October 2016]. Available from: <https://www.gfmag.com/global-data/glossary/gdp-gni-definitions>

** Të dhënat e munguara për Turqinë dhe Algjerinë janë marrë nga, UNESCO Institute for Statistics, 2015.

*** Popullata për vendet me ekonomi të zhvilluar janë marrë nga referenca [4].

2. World Bank. 2013. World Development Indicators 2013. Washington, DC: World Bank. doi: 10.1596/978-0-8213-9824-1. License: Creative Commons Attribution CC BY 3.0.

3. Global Finance Magazine - GDP-GNI-Definitions [Internet]. Global Finance Magazine. 2016 [cited 28 October 2016]. Available from: <https://www.gfmag.com/global-data/glossary/gdp-gni-definitions>

Ekstremizmi midis paragjykimit dhe stigmatizimit

Doc. Dr. Faredin Ebibi

Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame – Shkup

Abstrakt

Ekstremizmi si fenomen e ka shoqëruar njeriun gjatë tërë periudhave kohore. Si dukuri ka gjetur shtrirje gjithandej në poret e jetës, si në rrafshin politik, ekonomik, ideologjik, fetar, sportiv e gjetkë. Si pasojë e ndryshimeve globale më i diskutueshmi rreth të cilit debatohet shumë, është i ashtuquajtimi ekstremizmi i dhunshëm fetar. Me tendencë të apostrofimit dhe etiketimit me këtë dukuri, të një feje të caktuar – Islamit, a thua se çdo ideologji, fe ose strukturë tjetër të ishte immune nga ky fenomen.

Fjalët kyçe: *ekstremizëm, Islam, ideologji, paragjykim, stigmatizim, Kur'an, Sunet, tendencë, normë, standard.*

Hyrje

Kohëve të fundit në Maqedoni është debatuar me të madhe rreth dukurisë së ekstremizmit. Si shqetësim kjo dukuri ka zënë vend në medime të shkruara dhe

elektronike. Janë organizuar tryeza, tribuna dhe konferenca, në kuadër të të cilave temë debati ka qenë ekstremizmi i dhunshëm.

Pavarësisht faktit se ekstremizmi si fenomen, ka gjetur shtrirje gjatë tërë periudhave kohore. Është prezent gjithandej si në rrafshin

politik, ekonomik, ideologjik, shoqëror, fetar, dogmatik, sportiv etj. Por, më i debatueshmi, rreth të cilit është diskutuar më tepër, ishte i ashtuquajturi ekstremizmi i dhunshëm (duke aluduar në atë fetar). Si shqetësim, sigurisht që ia vlen të trajtohet me seriozitetin më të madh, por mënyra parciais e përjashtuese e ekstremizmave në fusha të tjera, krijonte përshtypjen e mos seriozitetit të debateve rreth këtij fenomeni. Madje tendenca e birësimit të ekstremizmit të dhunshëm një feje ose një shoqërie të caktuar, është shqetësuese dhe ngarkesë përplot paragjykitime.

Përvoja ime e fituar nga pjesëmarrja në ato konferenca, tryeza dhe tribuna të organizuara, më ka motivuar t'i qasem më seriozisht kësaj teme, për t'i bërë me dije opinionit publik qëndrimin e fesë islame, sipas interpretimit identik rreth mënyrës si ajo e ka trajtuar ekstremizmin dhe cili është qëndrimi i saj ndaj fenomenit në fjalë. Kam dëgjuar nga shumë individë pjesëmarrës në ata debate, konstatime paragjyquese, si pasojë e mosnjohjes, ose si pasojë e njohjes gabim të qëndrimit të Fesë Islame ndaj dukurisë së ashtuquajtur ekstremizmi i dhunshëm (fetar).

Fillimisht do të ndalemi në përkufizimin e termit ekstremizëm, më pastaj do të prezantojmë tekste nga Kur'ani dhe Suneti për të mësuar qëndrimin e fesë islame lidhur me fenomenin ekstremizëm.

Përkufizimi etimologjik dhe terminologjik i shprehjes ekstremizëm

Tërësia e pikëpamjeve dhe e synimeve më të skajshme, quhet ekstremizëm (Albanian Explanatory Dictionary). Në këtë kuptim, kjo shprehje është përdorur edhe nga disa studiues të mëvonshëm myslimanë siç janë Neveviu dhe Ibni Tejmije. Ndërkohë dijetarët e mëhershëm kanë përdorë shprehjen “guluvv” që do të thotë: “tejkallim”, “skajshmëri”, “diçka e tepërt”, “zmadhim”, “ekzagjerim” etj.

Ndërlikueshmëria konceptuale e të kuptuarit të termit ekstremizëm, e vështirëson përkufizimin real të këtij termi. Kjo si pasojë e motivit se qasja e njerëzve ndaj fenomeneve nuk është e njëjtë, ashtu siç nuk është e njëjtë edhe qasja ndaj problemeve dhe trajtimi i tyre, për arsye se metoda dhe mënyra e trajtesës ndryshon nga një shoqëri në tjetrën.

Burimet prej nga njerëzit furnizohen me njohuri dhe informacione nuk janë të njëjta. E gjithë kjo e vështirëson përcaktimin e saktë të kuptimit terminologjik të termit ekstremizëm.

Një veprim i caktuar mund të shihet si ekstremizëm, kurse te tjetri shihet dhe vlerësohet si i drejtë e i moderuar. Atë që dikush e sheh si veprim të moderuar, tjetri e sheh si ekstremizëm. Agjërimi në periudha

të nxehta shihet si diçka ekstreme, por besimtari i denjë e realizon atë me plot përkushtim. Pasja kujdes ndaj parimit nëse çështja është e lejuar fetarisht ose e ndaluar, nga dikush mund të shihet si diçka e tepruar, por për besimtarin mysliman, ajo është çështje parimore. Të respektosh ligjet konsiderohet vlerë, ndërkohë, ai i cili respekton ligjet e fesë që i përket, që zbaton urdhëresat hyjnore, sipas dikujt vlerësohet si ekstremist?! Shtrohet pyetja, cili është ekstremist, ai që i respekton ligjet apo ai që nuk i respekton?

Në rrethana të këtilla domosdo duhet të kishte një referues me kompetencë mbi bazën e të cilit do të ishte e mundur përcaktimi i kuptimit të saktë të termit ekstremizëm. Në të kundërtën, çdo kush do të veprojë në përputhje me konceptin dhe botëkuptimin individual ndaj kuptimit të termit ekstremizëm. Për pasojë divergjencat janë ekzistente për sa i përket të kuptuarit të shprehjes në fjalë.

Nga perspektiva e Legjislacionit Islam, termi ekstremizëm është përdorur në dy konotacione. Është përdorur në kuptimin e ekzagjerimit dhe të tejkalimit, ndërkaq i njëjti term është përdorur edhe për mospërmbushje të normës së caktuar nga Legjislacioni Islam, si në rrafshin praktik, në atë që i përket çështjes së besimit, edhe në përditshmërinë e sjelljeve të njeriut.

Ekzagjerimi nga perspektiva e teksteve hyjnore

Mosnjohja e plotë e platformës strukturore të fesë islame, shpie në paragjykime dhe në shtrembërimin e të vërtetës së saj. Padrejtësisht apostrofohet si gjeneratore e krizave, dhunës, ekstremizmit, radikalizmit, etj.

Faktet në vazhdim paraqesin dëshmi solide për sa i përket vërtetësisë se Feja Islame nuk ka asgjë të përbashkët me fenomenin ekstremizëm. Në Kur'anin fisnik është theksuar:

1. “ **O ithtarët e librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën...**” (Kur'an, 4:171)

2. Thuaj: “**O ithtarë të librit! Mos i shkelni kufijtë e së vërtetës në besimin tuaj dhe mos ndiqni dëshirat e një populli, që gaboi më parë...**” (Kur'an, 5:77)

3. “**Allahu nuk dëshiron t'iu krijojë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë...**” (Kur'an, 5:6)

4. “ **... dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi...**” (Kur'an, 22:78)

Në këtë drejtim nuk janë të pakta edhe hadithet, përmes të cilëve, i Dërguari i Allahut (a.s.) ka tërhequr vërejtjen që të mos ekzagjerojnë gjërat dhe praktikat rituale në fe, e të mos rëndohet feja jashtë formatit të saj. Në të kundërtën, e humb vlerën

dhe efektin e të qenët fe e shpallur nga Krijuesi i Gjithësisë.

1. Ibn Abasi tregon se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kujdes nga ekzagjerimi në fe, sepse ata që ishin para jush u shkatërruan për shkak të ekzagjerimit në fe.”* (Nisai, 1421/2001)

2. *“Bëni vepra (të mira) aq sa është në mundësitë tuaja...”* (Buhariu, 1422)

3. *“Fe më e dashur ke Allahu është ‘el – hanifijje’ ajo që është tolerante.”* (Buhari, 1422)

4. *“Vërtet feja është lehtësi, kushdo që e vështirëson fenë (duke ekzagjeruar dhe rënduar atë) ajo e ngadhënjën atë...”* (Buhari, 1422)

Nga ana tjetër, ndërtimi i parimit: *jo tejkalim dhe jo neglizhencë, s’ka ekzagjerim në fe dhe as nuk ka dhunë*, është dëshmi e qartë e distancimit të plotë të Fesë Islame nga dukuria e ekstremizmit. Ndërkohë, nuk do të kishte logjikë dhe as kuptim feja, e cila simbol të vetin ka «selamin – pagen», të ishte ajo që ushqen ekstremizmin.

Myslimanët e gjithë botës ndajnë mendimin dhe konstatimin se çdo gjë e tepruar jashtë limiteve, nuk i përket Fesë Islame. Çdo konstatim tjetër do të ishte tendencë, paragjykim dhe stigmatizim. Në këtë relacion, gjithashtu, nuk ka hapësirë as për frazën “ekstremizmi islamik”, “radikalizmi islamik” dhe “terrorizmi islamik”. Një perifrazim i tillë nuk përkon me të vërtetën e Islamit, por struktura të caktuara përpiqen ta paraqesin Islamin si të atillë.

Ekstremizmi dhe aktet e dhunës

Veprime të caktuara nga elementë ekstremistë, shpeshherë të dhunshëm, që shfaqen kohë pas kohe nga struktura të caktuara, paraqesin shqetësim serioz dhe po ngjallin frikë te opinioni i gjerë. Megjithëse po flitet shumë për pasojat, por po flitet shumë pak për shkaqet dhe rrethanat, të cilat e stimulojnë këtë dukuri negative. Si rrjedhojë investimi antiekstremizëm, së paku gjer më tani, nuk ka dhënë frytin e duhur. Trajtimi i kësaj dukurie nuk është i lehtë ashtu siç mendohet, sepse është një temë e thellë, e cila kërkon objektivizëm. Bashkëpunimi i forcave relevante dhe me ndikim, gjithsesi është shumë i nevojshëm, veçanërisht roli i institucioneve edukative, gjithandej, duhet të ishte në krye të detyrës dhe të kryejë misionin me nder dhe me profesionalizëm. Duke mos dashur të stërzgjatet tema, në vazhdim po theksoj disa faktorë si indikatorë të mundshëm të prurjeve ekstremiste. Faktorët mund të jenë të shumtë, por unë do të theksoj vetëm disa prej tyre.

1. Mosnjohja e mësimëve fetare. Fjala është për mosnjohje parimore dhe identike të mësimëve Islame. Këtu kemi të bëjmë me struktura që kanë mungesë të skajshme të njohurive të vizionit largpamës dhe strategjik të Islamit, që

kanë mungesë të skajshme gjithashtu të njohurive rreth avantazheve, vlerave dhe karakteristikave të Islamit. Mosnjohja solide e funksionimit të sistemit, mbi bazën e të cilit funksionon e drejta fetare dhe ajo juridike islame. Mungesa profesionale e të kuptuarit të mesazhit hyjnor dhe pamundësia harmonizimit midis normave të përgjithshme dhe atyre sekondare. Pamundësia për të kuptuar çështjet enigmatike islame dhe ato që janë të qëndrueshme. Qasja e lirë dhe sipërfaqësore ndaj teksteve hyjnore pa standarde përkatëse. Këto mund të jenë indikator i veprimeve me elemente ekstremiste të disa individëve dhe grupeve nga radhët e myslimanëve. Sipas disa studiuesve të tjerë, mosnjohja kualitative e funksionimit të sistemit juridik dhe i së drejtës islame, cunon kompetencat për të kuptuar objektivin real të mesazhit hyjnor dhe motivon sistemin e antivlerave të mësimave megalomane dhe zhgënjyese larg objektivitetit. Ekzagjeruesit posedojnë njëfarëlloj diturie, por jo të bazuar mbi principet e parimeve dhe normave. Këto rrethana mund të jenë stimul i aktiviteteve me efekte ekstremiste.

2. Qëndrimi larg dijetarëve dhe institucioneve përkatëse, që ushtrojnë veprimtari edukative dhe arsimore zyrtare me programe fetare. Intoleranca dhe njëanshmëria

në mendime është rezultat i mësimit të fesë pa mësues. Mund të ishte faktor i radhës, që motivon ekzagjerimin dhe veprimtarinë me efekte ekstremiste. Veprimtaria e kësaj strukture më tepër e zbeh imazhin e Islamit se sa ndihmon në paraqitjen reale të tij. Një praktikë e tillë sjell rreziqe me përmasa të mëdha për arsye se nëpërkëmben parimet bazë të vetë fesë Islame. Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve, janë burim drite dhe bartës të mësimave të mirëfillta hyjnore. Krijuesi i gjithësisë ka porositur që t’iu kthehemi atyre në rast mosdije: **“ Ju pyetni pra dijetarët nëse ju nuk dini”** (Kur’an, 16:43). Injorimi i këtij parimi e përjashton mohuesin të ishte pjesë e strukturës së Fesë Islame.

3. Ndjenja e epërsisë dhe e superioritetit. Kjo veti nuk përkon me vlerat e besimtarit sipas interpretimit identik të Islamit. Kjo është veti e djallit të mallkuar, i cili ka mbivlerësuar veten ndaj gjithë krijesat. Mjerisht, kjo veti po manifestohet te një numër jo i vogël i njerëzve, sidomos te disa të rinj myslimanë, të cilët kanë ndërtuar bindjen se janë ata, të vetmit, në rrugë të drejtë, ndërsa të tjerët janë në rrugë të gabuar. Kështu ndodh me ata që nuk e njohin Islamin burimor sipas interpretimit identik. Të pavetëdijshëm, devijuesit i nënshtron sanksionit: **“Kushdo që i**

kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kijametit, do ta ringjallim të verbër.” (Kur’an, 20:124).

4. Etiketimet. Faktor i mundshëm potencial për veprime me efekte ekstremiste, mund të jenë edhe etiketimet. Në këtë kohë që po jetojmë, besimtari, i cili dëshiron të praktikojë parimet Islame, etiketohet me lloj-lloj etiketimesh. Në emër të të drejtave, cungohen të drejtat e besimtarit dhe kjo në mënyrë institucionale. Edhe pse ato të drejta dhe liri fetare janë të garantuara në sistemin demokratik, forca të caktuara krijojnë rrethana nxitëse të ndjenjës ekstremiste si reaksion. Ndoshta kjo është ajo sprova për të cilën i Dërguari i Allahut (a.s.) ka paralajmëruar: “*Islami ka filluar i huaj (me pak besimtarë) dhe i tillë do të ketë.*” (Ed-Devrekij, 1407).

Përfundimi

Çdo lloj aktiviteti dhe veprimtarie, jashtë kuadratit të interpretimit identik të Islamit, është i papranueshëm. Ekzagjerimi i normave fetare, përtej standardeve të shpalljes, jo që nuk pranohen, por është i ndaluar, për shkak se bije ndesh me parimet e përgjithshme të interpretimit identik të Islamit. Tendenca e birësimit të dhunës, ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit “Islamik”, është tendencë paragjyquese dhe stigmatike e fabrikuar nga qarqe anti-islame dhe islamofobe. Aktet e dhunës, veprimet ekstremiste, radikale e terroriste që shfaqen, kohë pas kohe, si reaksion nga individë dhe grupe të caktuara të shoqërisë islame, nuk janë arsye për ta akuzuar Islamin, sepse vetë Islami, akte të tilla, i gjykon dhe i vlerëson si aktivitete të ndaluara, e si pasojë të ndëshkueshme.

Literatura e shfrytëzuar

- **En-Nisaij**, Ebu Abdurrahman Ahmed b. Shuaib: Sunenu-l-kubra, Mues-sesetu er-risaleh, Bejrut, 2001 / 1421, 4, 178.
- **El-Buharij**, Muhamed b. Ismail: el-Xhamiu-l-musndeu-s-ahih el-muhtesar, Daru tauk en-nexhah, 1422, 3,38, 1,16.
- **Ed-Devrekij**, Ebu Abdullah Ahmed b. Ibrahim: Musnedu Sa’d b. Ebi Vekas, Daru-l-beshair el-Islamije, Bejrut, 1407, 1, 163.

Disa tema dhe dilema rreth përkthimit të Kur'anit në Gjuhën Shqipe

Mr. Elez Ismaili
Medreseja “Isa Beu” - Shkup

Abstrakt

Është fakt se me çështjen e përkthimit të Kur'anit janë marrë dijetarët më eminentë të proveniencës islame, dhe të gjithë kanë dhënë mendimet e veta lidhur me të. Duke i analizuar pohimet e tyre, mund të konstatojmë se përkthyesit e të gjitha kohërave nuk kanë qenë kategorikë që Kur'ani të mos përkthehet, por janë pajtuar që, ky thesar hyjnor, t'iu ofrohet popujve të mbarë botës. Dhe së fundi dubet të pajtohemi me këto dy konstatime që mund t'i përdorim si moto. I pari është ai i Imam Vehbi Dibrës, që del nga deklaratat e tij me rastin e botimit të disa pjesëve të Kur'anit në turqisht dhe shqip. Ai thotë: “Si kur qì dihet Kur-ani asht fjala e madhnueshme e krijuesit të Gjithsis, prandaj hypset me u përktheje madhnisht e nuk asht punë qì mbarohet me pendën e meftshme të mend shkurtënve”. Kurse për përkthimet me gabime thotë: “me këndue ksi soj librash se gabimet qì duken sheshit në përkthimet e përmendura mund t'u ngatrollojnë besimin e prandaj i porosisim qì të mos u napin randsië dhe mos t'i këndojnë fare.” Ndërsa konstatimi tjetër është ai i Enes Kariqit, ku thotë: “Kur'ani nuk ka mundësi të përkthehet, por ai pa tjetër dubet përkthyer”.

Në hyrje të këtij studimi, e shoh të udhës të jap konstatimin me të cilin pajtohen të gjithë studiuesit tanë se, në kuadër të gamës së veprimtarisë botuese të literaturës islame, pa dyshim që përkthimi i Kur'anit zë vend të veçantë dhe ka

një shtrirje kohore më se 100 vjeçare. Me përkthimin e Kur'anit, Gjuhës Shqipe iu sigurova statusi i gjuhës me të cilën është arritur përndritja e Shpalljes Hyjnore, kurse popullit tonë i është dhuruar thesari më i shtrenjtë i njerëzimit, që është fanar ndriçues për të gjithë popujt e botës,

pa dallim ngjyre, race a bindjesh fetare.

1. Dilema e parë që për shumë vite e bluaj në mendje është: kujt i takon merita për ta njohur si përkthyes të parë të Kur'anit në gjuhën shqipe? Përmendet emri i Ilo M. Qafëzezit¹ si përkthyes i parë i Kur'anit i mesit të viteve 20-të të shek. XX e nuk zihet në gojë Naim Bej Frashëri për përkthimin, ta quajmë selektiv, të një sërë ajetesh, me titull *Thelb' i Kur'anit*². Logjikisht, meqë të dy këto përkthime nuk janë të plotë, atëherë do të ishte më e arsyeshme, që kjo çështje, të shihet edhe në rrafshin kohor, dhe, pa mëdyshje, Naimi duhet të jetë përkthyesi i parë i ajeteve të zgjedhura të Kur'anit dhe përderisa nuk zbulohet ndonjë përkthyes më i hershëm, Naimi duhet të mbajë flamurin e përkthyesit të parë në gjuhë shqipe.

1. Sipas studiuesit tonë të njohur Gazmend Shpuza, përkthimi i Ilo M. Qafëzezit është i pari përkthim i Kur'anit në gjuhën shqipe nga një bashkatdhetar ortodoks. Është përkthim i pjesshëm i mbështetur në përkthimin anglisht të bërë nga George Sale. <http://kuranifisnik.net/kuranifisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=273>

2. Thelb i Kur'anit, pjesë përbërëse e veprës *Mësime* në botimin e kompletit të veprave të Naimit, si në Tiranë po ashtu edhe në Prishtinë, nuk përmendet fare. Botimin e parë të kësaj vepre e ka bërë vetë Naimi në Bukuresht më 1894. Studimin më të plotë të këtij kontributi e ka bërë dr. Mahmud Hysa. Më gjerësisht shih studimin me titull *Naim Frashëri si përkthyes i një varianti të Kur'anit* të këtij autori në veprën *Alamiada shqiptare II Logos-A*, Shkup 2000, f. 39-79.

1.1 Qafëzezi ka meritat e veta sepse, siç konstaton edhe studiuesi i mirënjohur Gazmend Shpuza, deshi të bëjë “çështje të kulluar kombëtare” dhe të paraqesë prova të një koncepti të gjerë dhe përparimtar për bashkëjetesën dhe mirëkuptimin midis besimtarëve të feve të ndryshme në atdheun e përbashkët. Është i kuptueshëm edhe karakteri iluminist i tij. Por, kur bëhet fjalë për Kur'anin, çfarë meritash i takojnë një përkthyesi, që merr guximin të përkthejë Kur'anin, ose cilin do libër të shenjtë, nga një gjuhë që s'ka as afërsinë më të vogël me gjuhën në të cilën është shpallur? Por tashmë janë të njohura reagimet për përkthimet e Kur'anit, ose çfarëdo vepre tjetër, jo drejtpërdrejtë nga origjinali arabisht, madje ato përkthime kanë dalë të dyshimta dhe jo qëllimira³.

1.2 Të kësaj kohe i kemi edhe përpjekjet e para në mënyrë të institucionalizuar, pak kohë pas themelimit të Komunitetit Musliman Shqiptar (1923), kur Hafiz Ali Korça më 1926 bëri hapat e para drejt përkthimit dhe komentimit të Kur'anit; Hafiz Ibrahim Dalliu për 15 vjet, në tri vëllime botoi *Ajkën e kuptimeve të Kur'ani Kerimit*, që njihet si përkthimi më

3. Për përkthimin e I. M. Qafëzezit do të mjaftonte edhe reagimi i Imam Vehbi Dibrës në Zanin e Naltë, nr. 12 të vitit 1924, f. 384 që është i njëjtë me reagimin e ulemave boshnjakë rreth përkthimit të Lubibratiqit. Sipas Enes Kariqit, vepra e cituar në fusnotën nr. 13.

i plotë, krahasuar me përpjekjet e më hershme ose të mëvonshme, të pjesërishtme, nga Abdulla Zemblaku (gjatë viteve 30-34) dhe nga Ferit Vokopola, i cili ka bërë përkthimin e pjesëve të Kur'anit, të realizuara përmes frëngjishtes në gjuhën shqipe⁴. Por cilat kanë qenë indikacionet që e shtynë Hafiz Ali Korçën, Hafiz Ibrahim Dalliu, Ali Asllanin, Ferit Vokopolën, Abdulla Zemllakun e ndonjë tjetër, që t'i rreken një pune kaq të ndjeshme dhe me përgjegjësi karshi Zotit xh.sh., dhe të gjithë atyre që në Kur'an do të gjenin udhëzuesin e vërtetë të jetës? Para se t'i japim përgjigje kësaj pyetjeje, më duhet të paraqes një tezë që buron nga të dhënat që i hasim në faqet e Zanit të Naltë⁵, të Kulturës Islame⁶, të revistës Njeriu⁷, etj. Në të vërtetë, në këto revista, Imam Vehbi Dibra, Behxhet Shapati, Haki Sharofi etj., mbushnin faqe të tëra me vaze e nasihate, të cilët edhe njihen si njohës të thellë të tefsirit dhe që kanë merita të veçanta, sepse në shkrimet e tyre, citatet kur'anore i kanë dhënë, krahas përkthimit, edhe në origjinal, dhe ne drejtpërdrejt vihemi para përkthimeve të Kur'anit nga dora e këtyre myderrizëve të

shquar. Nuk duhet të na çuditemi aspak nëse, nesër a pasnesër, dikush boton ndonjë punim, në të cilin do të përmbliidhte vetëm përkthimet e ajeteve të cilido nga këta autorë që i përmenda, dhe besoj se do të ishin më meritore për përpjekjet e tyre në përkthimin e Kur'anit, sesa përkthyesit që ne i përmendim si përkthyes të pjesëve të ndryshme të Kur'ani Kerimit.

Edhe pse është e vështirë për të dhënë një përgjigje të plotë se cilat ishin indikacionet që e shtynë Hafiz Ali Korçën dhe bashkëkohësit e tij të bëjnë atë që mundën në përkthimin e Kur'anit, më duket se indikacionet do të jenë të njëjta me ato që patën Mulla Sherifi, Hasan Efendiu, Profesor Fetiu (në shënimet e ardhshme këtij grupi gjithsesi do t'ia bashkëngjisim edhe Muharrem Bllakçorin e Sali Efendi Feratin), sepse këta kanë qenë njerëzit më të zgjedhur që t'i dalin zot një pune kaq me përgjegjësi dhe që të mos mbetej në dorë të diletantëve. Dhe askush nuk ka të drejtë morale të thotë, për asnjërin prej të apostrofuarve, pse këta u morën me përkthimin e Kur'anit. Jo, ata kryen një mision të shenjtë dhe pikërisht puna e tyre ka bërë që ne sot të shkruajmë e flasim rreth kësaj çështjeje.

Përkthimet e viteve tetëdhjetë

2. Historiku i përkthimeve të Kur'ani Kerimit në gjuhën shqipe,

4. Gazmend Shpuza, punimi i cituar.

5. Zani i Naltë, organ i Komunitetit Musliman Shqiptar, Tiranë 1924.

6. Kultura Islame, Komuniteti Musliman Shqiptar, E përmuajshme Fetare, Filozofike, Morale e Shoqnore, Tiranë.

7. Njeriu, Revistë e përmuajshme shpirtnore kulturore, Tiranë 1942.

pa përkthimet e viteve tetëdhjetë do të ishte i zbrazët. A thua, vallë, përkthimet brenda dhjetëvjeçarit të tetë të shek. të kaluar ishte shfryrje e ndjenjës së hidhërimit a pezmatit të akumuluar, që nga fillimi i vrazhdësisë së pushtetit monist, apo ishin përpjekje për të korrigjuar ndonjë nismë të më hershme, por të ngelur në mes të rrugës? Sido që të ketë qenë e vërteta, do të përmendim me këtë rast vetëm një detaj që nuk ka të bëjë me njerëz të proveniencës fetare, por të asaj laike. Ndoshta ishte refleksion i atmosferës politike që u krijua në vend. Hetohet njëfarë liberalizmi në shumë sfera të jetës, si në art, në kulturë, letërsi. Pa e tepruar do të përmendim vetëm një rast. Në fillim të viteve tetëdhjetë, u dëgjuan në Prishtinë njerëz që shprehnin revoltë kundër Entit të Botimeve të Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, se nuk futnin në plan botues përkthimin e Kur'anit, e në anën tjetër, autoritetet e këtij Enti, ishin qepur pas letërsisë ruse, duke botuar kolana të gjata të autorëve të kësaj letërsie. Në të vërtetë, edhe nuk mund të pritej nga entet shtetërore, që të botonin literaturë fetare, pasi ndihej njëlloj animoziteti edhe ndaj letërsisë artistike të botës arabe. Kujtojmë vetëm një vepër të Mahmud Tejmur-it, që u botua në ato vite nga "Rilindja"⁸. Me gjithë

8. Mahmud Tejmur, *Haxhi Çelebiu*, "Rilindja", Prishtinë, 1968. Përkthyer nga Hasan Kaleshi.

pengesat e ndryshme, fatmirësisht, në fund të viteve 70-të e në fillim të viteve 80-të, u hodhën hapat e para, te ne, në përkthimin e disa veprave me përmbajtje fetare. Por, kulmi i kësaj veprimtarie u arrit me punën kolosale të Hasan Efendi Nahit, Mulla Sherif Ahmetit dhe akad. Feti Mehdiut, që i hynë kësaj pune me një ndjenjë të lartë përgjegjësie, të vetëdijshëm për vështirësitë me të cilat do të ballafaqoheshin.⁹

2.1. Kur bëhet fjalë për vitet e përkthimeve të Kur'anit Kerimit, madje edhe në vitet shtatëdhjetë, në programet mësimore të Universitetit të Prishtinës, mësohej për Kur'anin, qoftë si vepër letrare, apo filozofike. Tani duam të besojmë se i është dhënë vend shumë më tepër se atëherë, por mua më habit fakti se në tekstet e shkollave të mesme, edhe sot e kësaj dite, figurojnë njësi mësimore për vepra që i takojnë mitologjive të popujve të ndryshëm, kurse për Kur'anin, me sa kam njohuri, nuk është menduar fare. Për këtë çështje, Ministria e Arsimit duhet të marrë hapat e duhura që,

9. Në këtë kontekst do të mjaftonin disa pasazhe nga kumtesa e autorit të këtij shkrimi ose e referuesve të tjerë nga punimet e sesionit shkencor kushtuar Hasan Efendisë, ku bëhet fjalë për peripecitë e tij me rastin e botimit të përkthimit të Kur'anit në Zagreb, nga Shtëpia Botuese "Ognjen Prica". Shih: *Muderriz Hasan ef. Nahit*, Jeta dhe vepra (1905-1991) Botoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012.

në programet aktuale të shkollave tona, të mësohet më tepër për librat e shpallura, sesa për mitologjitë dhe trashëgiminë letrare të popujve të lashtë. Por edhe Bashkësia Islame, duhet ta aktualizojë një kërkesë të këtillë, sepse është pjesë integrale e këtij sistemi arsimor. E shtrova këtë çështje sepse për çdo ditë e më tepër, Kur'ani si libër i shenjtë, zë vend merituar në programet mësimore të shumë vendeve evropiane, qoftë në tekstet shkollore të ciklit të mesëm apo edhe atij universitar. Si shembull më të freskët mund të përmendim Gjermaninë dhe Zvicrën.

Kur të merret parasysh kjo që po ndodh me sistemin arsimor të shumë vendeve evropiane, a thua, vallë, nuk ka ardhur ende koha që Hermeneutika e Kur'anit ose Kur'anologjia të zërë vendin e merituar edhe në sistemin tonë shkollor? Kjo për shkak se, postulatet kur'anore, sa më afër rinisë shkollore që të jenë, aq më e ndritshme do të jetë edhe ardhmja e saj, që të mund të ecë shtigjeve të jetës ballëhapur dhe të jetë mbartës i vlerave humane e universale të mbarë njerëzimit.

Ky është 30-vjetori i Kur'anit të përkthyer

3. Meqë jemi në 30-vjetorin e përkthimit të plotë të Kur'anit Fisnik, besoj se është koha të shtrohen edhe disa çështje që, deri më tani, nuk janë zbërthyer sa duhet dhe në

mënyrë analitike të jepen përgjigjet e duhura, që të dalë në pah i gjithë ai përkushtim i figurave më të ngritura që ne njohim nga vitet 80-të. Pse u derdh i gjithë ai mund jo nga një individ por nga disa syresh? Ku qëndron arsyeja e këtij angazhimi? A pati mangësi? A mos që procesi pak i shpejtuar? Për t'u dhënë përgjigje sa më të drejtë, së pari duhet të konsultohemi me ato pak shënime në parathëniet e përkthimeve përkatëse, ku fare pak janë të qëmtuara qëllimet e punës së tyre.

3.1. Sipas F. Mehdiut, në parathënien e përkthimit të parë, faqe 5, thuhet: "...përkthimi në cilëndo gjuhë, pra edhe në gjuhën shqipe, është i pamundur ta përcjellë në mënyrë adekuate origjinalin" dhe se "Njësoj sikurse edhe përkthimet dhe komentimet në gjuhët e tjera, edhe ky në gjuhën shqipe, ka për qëllim ta plotësojë një zbrazëti të kamotshme, sepse jemi ndër popujt e vonuar që Kur'anin nuk e kishim të përkthyer në gjuhën tonë".¹⁰ Kurse në përkthimin e Hasan Efendiut, në mënyrë të tërthortë, kuptojmë nga parathënia e Mulla Sadri Prestreshit, ku thuhet: "Edhe te ne, gjer tani janë bërë përpjekje për përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe, por duke shfrytëzuar përkthimet në gjuhët e tjera" dhe se "Ky përkthim është bërë nga origjinali arabisht dhe është

10. Kur'ani, përktheu Feti Mehdiu, botues: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë, 1985.

rezultat i punës shumëvjeçare të përkthyesit”.¹¹ Në të gjitha botimet e Mulla Sherif Ahmetit nuk hasa ndonjë pasus që do të hidhte dritë për qëllimin e kësaj ndërmarrje aq me vlerë.¹²

3.2. Ne që kemi pasur fatin t’i njohim nga afër përkthyesit tanë, kemi atë të drejtë të themi diçka më tepër se kushdo tjetër. Hasan Efendiu e njihnte arabishten edhe në rrafshin e leksikut të gjuhës arabe edhe në aspektin gramatikor, si student i Az’harit që ishte, por edhe kishte atë dhunti që ia kishte falur Zoti, që pas vetes, të lejë një xhevahir kaq të çmueshëm. Në anën tjetër edhe puna shumëvjeçare në mësimdhënie ia mundësoi edhe më shumë perfeksionimin e gjuhës së Kur’anit. Por shqipen, ruante atë të vendlindjes. Gjuhën e sotme letrare nuk pati rastin ta përvetësojë, por njerëzit që i ndihmuan, ishin njohës të mirë edhe të gjuhës, por edhe të botimit (tipografisë) të një veprë kapitale siç është Kur’ani.

3.3. Mulla Sherifi, nga përvoja e tij arsimore, shqipen e dinte, por arabishten e dinte aq sa mund ta dijë një person që nuk ka pasur rast të studiojë në botën arabe (kjo nuk do të thotë se për çdo përkthyes

të jetë kriter mësimi i arabishtes në ndonjërin nga shtetet arabe). Është dashur patjetër të mbështetet në përkthimet e boshnjakishtes, konkretisht ai zgjodhi metodologjinë e përkthimit dhe të komentimit të Çausheviqit.

3.4. Feti Mehdiu, mund të themi se e ka njohur shqipen, normën e sotme letrare, ka studiuar orientalistikën, e ka njohur edhe boshnjakishten, mbase edhe turqishten, madje ka qenë për një kohë edhe në Kajro në specializim të gjuhës, para se t’i rrekej përkthimit të Kur’anit. Prapëseprapë, strumbullar i përkthimit të tij është dëshira për të pasur secilin version të përkthimit boshnjakisht, dhe ai këtë e ka bërë; për nga ana metodologjike e punës është mbështetur në përkthimin e Besim Korkutit, madje nga ky përkthim ka marrë edhe parathënien e Fazlur-Rahmanit.

3.5. Secili nga emrat e përmendur ka pasur arsye shumë të fortë për punën që ka bërë. Është fakt i pamohueshëm se si këta profesorë dhe të tjerë hoxhallarë, dikush më shumë e dikush më pak, ka pasur në dorë Ajkën e kuptimeve të Kur’ani Kerimit të Hafiz Ibrahim Dalliut ose përkthimin e Hafiz Ali Korçës, por më së tepërmi janë shërbyer me përkthimet boshnjakisht. Kjo nuk vlen për punën e Hasan Efendiut. Megjithatë, nuk duam të besojmë se qëllimi i tyre ka qenë të zëvendësohet përkthimi boshnjakisht me përkthim

11. Kur’ani i Madhëruar, e përktheu nga arabishtja Prof. Hasan I. Nahi, Prishtinë, 1988.

12. Kur’an-i, Përkthim me Komentim. Përktheu dhe komentoj H. Sherif Ahmeti, Botues: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë, 1988.

shqip. Para së gjithash, jemi të bindur thellë se e kanë kuptuar si një punë sublime, të shenjtë, që fjala e Allahut të thuhet ose të ketë “hijen e tij shqip”, siç e përdori dr. Feti Mehdiu në botimin e dytë, ose të bëhet “Ndërmjetësia për të shpjeguar fjalën e Zotit... për të kuptuar shpirtërisht dhe fizikisht mesazhin hyjnor, për të kapërcyer të gjitha kufizimet njerëzore, për të arritur standardet më të fundit të kulturës, shkencës dhe qytetërimit”, siç thuhet në fjalën e botuesit, të botimit të nëntë të përkthimit të Hasan Efendi Nahit.¹³

A është arritur qëllimi final?

4. Çështja më me interes më, sipas mendimit tonë, është ajo se a është arritur qëllimi final, a i është ofruar lexuesit shqiptar version i përkryer? Ende jo¹⁴. Arsyet mund

13. Kur'an i Madhërishtëm në gjuhën shqipe, Përktheu nga gjuha arabe Prof. Hasan I. Nahi. Botues: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2012.

14. Shprehja “Ende jo”, uroj që të mos shkaktojë reagime. Për këtë arsye, duke dashur që të mos keqinterpretohet ky konstatim imi, ose të japë kualifikime superiore, qoftë për përkthimet që janë marrë në shqyrtim, apo edhe për përkthimet e tjera, në gjuhë të ndryshme, unë do të sugjeroja studimin i Enes Kariqit, ku ai jep të dhëna të hollësishme mbi përkthimet e Kur'anit duke filluar me përkthimin e Fatihës nga myslimani i parë persian (gjysma e parë e shek. VII) e deri të përkthyesit i fundit në gj. boshnjake, Besim Korkut. Po ashtu edhe punimi i prof. Nexhat Ibrahimit na ofron të dhëna të mjaftueshme për historikun e

të dalin nga ajo që u përmend pak më lart për përkthyesit e nderuar, por jemi të vetëdijshëm se edhe ata e kanë pasur të qartë se nuk do të jenë në gjendje të bëjnë një përkthim të përkryer. Megjithatë, ata kanë shpresuar në mbështetjen e shokëve e dashamirëve, redaktorëve, lektorëve, recensentëve, që përkthimi i tyre të jetë sa më afër origjinalit. Këtu mund të shtojmë një detaj nga përvoja personale, që lidhet me përkthimin e Feti Mehdiut, edhe pse në atë kohë autori i artikullit hidhte hapat e para në redaktimin gjuhësor të ndonjë shkrimi. Kur prof. Fetiu dorëzoi materialin për të bërë lekturën, i thashë vetes: po këtu paska punë për pesë vjet edhe atë duke afruar

përkthimit të Kur'anit në përgjithësi, dhe te shqiptarët në veçanti. Për më shumë shih: <http://kuranifisnik.net/kuranifisnik/Artikuj/default.asp?NrArtikull=275>.

Për ne ka rëndësi të vëmë një paralele ndërmjet përkthimit të Lubobratiqit dhe të I. M. Qafëzezit. Sepse duke e njohur sa më afër punën e Lubobratiqit, do të kuptojmë, edhe qëllimin e Qafëzezit. Në veprën e tij *Tefsir-hyrje në shkencën e tefsirit*, botim i Bosanska knjiga, Sarajevo, 1995, faqe 264, në kapitullin mbi përkthimet e Kur'anit, që nga Miqo Lubobratiqi deri te Besim Korkuti, autori na jep profilin e vërtetë të përkthyesit Lubobratiq, i cili e ka përkthyer Kur'anin nga rusishtja, ndërsa në rusisht nga frëngjishtja, edhe atë për t'i pajtuar Serbët “me muhamedanët e kombësisë serbe”. Ai njëhej si udhëheqës i kryengritësve hercegovas dhe person që proklamonte “bashkëpunimin vëllazëror të serbëve dhe myslimanëve boshnjakë” dhe ky gjest i Lubobratiqit nga ana e ulemave të kohës u trajtua si hap antiislam *par excellence*.

arabologë e albanologë të regjur, islamologë, mufessirë, kulturologë, orientalistë dhe njerëz të profileve të afërta, që puna të dalë sa më e kompletuar. Kjo ndoshta ishte e mundur të arrihej, por si duket ka munguar guximi i disa studiuesve tanë, duke menduar se nuk janë të denjë për këtë punë, dhe se është terren i panjohur për ta. Fatmirësisht ata që patën, para së gjithash, tabanin e shëndoshë fetar, edhe pse të pakët, pranuan që të japin ndihmesën e tyre, duke vënë në rrezik edhe pozitën e tyre shoqërore nëpër institucionet ku punonin.

**Përkthimi i Kur'ani Kerimit
në rrafshin gjuhësor: mbi baza
të gjuhës standarde-pa asnjë
dilemë, por jo në dëm
të origjinalit**

5. Edhe pse nuk jemi të prirur që gjërat t'i japim në superlativ, duke dashur që të jemi të realistë në këto shqyrtime, duke dashur që të themi të vërtetën shkencore, edhe në qoftë e hidhur, nuk mund të anashkalojmë një temë, a dilemë që do të ishte më e dhimbshme dhe që do të paraqiste anën tjetër të medaljes. Sado që të mundohemi ta shfaqim në formën më të zbutur, prapëseprapë nuk mundemi të mos reagojmë, pikërisht ashtu siç u reaguua 100 e sa vjet më parë në punën e Jani Vretos, kur siti fjalët e huaja (orientalizmat) nga vepra e bejtexhinjve, dhe i zhveshi nga petku

fetar dhe, siç dihet, studiuesit e të gjitha kohërave, gjithnjë e kritikuan. Edhe për përpjekjet e sotme, për hir të ruajtjes së pastërtisë së normës standarde të gjuhës së sotme letrare shqipe, nuk kanë ndihmuar as sa një pikë drejt përkimit me origjinalin e tekstit kur'anor. E kundërta ka ndodhur. E them këtë sepse, procesi i standardizimit të gjuhës letrare, është proces i gjallë, që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Do të thotë ende nuk ka përfunduar. Këtë e dëshmojnë edhe përfundimet nga mbledhja e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe, mbajtur në Tiranë më 16.04.2013 (të filluar më 2012, me rastin e -40vjetorit të mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit), ku kërkohet që fjalët Zot, Perëndi, All-llah të shkruhen me shkronjë të madhe nistore, si dhe emrat e festave Bajrami, Pashkët, Krishtlindjet. Do të dëshiroja që mu Kur'ani, gjegjësisht përkthimi i Kur'anit të ishte A-ja dhe Zh-ja e përdorimit të drejtë të terminologjisë islame. Edhe pse kjo temë u trajtua në Sesionin shkencor të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame,¹⁵ më 10 nëntor 2005, edhe sot e kësaj dite, pas njëmbëdhjetë vitesh të plota, ende hasim në divergjenca të shumta, pikë së pari rreth përdorimit të drejtë të fjalës Kur'an, e të mos

15 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës- Fakulteti i Studimeve Islame, *Terminologjia Islame*, Prishtinë 2006.

flasim edhe për një sërë fjalësh të tjera të kësaj natyre.¹⁶

5.1. Dikur edhe profesorëve tanë, kur u drejtohemish se nuk ka gjuhë në botë, në të cilën kërkohej që fjalët Zot, Perëndi, Hyjni të shkruhen me shkronjë të vogël, më thoshin: ashtu e parasheh drejtshkrimi. E sot, këtu nëse ju drejtohem, kolegëve tanë, se fjalët Kur'an, All-llah, Muhammed, etj. do të shkruhen me apostrof e teshdid, nuk e di çfarë përgjigjeje do të marrim. Me këtë rast do të paraqesim disa të dhëna të shkurtra, vetëm për fjalët All-llah, Muhammed dhe Kur'an, se si i kanë shkruar tre përkthyesit tanë. Në përkthimin e parë dhe të dytë të Feti Mehdiut këto fjalë shkruhen: All-llah, Kur'an dhe Muhammed, pra me teshdid dhe apostrof. Në botimin e parë, të vitit 1988, të Mulla Sherifit këto fjalë shkruhen: Kur'ani, Muhamedi, Allahu. Në botimin e Kajros (1992) shkruhen: Allahu, Kur'ani, Muhamedi. Në fusnotën e

16. Të gjithë mund t'i kuptojmë, por shokët tanë që kanë mbaruar Medresenë ose Fakultetin e Studimeve Islame dhe në shkrimet e veta të përdorin fjalën Kur'an (Kuran) pa apostrof ose fjalët All-llah dhe Muhammed (kur është fjala për Pejgamberin tonë a.s.) pa teshdid, me të vërtetë është e pakuptimtë. Lidhur me këtë çështje, kemi shfletuar edhe disa përkthime në gjuhë të ndryshme të botës. Kemi hetuar se gjithnjë e më tepër shihet tendenca e përdorimit të këtyre fjalëve, sa më afër gjuhës së Kur'anit, ashtu si u propozua nga shumica e referuesve në Sesionin shkencor, të shënuar në fusnotën 14.

parë të këtij botimi (f. 27) jepet ky shënim: Origjinali i këtij emri në gjuhën arabe është All-llah. Ndërsa në botimin e Medinës shkruhen: Kur'ani, Muhammedi, All-llahu. Edhe Hasan Efendiu i përdor po në këtë trajtë: All-llahu, Kur'ani, Hazreti Muhammedi.

5.2. Do të kishim dëshirë që të formohej një grup punues dhe, në mos për të gjitha, të paktën për disa fjalë, që i përdorim më shpesh, të marrim një qëndrim të prerë dhe të përdoren konform gjuhës së Kur'anit, ose le të ndodhë e kundërta; cilado qoftë zgjedhja le të më paraqiten argumente të forta e të sakta që ne të gjithë të pajtohemi me ta e t'i përdorim të gjithë njësoj fjalët e terminologjisë islame. Realisht shpresojmë që dikush të trajtojë këtë segment të rëndësishëm të përdorimit të drejtë të terminologjisë islame, qoftë në tekstet e përkthiera, ose në ato origjinale, dhe të hiqen njëherë e përgjithmonë dilemat rreth përdorimit konsekuent të fjalëve të proveniencës islame.

Si përfundim:

6. Edhe përkundër vërejtjeve që kanë pasur dhe që mund të kenë edhe sot, prapëseprapë të gjitha përkthimet e deritashme nuk janë nën nivelin e përkthimeve boshnjakisht, turqisht apo të ndonjë gjuhe tjetër. Dhe, thënë pak edhe me gjuhën e një diplomati dhe atdhetari të shquar të

viteve të tridhjeta, nuk ka qenë kurrë nevoja që të dalë dikush e të thotë: Hoxhallarë, merrni e përkthejeni Kur'anin nga arabishtja, sepse përkthimi nga anglishtja a ndonjë gjuhë tjetër, nuk vlen as për pesë pare. Ky aluzion mund të kuptohet drejt vetëm nga ata që e kanë të njohur historinë e përkthimeve të Rubairave në gjuhën shqipe, kur Rauf Fico i pati sugjeruar Hafiz Ali Korçës që të bëjë përkthimin e Rubairave nga origjinali persisht. Jo vetëm Rubairat, por edhe pjesë nga Shahnameja e Firdusit, si dhe librin Gjylistani, Hafiz Aliu i ka përkthyer me insistimin e R. Ficos¹⁷, vetëm e vetëm që t'i shmangen përkthimit të përkthimit.

17. Dr. Shyqyri Hysi, Rauf Fico - shtetar dhe diplomat i shquar (monografi), Tiranë, 2007. Në faqen 231 të kësaj monografie shkruan se parathënien e Rubairave e shkroi shoku i studimeve, Rauf Fico. Mes tjerash thuhet: "Hafiz Ali Korça, që e njihte mirë persishten, me nxitjen edhe të Rauf Ficos, bëri përkthimin e kësaj vepre madhështore persiane." Ndërsa, pak më poshtë, jepet ky pasazh nga parathënia e Ficos: "Unë prej Aliut kam marrë edhe disa mësimë persisht. Nuk besoj që të ndodhet ndonjë njeri në Shqipëri që ta zotërojë persishten kaq mirë sa ky. Ai librin 'Gjylistani', ashtu edhe disa pjesë nga Shahnameja e Firdusit, i ka përkthyer me shtytjen time". Ky shembull parashtrihet vetëm e vetëm që t'ua bëjë të ditur studiuesve tanë se, edhe sot, gjenden mecenë të vërtetë që mundohen që e vërteta shkencore të dalë në sipërfaqe. Këto të dhëna që u përmendën, si dhe faktin se Ali Asllani ka bërë përkthimin e Kur'anit në Gjuhën Shqipe, më janë konfirmuar qysh më 1991, nga Bardhyl Fico, i biri i Rauf Ficos.

19. Nuk do të ishte normale po qe se do të prananim se, me përkthimin e Kur'anit, gjithçka është në rregull. Po qe se ka njerëz që mendojnë se, çështja e përkthimeve të Kur'anit më mirë të mos preket sesa të konfrontohen njerëzit, me vend e pa vend, kjo nuk shkon, fare. Është e vërtetë se askush nuk do të dëshironte që Kur'ani të jetë, mos dhëntë Zoti, mollë sherri, shkak i zënkave ndërmjet njerëzve. Duhet marrë parasysh se shpesh na ndodh, që gjatë redaktimit të ndonjë teksti me përmbajtje fetare, na bien në sy përkthime, që detyrohemi të themi se kjo është e pamundur të jetë ajet kur'anor, dhe detyrohemi të krahasojmë më shumë përkthime, ose të kërkojmë ndihmë nga shokët e punës, që e njohin edhe arabishten edhe tefsirin, dhe t'i japim kuptimin e duhur. U përmend ky fakt me bindjen e thellë se edhe të gjithë lektorët, redaktorët, recensentët tanë përballen me të njëjtin problem.

Është fakt se me çështjen e përkthimit të Kur'anit janë marrë dijetarët më eminentë të proveniencës islame, dhe të gjithë kanë dhënë mendimet e veta lidhur me të. Duke i analizuar pohimet e tyre, mund të konstatojmë se përkthyesit e të gjitha kohërave nuk kanë qenë kategorikë që Kur'ani të mos përkthehet, por janë pajtuar që, ky thesar hyjnor, t'iu ofrohet popujve të mbarë botës. Dhe së fundi duhet të pajtohem me këto dy konstatime

që mund t'i përdorim si moto. I pari është ai i Imam Vehbi Dibrës, që del nga deklarata e tij me rastin e botimit të disa pjesëve të Kur'anit në turqisht dhe shqip. Ai thotë: "Si kur qi dihet Kur'ani asht fjala e madhnueshme e krijuesit të Gjithsis, prandaj lypset me u përkthye madhnisht e nuk asht punë qi mbarohet me pendën e meftshme të mend shkurtënve". Kurse për përkthimet me gabime thotë: "me këndue ksi soj librash se gabimet qi duken sheshit në

përkthimet e përmendura mund t'u ngatrollojnë besimin e prandaj i porosisim qi të mos u napin randsië dhe mos t'i këndojnë fare¹⁸. Ndërsa konstatimi tjetër është ai i Enes Kariqit, ku thotë: "Kur'ani nuk ka mundësi të përkthehet, por ai pa tjetër duhet përkthyer"¹⁹.

18. Deklaratë e Krye Muftiut, Zani i Naltë, nr. 12, Shtatuer, 1924, f. 384.

19. Enes Kariq, vep. e cit.

Raporti mes shtypit dhe pushtetit në Shqipëri: miratimi i ligjit osman të shtypit në vitin 1922

Hasan Bello

Qendra e Studimeve Albanologjike,
Instituti i Historisë, Tiranë

Abstrakt

Studimi i raportit mes shtypit dhe pushtetit përbën një aspekt interesant për historinë e publicistikës shqiptare. Ai është një tregues i qartë i trajektores që ka ndjekur beteja për lirinë e fjalës. Prandaj, për ta ilustruar këtë problem kemi zgjedhur vetëm një segment të shkurtër historik, por që, në vetvete, përmban një mozaik të plotë.

Ky artikull trajton debatet mbi shtypin dhe lirinë e fjalës në vitin 1922 dhe diskutimet që u zhvilluan në këtë periudhë lidhur me miratimin e ligjit osman të shtypit.

Hartimi i ligjit të shtypit, duke marrë si model legjislacionin osman, nuk u prit mirë nga disa qarqe intelektuale. Në avangardë të luftës për mbrojtjen e lirisë së shtypit ishte Faik Konica me gazetën Dielli. Ai e quante këtë vendim një “pseudo-kanun”, sipas të cilit, tani e tutje, në Shqipëri mund të qarkullonin vetëm gazeta të shitura te policia. Sipas tij, ata që nuk e donin lirinë e shtypit nuk u pëlqente drita dhe sigurinë kombëtare e vinin në rrezik. Kjo sepse Faik Konica e konsideronte shtypin si një mjet të domosdoshëm për një shoqëri, të ngjashëm me një valvul shkarkimi (“safety valve”). Kufizimi i lirisë së shtypit, sipas tij, ishte burim i tiranisë dhe gjeneronte dhunë.

Ky ligj nuk krijoi ndonjë pengesë juridike apo faktike për shtypin e kohës. Përkundrazi, gazetarët dhe intelektualët shqiptarë botuan artikuj, kritika, polemika dhe pamflete për aspekte të ndryshme social-politike. Kjo vihet re edhe nga trashëgimia e jashtëzakonshme publicistike, e cila dëshmon për një nivel të lartë profesional. Me kalimin e viteve legjislacioni mbi shtypin evoluoi në raport me zhvillimin e brendshëm të shtetit shqiptar dhe me rrethanat e reja që u krijuan brenda vendit.

I. Shtypi dhe pushteti - probleme rreth rolit, misionit dhe etikës gazetareske

Kongresi i Lushnjës i vitit 1920 krijoi premisat që elita politike e kohës të merrte masat për ndërtimin e institucioneve kombëtare dhe për hartimin e legjislacionit të nevojshëm për mbarëvajtjen e jetës politike. Në përputhje me këto rrethana, shtypi u pa si një mjet, i cili duhet t'i shërbente shtetit për të stabilizuar situatën. Prandaj, më 24 maj 1921, Ministri i Brendshëm, Mehdi Frashëri, shpërndau një qarkore ku urdhëroi: ndalimin e gazetave, të cilat botonin lajme që nxisnin popullsinë për t'u rebeluar; përgënjeshttrimin e artikujve me karakter dizinformues; si dhe mos dhënie leje për ato organe që financoheshin nga të huajt. Për të mbajtur nën kontroll këtë proces, çdo botues ishte i detyruar që një kopje ta dorëzonte në Prefekturë dhe një tjetër në Prokurori. Kjo ishte një masë frenuese pasi situata politike brenda vendit nuk ishte stabilizuar ende. Lëvizjet antiqeveritare, si nga opozita, ashtu edhe nga jashtë kufirit, ishin të pranishme nga çasti në çast. Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana një veprim i tillë ishte plotësisht i justifikueshëm.¹

1. *Qarkoret e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme të vjetit 1921*, nr. 2, Shkodër: Shtypshkronja "Nikaj", 1921, Qarkore e Ministrit të Punëve të Brendshme, Mehdi Frashëri, drejtuar Prefekturave, Tiranë, 24.5.1921, f. 13.

Në organet e kësaj periudhe, liria e shtypit perceptohej si diçka e nevojshme pavarësisht pengesave dhe artikulimeve për të si "mikrob i propagandës". Shtypi konsiderohej si i vetmi mjet për të parandaluar abuzimet e administratës dhe për ta mbajtur atë nën kontroll të vazhdueshëm për zbatimin e ligjit. Sigurisht që ekzistenca e një numri të madh gazetash do ta ulte rrezikun e përdorimit të tyre si mjet shantazhi. Prandaj, liria e shtypit eliminonte përdorimin e tyre jashtë misionit informues. Si model i shtypit shqiptar, sipas *Posta e Korçës*, duhet të ishte shtypi anglez. Gazetat britanike tashmë përbënin një model dije.² Dëshira kombëtare e quante lirinë e shtypit dhe të fjalës si pikën kryesore të qytetërimit të një populli. Ajo e konsideronte mungesën e lirisë së shtypit si shenjë tiranie. Një nga funksionet kryesore të medias së shkruar, sipas kësaj gazete, ishte mbrojtja e të drejtave të individit nga shkeljet flagrante dhe padrejtësitë. Monopolizimin e shtypit, ky organ e quante një akt djallëzor me prapavijë okulte. Ky veprim kishte si qëllim kryesor keqpërdorimin e informacionit dhe manipulimin e masave. Kjo tregon se fenomeni negativ i monopolizimit të shtypit i ka fillesat që në vitet e para të konsolidimit të shtetit

2. "Liri e Shtypit", *Posta e Korçës*, nr. 89, 25.2.1922, f. 2.

shqiptar.³ *Dëshira kombëtare* nuk ishte kundër kritikës, madje, ky organ e konsideronte kritikën si shenjë përparimi, por me kushtin që ajo t'i përmbahej parimeve dhe të mos i kalonte caqet. Ajo ishte kundër përdorimit të fjalëve që cenonin nderin e të kritikuarit. Kjo gazetë pasi vinte në dukje fuqinë që kishte shtypi për të transformuar shoqërinë, shtronte problemin se ai duhet të ishte në duar të ndershme.⁴

Në këtë periudhë gazetat konsideroheshin si mjet i nevojshëm me rol të pazëvendësueshëm për emancipimin dhe zhvillimin kombëtar.⁵ Megjithëse gazeta *Koha* e quante të domosdoshme ekzistencën e shtypit, ajo e shihte me shqetësim mungesën e profesionalizmit apo diletantizmin.⁶ Në këtë periudhë shtypi konsiderohej si formësues i opinionit publik.⁷

Megjithatë nuk munguan edhe shkrime të cilat artikulonin hapur se misioni i shtypit duhej të ishte në funksion të interesit kombëtar. Sipas Mit'hat Frashërit, detyra e atyre që shkruanin dhe botonin ishte që të ngjallnin te zemrat e lexuesit

dashurinë për Shqipërinë; të zgjonin tek ata besimin në vetvete dhe te kombi; të shtonin dëshirën për t'u bërë më të mirë, më të përparuar, më të lartësuar, duke u mbështetur te puna, vullneti dhe patriotizmi i tyre. Autori është i ndërgjegjshëm për të metat e shtypit dhe shoqërisë shqiptare. Nevojat materiale dhe morale ishin, sipas tij, një boshllëk më vete. Prandaj, ai bën thirrje se shpresa e përparimit varej vetëm nga populli shqiptar, nga puna dhe vullneti që do të tregonte.⁸ Ndërtimi dhe konsolidimi i institucioneve në këtë periudhë kishte shfaqur një sërë problemesh, të cilat vinin si rezultat i një procesi të natyrshëm. Vendi ynë ishte në fazën embrionale të shtetformimit. Mirëpo këto probleme kishin ngjallur pakënaqësi te disa individë dhe grupime politike. Kjo ishte reflektuar edhe në faqet e shtypit në trajtën e kritikave dhe polemikave, që shpesh i kalonin të gjitha caqet. Një veprim i tillë, edhe kur ishte krejtësisht i justifikueshëm, ishte me pasoja për një shtet të pakonsoliduar. Prandaj, Mit'hat Frashëri kërkoi hapur që shtypi mos t'ia thyente shpresën dhe kurajën kombit. Nuk duhej harruar se shoqëria shqiptare ishte në fillësat e jetës së saj politike dhe probleme të tilla ishin krejtësisht normale. Ai e konsideronte criticizmin si diçka të lehtë, por nga ana tjetër, kërkoi nga

3. "Liri e shtypit", *Dëshira kombëtare*, nr. 1, 11.11.1922, f.2.

4. *Po aty*.

5. Sefer O. Prishta, "Përse na duhen gazetat", *Reforma*, nr. 4, 7.4.1922, f. 2-3.

6. "Shtypi shqip këtu./Korçë", *Koha*, nr. 75, 1.4.1922, f. 1.

7. "Sa prapa jemi.../Gjendja e shtypit në Shqipëri", *Posta e Korçës*, nr. 140, 23.9.1922, f. 2.

8. Mit'hat Frashëri, "Detyra e gazetave dhe gazetarëve", *Dodona*, nr. 4-5, 1922, f. 62.

gazetarët se duke kritikuar shtetin apo qeverinë, duke nxirë gjithçka në sytë e popullit, thyhej kurajoja e njerëzve dhe ngjallej një frikë e panevojshme. Ai i referohej një thënie, sipas së cilës gjeneralët e mëdhenj ishin të mendimit se sukcesi i një ushtrie varej nga besimi që çdo ushtar kishte në vetvete. Pikëpamjen se administrata vendase mund të përparonte vetëm nëse vinin organizatorë të huaj, ai e konsideronte regresiste. Sipas Mit'hat Frashërit ata mund të kontribuonin vetëm nga ana metodologjike.⁹

Në këtë periudhë komisioni i patentës vendosi edhe një taksë për gazetarët, e cila shkonte deri në 30 f. ari në vit. Kjo u kontestua nga shtypi i kohës, duke e konsideruar si diçka të padrejtë. Sipas tyre, profesioni i gazetarit, ishte një mision dhe ushtrohej mbi baza vullnetare. Ai nuk ishte burim të ardhurash siç ndodhte me profesionet e tjera.¹⁰

Gazetat e kohës ngrinin problemin e mosinformimit siç duhej nga Zyra e Shtypit.¹¹ Kjo sidomos për lajmet e agjencive të huaja, të cilat ishte e pamundur për t'i siguruar. Vështirësia në fjalë, më tepër se mungesë vullneti për të bashkëpunuar, vinte për shkak të pamundësisë financiare që Zyra e Shtypit kishte për t'i paguar agjencive

ndërkombëtare.¹² Prandaj, Zyra e Shtypit i bëri të ditur kritikuesve se ajo nuk ishte një agjenci lajmesh, por një organ qeveritar në shërbim të shtetit.¹³

Marrëdhëniet e Zyrës së Shtypit me gazetat konsideroheshin si raporte midis dy rrymave të kundërta. Kjo për faktin se, ndërsa e para përfaqësonte qeverinë dhe interesat e shtetit, shtypi kishte si mision informimin dhe të vërtetën.¹⁴ Gazeta *Fjal e lirë* kritikoi ndalimin botimit të bisedimeve parlamentare në *Fletoren Zyrtare* dhe hyrjen e gazetës *Dielli* në Shqipëri, për shkak të kritikave të Faik Konicës ndaj qeverisë. Ajo i bënte thirrje qeverisë që për ndriçimin e opinionit publik dhe interesin e shtetit:

a) Të votonte sa më shpejt ligjin e shtypit në bazë të parimeve kushtetuese.

b) Të mbledhë një kongres i shtypit kombëtar nën drejtimin e Zyrës së Shtypit, ku të vendosej disiplina, programi i punës dhe mënyra e mbarimit të detyrës.

c) Të anulohet vendimi, i cili ndalonte hyrjen e gazetës *Dielli*, duke ia lënë këtë problem ligjit dhe gjykatës.

12. "Nga Zyra e Shtypit./Funksionet e saj", *Posta e Korçës*, nr. 92, 7.3.1922, f. 2; "Zyra e Shtypit", *Drita*, nr. 86-14, 27.5.1922, f. 1.

13. "Fletoreve. (Dy fjalë të Zyrës së Shtypit)./Mbi marrëdhëniet të Zyrës së Shtypit me organet e shtypit", *Fletorja zyrtare*, nr. 26, 10.8.1922, f. 3.

14. "Shtypi zyrtar-Shtypi kombëtar", *Fjal e lirë*, nr. 14, 16.11.1922, f. 1.

9. *Po aty*, f. 3.

10. "Një taksë për gazetarët (Lajme të brendshme)", *Fjal e lirë*, nr. 5, 16.2.1922, f. 2.

11. "Zyra e Shtypit./Roli dhe funksionimi i saj", *Posta e Korçës*, nr. 85, 11.2.1922, f. 2.

d) Të vazhdonte botimi i bisedimeve parlamentare në *Fletoren Zyrtare*.

e) Përgënjeshtimet të kishin formë zyrtare dhe të mbështeteshin mbi fakte.

Gazeta mbante një qëndrim parimor për sa i përket kritikave të shtypit. Ajo shkruante se ato duheshin bërë me edukatë, duke ruajtur nderin dhe interesat e shtetit.¹⁵ Emërimi i arbëreshit dhe gazetarit të afirmuar Dr. Terenc Toçit, në krye të Zyrës së Shtypit, u mirëprit nga intelektualët e publicistët shqiptar. Ai njihej për përvojën e çmuar, e sidomos për patriotizmin e treguar që në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Kjo u vu re edhe nga një telegram që ai i drejtoi të gjitha gazetave, ku tregohej i gatshëm për rritjen e frymës së bashkëpunimit.¹⁶

Në këtë periudhë raportet mes shtypit dhe pushtetit u karakterizuan nga problematika të ndryshme. Mihal Grameno, megjithëse ishte për ruajtjen e etikës profesionale të shtypit, përsëri ankohej ndaj dënimit

të gazetës *Koha*.¹⁷ Ai e quante këtë një vendim të padrejtë, duke kujtuar se dënime të ngjashme kishte pësuar vetëm në kohën e Perandorisë Osmane. Nuk munguan edhe raste siç ishte letra e një qytetari lidhur me një njoftim të pakonfirmuar të *Posta e Korçës*, ku ai akuzohej si kapedan (kryetar bande) dhe i biri si autor i një vrasje.¹⁸ Pasaktësi të tilla dhe sidomos fyerjet nuk ishin të rralla për shtypin.¹⁹ Madje, drejtori i kësaj gazete ishte dënuar më parë me dy muaj burg.²⁰

Ajo që vihet re në këtë periudhë është fakti se, ndaj kryeredaktorëve dhe gazetarëve, nuk munguan edhe raste të dhunshme. Një rast tipik ishte ai mbi avokat Agjah Libohovën, i cili ushtronte funksionin e kryeredaktorit të *Fjal e lirë*. Si shkak shërbeu një artikull “investigativ” që vinte në pah abuzimet e vëllezërve Kokoshi. Kjo e shtyu Muharrem Kokoshin, vëllain e kryetarit të Bashkisë së Vlorës, të shtinte me armë mbi Agjah Libohovën.²¹ Raste të dënimit

15. *Po aty*. Gazeta *Dielli* pati probleme të vazhdueshme me qeverinë dhe drejtësinë shqiptare, për shkak se Faik Konica në disa artikuj të tij, i bënte thirrje popullit për të përmbysur rendin kushtetues me dhunë. “Këshilli Ministruer-vendim për ndalimin e gazetës “Dielli”, *Fletorja zyrtare*, nr. 23, 15.5.1923, f. 1.

16. “Lajme të vendit./Telegram i Terenc Toçit me rastin e emërimit drejtor i Zyrës së Shtypit”, *Koha*, nr. 84, 3.6.1922, f. 2.

17. Mihal Grameno, “Shtypi dhe dënimet”, *Koha*, nr. 77, 15.4.1922, f. 1.

18. “Zoti Direktor i Gazetës “Koha”./Letër kundër Gazetës “Posta e Korçës” për ofezën personale”, *Koha*, nr. 101, 14.10.1922, f. 1.

19. “Lajme të vendit./U zhvillua gjyqi ndaj drejtorit të “Kohës” Koço Grameno të paditur për ofendim nga Vangjel Gollgota”, *Koha*, nr. 76, 8.4.1922, f. 2.

20. “Drejtori i “Postës së Korçës” dënohet me dy muaj burg”, *Koha*, nr. 76, 8.4.1922, f. 2.

21. “Telegram i posaçëm për gazetën tonë nga Vlora./Vëllezërit Kokoshi kërkojnë të vrasin kryeredaktorin e gazetës “Fjal e lirë”,

të gazetarëve, apo të dhënies së pafajësisë nga gjykatat, përbënin diçka normale. Kështu, vendimin e Gjyqit të Paqit për dënimin e drejtorit të gazetës *Koha* Koço Grameno me gjobë 5 f. ari për botimin e artikullit “Shqipëri apo Turqi”, Gjyqi i Diktimit e anuloi, duke e konsideruar atë si të pafajshëm.²² Por nuk munguan edhe raste kur ndodhi e kundërta²³, kur drejtorët apo gazetarët dënoheshin për hamendësime dhe epitete, të cilat nuk përbënin vepër penale.²⁴

Një aspekt tjetër kontradiktor mes shtypit dhe pushtetit ishin edhe rastet kur dizinformacionet e botuara nga shtypi i vendeve fqinje, për të destabilizuar politikisht shtetin shqiptar, botoheshin pa marrë parasysh ndikimin që ato

kishin brenda vendit.²⁵ Megjithatë raporti mes qeverisë dhe shtypit nuk karakterizohej vetëm nga konflikti dhe mosmarrëveshjet. Politikanët e kohës ishin të ndërgjegjshëm se gazetat ishin një mjet i domosdoshëm. Ato konsideroheshin si simbol i shkallës së emancipimit dhe demokratizimit të një shoqërie. Kritikën që ato bënin ndaj institucioneve shtetërore, në një vend të pakonsoliduar, përbënin rrezik për rendin kushtetues dhe stabilitetin e brendshëm. Shtypi, ashtu si krejt mekanizmat e brishtë të shtetit shqiptar reflektonte të njëjtat probleme. Prandaj, qeveritë e kohës nuk hezituan që, herë pas here, me rastin e festave kombëtare, të amnistionin paditë ndaj gazetarëve.²⁶ Në këtë segment të shkurtër historik qeveria e Iliaz Vrionit u tregua më liberalja në raport me shtypin.²⁷

II. Ligji osman i shtypit - midis aprovimit dhe kontestimit

Megjithëse qeveria shqiptare kishte hartuar një ligj paraprak për shtypin, brenda një kohe të shkurtër ai rezultoi mjaft problematik. Kjo e

Koha, nr. 98, 23.9.1922, f. 1.

22. “Nga pak dhe për të gjitha./Gjyqi i diktimit nxjerr të pafajshëm drejtorin e “Kohës”, *Koha*, nr. 91, 5.8.1922, f. 3.

23. “Dënohet drejtori i gazetës “Qarku i Bilishtit”, *Koha*, nr. 85, 17.6.1922, f. 2; Faik Konica, “Shtypi i Shqipërisë./ Gjobiten drejtorët e gazetave “Posta e Korçës”, “Qarku i Bilishtit” dhe “Koha” nga qeveria sepse kanë shprehur lirisht mendimet për ngjarjet e kohës”, *Dielli*, nr. 2463 (36), 17.6.1922, f. 8; “Veli Harshova u burgos se foli të drejtën./Kundër zgjedhjeve të Durrësit, Dibërës e Kosovës”, *Dielli*, nr. 2514 (57), 16.9.1922, f. 1.

24. “Letër e hapur Shkëlqesisë së Tij Ministrit të Drejtësisë./Kundër dënimit të drejtorit të kësaj gazete”, *Posta e Korçës*, nr. 103, 8.4.1922, f. 2; Faik Konica, “Një gazetar i burgosur./ Njoftohet nga Tirana se në Elbasan është arrestuar Emin Matraxhiu”, *Dielli*, nr. 2370 (20), 25.2.1922, f. 4.

25. “T” a mbyllim gojën?...Mbi gjyqin kundër gazetave “Posta e Korçës” dhe “Koha”, *Posta e Korçës*, nr. 104, 15.4.1922, f. 2; “Lajme të vendit./U zhvillua gjyqi për drejtorin e “Kohës”, *Posta e Korçës*, nr. 102, 4.4.1922, f. 2.

26. “Falja e shtypit. (Ligjë e rregullore)”, *Fletorja zyrtare*, nr. 57, 17.12.1922, f. 4.

27. “Mbi ligjin për shtypin”, *Posta e Korçës*, nr. 151, 18.11.1922, f. 2.

detyroi atë që të kërkonte alternativa të reja, në përputhje me specifikat e shoqërisë shqiptare.

Më 29 mars 1922, Këshilli i Naltë i Shtetit aprovoi ligjin e shtypit të miratuar nga qeveria.²⁸ Ai ishte krejtësisht, ose me pak modifikime, ligji osman i shtypit i miratuar nga Parlamenti Osman më 31 korrik 1909.²⁹ Menjëherë pas Revolucionit Xhonturk, elita politike osmane, duke marrë si model ligjin francez të shtypit, u përpoq të tregonte një frymë liberale. Prandaj, duke u nisur nga këto premisa mund të themi se karakteri krejtësisht “oriental” i këtij ligji, siç pretendonte Faik Konica, nuk është aspak i vërtetë. Përkundrazi, politikanët shqiptarë duke marrë në konsideratë: nivelin e zhvillimit kulturor dhe ekonomik të vendit; rrethanat e brendshme dhe të jashtme; të kaluarën historike të shqiptarëvenën Perandorinë Osmane për një periudhë relativisht të gjatë, vendosën që të huazonin për një fazë kalimtare legjislacionin osman. Ai u përshtat dhe u redaktua nga specialistët e Ministrisë së Drejtësisë, të cilët ishin personalitete të njohur në fushën e jurisprudencës³⁰ dhe

gjeti miratimin e plotë të Këshilli të Naltë të Shtetit dhe Kryeministrit.³¹ Ky ligj vinte bazat fillestare të mbarëvajtjes së jetës gazetareske në vendin tonë.³² Ai synonte të krijonte

1922, D. II-106, fl. 20. Letër e ministrit të Drejtësisë H. Vrioni drejtuar Kryeministrit, 9.10.1922.

31. *Po aty*, fl. 21. Letër e kryeministrit Ahmet Zogu drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, 13.12.1922.

32. *Po aty*, fl. 2-8. LIGJI I SHTYPIT

PJESË E I

Neni. 1.) Ç’do gazetë ose e përkohshme duhet me pasë një Drejtues të përgjegjshëm. Neni. 2.) Ç’do shqyphtar që ka mbarue 21 vjetë dhe që zotnon gjith të drejtat qytetnore nuk është i dënuem me ndonji shkak si mashtrim, çpërdorim besimi ose falsifikimi, mundet me u ba drejtues i përgjegjshëm i një gazete ose të përkohshme, por detyrohet të veprojë mbas këtij ligji. Drejtori i përgjegjshëm duhet doemos të dijë të këndojë e të shkruaj shqip ose atë gjuhë me të cilën do të shtypet gazeta.

Neni. 3.) Ç’do njeri që kërkon të shtypi një gazetë ose të përkohshme, duhet që të kërkojë leje me një lutje të posaçme nga Ministria e Punëve të Mbrendshme; lutja do të përmbajë pikat e poshtë shënueme:

a). Emnin e gazetës ose të përkohshmes.

b). Vendin ku do të shtypet.

c). Programin themelor.

d). Ditët e botimit.

e). Emnim, mbiemnin, moshën, vendin e banimit e nënshtetësin e lutësit.

f). Emnin, mbiemnin, moshën, banimin e nënshtetësin e Drejtorit të përgjegjshëm.

g). Emnin e gjuhës në të cilën do të botohet. Mbas kësaj lutje merret një dftesë.

Neni. 4.) Ç’do gazetë ose e përkohshme që shtypet pa u paraqitë lutja e sipërthanun, ndalohet që atë çast dhe botuesi dënohet me 100-1000 fr. ar gjobë nga ana e gjykatores. Në qoftë se ky faj përsëritet, 200-2000 fr. ar

28. Arkivi Qendror i Shtetit (*AQSh*), Fondi (F): Ministria e Drejtësisë, Viti (V) 1922, Dosja (D): II-106, fl. 1. Letër e kryeministrit Xhafer Ypi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e ligjit të shtypit, 9.4.1922.

29. Orhan Koloğlu, *Osmanlı dönemi basınının içeriği*, Istanbul: Istanbul Üniversitesi İletişim Fakültesi Yayınları, 2010, s. 239-244.

30. *AQSh*, F: Ministria e Drejtësisë, V.

ose nga 24 orë deri një muaj burg. Në qoftë se landa e gazetës ose e përkohshme mbas ligjit meriton një ndëshkim ma të fortë, veprohet mbas asaj. Në qoftë se përmbajtja e lutjes kundërshton më të vërtetën ose veprohet kundra përmbajtjes së lutjes, lutja quhet si e paparaqitun dhe veprohet mbas ligjit.

Neni. 5.) Çdo gazetë ose e përkohshme ashtë pronë e të zotit; mundet që të shkojnë dhe në pronësi të një tjetrit. Kur vdes i zoti i mbetet trashigimtarvet të tij dhe vazhdohet në botim nën përgjegjësinë e një drejtorit të përgjegjshëm.

Neni. 6.) Emni i një gazete ose i një të përkohshme nuk mund të përdorohet prej tjetrit kuej as drejtë për drejtë dhe as me një ndyshim që t'i përngjasin asaj. Emni i një gazete ose i një të përkohshme që nuk asht shtypë prej 15 vjetëve e këndej, mundet të përdorohet edhe prej tjetrit.

Neni. 7.) Në qoftë se Drejtori i përgjegjshëm vdes ose me ndonji dënim të gjykatores; largohet nga drejtoria e përgjegjshme ose bahet ndonji ndryshim në përmbajtjen e lutjes që duhet të jenë e paraqitun, mbas nenit tre (fundi në 5 ditë e sipër) duhet të lajmërohet Ministria e Brendshme; në qoftë se vijohet në botim pa u vrejt kjo pikë, zbatohet përmbajtja e nenit 4.

Neni. 8.) Kryetarët e administratës, Prokurorët ose Drejtori i Shtypit, kurdo herë kanë të drejtë të kontrollojnë burimet e të ardhunave e shpenzimet e njëgazete ose të përkohshme. Në fund të hetimeve, në qoftë se dalin në shesh që janë edhe disa burime të mshefta e të dyshimshme, q'atë çast ndalohet botimi i saj. Në qoftë se ajo fuqi që e mburon e përmban gazetën me ndihma të hollash e ka një qëllim të msheftë për me ngatruë qetësinë e vendit ose kërkon të ndryshojë formën e qeveris ose vepron me sigurie interesat politike t'asaj fuqie drejtori i përgjegjshëm dhe shkrimtarët e artikujve të dyshimshëm, gjykohen mbas njejeve të posaçme të ligjit ndëshkimor.

PJESË E II

Neni. 9.) Drejtorat e përgjegjshëm për herë me të botuem fletoren, janë të detyruem me u paraqitë nga një copë tue e vertetue me nënshkrimin e tyre:

1) Në Ministrinë e Punëve të Brendshme
Në Drejtori të Shtypit

Në ma të madhin nënpunës t'administratës s'atij vendi

Në prokurori të vendit

Drejtorët që nuk i shtrohen këtij nyji për ç'do numër, dënohen me nga 10 fr. ar gjobë.

Neni. 10.) Në krye ose në fund të ç'do gazete a të përkohshme, duhet të shënohet emni i drejtorit të përgjegjshëm; përkundrazi u merret 20 fr. ar gjobë. Të pa shënuemit e emnit të drejtorit të përgjegjshëm, nuk e shpëton drejtorin e asaj fletorje nga përgjegjësia ligjore.

Neni. 11.) Ata që shesin ose ata qëshpërndajnë të përditshme e sende të shtypme, munden të përflasin vetëm emnat e shkrimtarëve a të fletorevet e të çmimeve të tyre. Të përdorunit e titullave a t'emnave të turpshëm e të thanunit të fjalve të ndyta që çnderojnë një person ose një trup edhe të bërtitunat në një mënyrë që shkaktojnë shqetsimin e popullit asht krejt e ndaluem. Kundërshtarët dënohen me 5 deri në 20 fr. ari gjobë ose në 24 orë deri në një javë burg.

Neni. 12.) Nënshkrimet ligjore që rrjedhin nga përmbajtjet e fletoreve me rradhë i përkasin:

- 1.) Drejtorit të përgjegjshëm
- 2.) Administratorit të gazetës
- 3.) Shkrimtarit t'artikullit

5.) Atyne që shesin e shpërndajnë gazetat

Pa qenë e mundun të ngrehunit të gjyqit kundra drejtorit të përgjegjshëm, nuk mundet me u ngrehë gjyqi kundra atyne që mvaren prej tij. Administratori i gazetës në qoftë se nuk administrohet prej drejtorit të përgjegjshëm dhe shkruesi i artikullit përherë gjykohen si bashkë-veprues. Drejtori i përgjegjshëm e pronari i gazetës janë të përgjegjshëm për dame që bahen

dhe për shpërblime që vendosen nga ana e Gjykatores.

Neni. 13.) Kushdo që sheh vehten e tij të damtum moralisht e materialisht nga botimet e fletorevet, ka të drejtë me u drejtue në gjykatore dhe me u ankue mbas nenit 12, kundra atyne që janë të përgjegjshëm. Për të lypunit e shpërblimeve nuk ka nevojë me dhanë një protestë ma së pari. Gjyktorja mundet me gjykue përmbi dëmet materiale e morale që mund t'i ken tskue ankuesit një shpërblim të arsyeshëm, veç kësaj gjykohet dhe ndëshkimi që cakton ky ligj. Gjykesa e gjykatores do të shpallet plotësisht në numrin e parë ose në të dytën tuj fillue prej ditës komunikimit; në mos u shtypet në këto dy numra, merret njëmij (1000) fr. ar gjobë. Gjyktorja mundet me gjykue e mundet me vendos që gjykesa të shpallet edhe në gazetë tjerë tue pagunun shpenzimet nga ana e fletores së ndëshkueme.

Neni. 14.) Fletoret munden të botojnë vendimet e çfar do këshillave ose gjykatoreve, por nuk munden të botojnë vendimet e një gjyqit a të një komsis zyrtare që ka rrjedhë mbas ligjit msheftasi. Në qoftë se botohet rrjedhja e ndonji gjyqit ma së fundit duhet të botohet edhe vendimi që nepet mbi ato çashtje; ato që veprojnë kundra këtij ligjit dënohen me 100-400 fr. ar gjobë.

Neni. 15.) Gjykatoret mundin të urdhënojnë ndalimin e botimit të shpjegimevet demoralizuese që mund të bahen me ndonji Gjyqë që vazhdon sheshazi. Ata që shtypin sendet e ndalueme, dënohen me 40-200 fr. ar ose 24 orë deri me një javë burg.

Neni. 16.) Ligjet dhe rregulloret nuk munden të botohen para se të shpallen zyrtarisht. Ata që veprojnë kundra këtij nyji, dëmtohen me 40-200 fr. ar gjobë e në u dashtë, mund të konfiskohen të gjith aktet e shtypuna.

Neni. 17.) Në qoftë se botohet ndonji send tue çnderue ndonji fe ose shtypen artikulla që mund të shtijnë dasie e idhnim midis pjestarëvet të fevet të ndryshme mbas nenit

12 të përgjegjshmit dënohen me 6 muaj deri në tri vjetë burg, dhe me një gjobë 400-1000 fr. ar. Këto dy ndëshkime munden të vendosen prej një herit ose njoftohet vetme me njënjën. Biseda e shkresa ditunije e filozofike që bahen tue u mbështet mbi dokumenta nuk quhen çnderime.

Neni. 18.) Në qoftë se botohen artikulla që shtynë popullin për me ba ndonji nga krimet që tregohen në pjesën e dytë të ligjit ndëshkimuer, simbas nenit 12, përgjegjësit dënohen si dhe kriminelët që kanë ba atë krim; por në qoftë se botimet e bame nuk shkaktojnë ndonji veprim, përgjegjësit dënohen me burgim të përjetshëm.

Neni. 19.) Ata që marrin të holla ose përfitojnë me ndonji mënyrë, dhe ata që dëshirojnë të marrin para ose të përfitojnë duke tremë me të çpallunit ose me të çpifunit e ndoji sendit mund të prishin nderin ndonji njeriut, dënohen nga tre muaj deri në tri vjetë burgim dhe me 200-2000 fr. ari gjobë.

Neni. 20.) Ata që botojnë ose çpallin lajme të rreme, të çpifuna a të falsifikueme ata që çpallin letra a lajme të pa kenuna në emën të tjetër kuj dhe me këtë mënyrë shkaktojnë prishjen e qetesisë, dënohen me 6 muaj deri në dy vjetë burg me 100-1000 fr. ar ose dënohet me njatin prej këtyne ndëshkimeve.

Neni. 21.) Për artikulla ose për fytyra që shtypen e që kanë një formë jasht moralit, mbas nenit 12 përgjegjësit i merret 40-200 fr. ar gjobë.

Neni. 22.) Gazetat e të përkohshmet janë të detyrueme të shtypin:

Përgënjeshtimet që do bahen nga ana e qeverisë (përgjegjja duhet të mos jetë e gjatë ma tepër se dy herë nga ajo që ka shkruar fletorja). Këto përgjegje e përgënjeshtime shtypen në fletën e parë t'asaj fletoreje ose në atë shtyllë që asht botue lajmi i përgënjeshtimit; përkundrazi përgjegjësit i merret 100-1000 fr. ar gjobë.

Neni. 23.) Të përsëritunit e fajeve të sipërthanun njihen si shkak shtërngimit.

Neni. 24.) Prokurori ngref padie kundra

fletoreve që botojnë sende që janë tregu në N. 18. Qeveria në qoftë se e shef me nevojë, mundet me ndalues botimin e fletores deri në mbarim të gjyqit. Në qoftë se Gjyktorja vendos mosfajinien e tij, drejtori ka të drejtë të lypë damin që i ka shkaktue nga ndalimi i botimit.

Neni. 25.) Ndëshkimet që janë tregue në kto ligje, për fajet e shtypit, zbatohen për gazetatat, të përkohshmet, për fytyrat që shtypen në të, dhe për letra dhe shpallje të shtypuna që përndahen ose shiten, për tabllot e zadhanjet që mvaren në rruga e në vende tjera të përgjithshme.

PJESË E III

Neni. 26.) Të shpifunat që bahen mbi ndonji pikë të posaçme, dhe të shamet që shkaktojnë të fymit ose shnderimin e një njeriu ose të një grupi quhen shnderime. Ata të shpifuna që bazohen mbi ndonji pikë të posaçme quhen të shame. Kritikata me nder e me logjikë kurr ndonji herë nuk mund të quhen si një faj.

Neni. 27.) Artikullat që përmbajnë fjalë, të shame ose shnderime kundra personave që përfaqsojnë fuqinë e fronit mbas nenit 12 përgjegjësit dënohen me tre muaj deri në tri vjet burg.

Neni. 28.) Për shnderime e të shame që bahen me një muaj deri me një vjetë burgim.

Neni. 29.) Të shamet e shnderimet që bahen kundra Këshillit Kombëtar e kundra Gjykatoreve, Ushtrisë e zyrave tjera ose kundra nëpunësve politikë e të përfaqësuesave të shteteve të huaj që ndodhen në Shqipëri, mbas nenit 12, përgjegjësi dënohet me 15 ditë e deri në 6 muaj burgim ose me 100-1000 fr. ar gjatë të dy ndëshkimet mund të bahen edhe të dyja për një herit. Në të shamet, ndëshkimi mund të bahet nga një javë deri edhe në tre muaj burgim e tue marrë nga 20-500 fr. ar gjobë; mund të zbatohet vetëm njana prej të dyjave. Në se i shami a i shnderumi lypë edhe shpërblimin e nderit, Gjyktorja dhe përmbi këtë pikë, jep një vendim të posaçëm.

Neni. 30.) Për të shame a shnderime që bahen kundra kujdo që të jetë nga populli a mbas nenit 12 përgjegjësi dënohet nga një javë deri në tre muaj burgim dhe bashkarisht nga 40-500 fr. ar gjobë, por mundet edhe me gjykue vetëm njena prej këtyne ndëshkimeve. Për të shamet dënohet nga një javë e deri në një muaj burg e nga 20-300 fr. ar gjobë ose mund të gjykohet vetëm njena prej këtyne dy ndëshkimeve; i shami a i shnderumi në qoftë se shef vehten e tij të dëmtuem, gjyktorja veçanërisht vendos edhe shpërblimin e dëmit.

Neni. 31.) Për të shamet e shnderimet që bahen kundra Ministrive e anëtarëve të Këshillit Kombëtar e kundra nëpunësisë së shtetit, zbatohet me doemos përmbajtja e nenit 30. E shamja ose shnderimi që bahet, në qoftë se i takon detyrave të nëpunësit të tyne veprohet mbas nenit 28. Por në qoftëse shnderimet që bahen kundra të sipërthanunave e kundra shoqënieve tregtare e financjare që janë formue tue qitë obligacione e i u bahen vetëm për veprat që u takojnë nëpunësisë tyne tue caktue një faj të posaçëm, dhe kjo gjë vërtetohet dhe në rrjedhje të Gjyqit. Përgjegjësit për botimet e banuna nuk mund të dënohet.

PJESA E IV

Neni. 32.) Për shnderime e të shame që bahen:

- 1) Kundra fuqisë së fronit
- 2) Kundra Ministrinave
- 3) Parlamentit
- 4) Për botime që shkaktojnë armiqësi ose dasi midis pjesëtarëve të fevet të ndryshme
- 5) Për botime që mbahen me qëllim të ndryshimit të formës qeveritare
- 6) Botimet që bahen kundra presionit moral t'ushtrisë dhe për botimet që bahen kundra mbretërve e Kryetarëve të Shteteve të huaj, dhe për nëpunësit diplomatik të tyre. Prokurori vetiut ban gjumimet e duhuna; për të huajt shkresa e Ministrit të Punëve të Jashtme.

Neni. 33.) Gjykimet që rrjedhin nga fajet

një ekuilibër të brendshëm midis organeve të shtypit, administratës shtetërore, qeverisë, politikanëve, individit dhe interesit kombëtar. Kjo për faktin se institucionet kombëtare ashtu si demokracia e brendshme kushtetuese ishin në fazën embrionale të konsolidimit. Në këtë periudhë roli i shtypit konsiderohej

e shtypit, shikohen vetëm në Gjykatoret e Përgjithshme për të shamet e shnderimet që bahen kundra atyne që nuk janë shamë në nyji 32, shikohen vetëm mbas një lutje që mund të nepet nga ana e shamit ose të shnderumit.

Neni. 34.) Padimet që i bahen masi të shkojnë tre muaj nga dita e botimit, nuk merren parasysh.

Neni. 35.) Në kohë të mobilizasionit ose kur asht frigo luftet të botimit e lajmeve që i përkasin veprave ose veglave të mbrojtjes s'Atdheut janë të ndalume, dhe urdhuni i ndalimit shpallet nga ana e Qeverisë. Në kët kohë shpallen vetëm lajmet që nep qeveria. Ata që kundërshtojnë dënohen me 1000-4000 fr. ar gjobë e 6 muaj deri dy vjet burgim. Mund të gjykohen me njanën prej këtyne dy ndëshkimeve.

Neni. 36.) Të përkohshmet që nuk merren me politikë dhe kanë të bëjnë vetëm me dituni e me literatyrë quhen si libra e nuk hyjnë në rreth të këtij ligji.

Neni. 37.) Gazetat ose të përkohshmet që shtypen në vende të huaja mund të ndalohen nga hyrja me vendim të Këshillit Ministrues. Ministri i Punëve të Brendshme mundet me urdhnuet vetë ndalimin e një numri. Ata që shesin ose i shpërndajnë fletoren e ndalueme dënohen me 300-40 fr. ar.

Neni. 38.) Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Drejtësisë janë të detyrueme me zbatue këtë ligjë.

Kryeministri

Ministri i Punëve të Brendshme.

si një mision në shërbim të ngritjes së shtetit, edukimit të qytetarëve me frymën kombëtare, bindjes së tyre ndaj ligjeve dhe emancipimit kulturor. Pretendimet e shfaqura në këtë periudhë, krahasimet me legjislacionin evropian apo amerikan nuk përputheshin me realitetin faktik. Në një vend të pakonsoliduar politikisht, me fqinjë që shfaqnin haptazi pretendime territoriale dhe me një ekonomi të dobët, liria e shtypit nuk mund të ishte mbi këto standarde. Prandaj, synimi kryesor i shtetarëve shqiptarë në këtë periudhë nuk ishte kontrolli dhe censurimi i shtypit, por vendosja e tij në shërbim të interesave të vendit. Kjo u vu re edhe në miratimin e ligjit për shtypshkronjat,³³ i cili, po

33. *Po aty*, fl.16-17. **LIGJA E SHTYPSHKRONJAVE**

Pjesa e I.

KREU I.

Neni 1. Cili do që i jep një letërlajmim zyrës Administratës dhe një kopje prokurories së vendit mundet të hapë lirisht shtypshkronjë.

Letër-lajmimi do të përmbajë:

1).Emnim e mbiemnin dhe banimin e drejtorit të shtypshkronjës dhe të shokve.

2). Në cilën gjuhë do të punojë.

Neni 2. Ç'do ndrrim i drejtorit dhe ndrrimi vendit të shtypshkronjës do t'i lajmohet administratës e prokurories.

Neni 3. Kush do qi hap shtypshkronjë tue mos plotsue përmbajtjen e nenit 1 e 2 dhe shtyp libra fletore tj., gjobitet me 20-100 fr. ari.

KREU II

Mbi shtypshkrim të librave dhe të përkohshmeve

Neni 4. Pa qenë nevoja me marrë leje editorët mund të shtypin, ç'do farë libri e të përkohshme mbi ditunitë, shkencat, literaturë e mbi mjeshtërit. Vetëm janë të detyrur me i dërgue të nesërmen të shtypshkrimit një copë Prokurories dhe dy Bibliothekës së Shtetit, përkundrazi dënohen në 400 fr. ari gjobë.

Neni 5. Botimet e përmenduna në nenin 4 janë pronë të autorit të cilat mund të shiten dhe trashgohen prej trashëgimtarëve në vdekjen e tyre. Por, në qoftë se pronarët 15 vjet me rradhë nuk miren me botimin e tyre e bjerrin në drejtim të ndalimit të ribotimit. Kushdo që vepron kundra paragrafit të parë të këtij neni dhe i shtyp pa lejen e të zotit.

Neni 6. Kushdo që lajmon një emën të rremë për emnin e vet dhe tregon si vend të shtypshkronjës një vend kundra të vërtetës gjykohet 200 deri 400 fr. ari.

Neni 7. Pjesa ndëshkimore e ligjit të shtypit përfshin dhe botimet e banuna me anë të librave dhe të përkohshmeve.

Pjesa e II mbi rregullat procedurale

Neni 8. Kjo ligj zbatohet nga ana e gjyqeve të drejtësisë dhe për shikimin e ç'do çashtje të përmendun në të lypet kërkimi i Prokurorit.

Neni 9. Përsëritja e fajeve të përmenduna në këto ligje, numurohet si shkak randësuer.

Neni 10. Me përjashtim të shkrimeve t'akteve private si dhe të shtypshkrimeve të posaçme të zyrave, sipër ç'do akti, libri etj., që të shtypen do të shënohen emni dhe vendi i shtypshkronjës kontrë-vajtësit me 20-100 fr. ar.

Neni 11. Nënshtetasit e huej për me çelë shtypshkronjë në Shqypnie janë të detyruar me marrë leje prej Këshillit Ministrues me ndërmjësie të përfaqësuesit të shtetit të tyre.

Neni 12. Shtypshkronjat e tashme janë të detyruar me plotsue kushtet ligjore të përmenduna në këto ligje mbrenda një muaji mbas shpalljes së saj. Për kundra vajtësit vepron si mbas nenit 3 të kësaj ligje.

Neni 13. Ky ligj zbatohet baraz dhe për

ashtu, u përkthye dhe u përshtat nga legjislati osman.³⁴ Me shumë pak ndryshime këto ligje vazhduan të aplikoheshin edhe në Turqinë e Mustafa Qemal Ataturkut deri në vitin 1931.³⁵

Mirëpo hartimi i ligjit të shtypit, duke marrë si model legjislatin osman, nuk u prit mirë nga disa qarqe intelektuale.³⁶ Në avantgardë të kësaj lufte ishte Faik Konica me gazetën *Dielli*.³⁷ Ai e quante këtë ligj

nënshtetasit e huej.

Neni 14. Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Drejtësisë detyrohen me zbatimin e kësaj ligje.

34. Orhan Koloğlu, *Osmanlı dönemi basınının içeriği*, s. 244-245.

35. *Po aty*.

36. "Ligji i shtypit", *Drita*, nr. 120, 8.12.1922, f. 2.

37. "Me ç'fuqi vë nome?./Mbi ligjin e shtypit në të botuar në "Dit e re", *Dielli*, nr. 2481 (39), 8.7.1922; "PERINDAT tiranike që përsëriten./Mbi ligjin e Shtypit në Shqipëri", *Dielli*, nr. 2481 (39), 8.7.1922; "Shtypi ynë./Mbi gjendjen e shtypit në Shqipëri", *Dielli*, nr.2453, 6.6.1922; "Me ç'fuqi vë nome?./Kryeartikull mbi ligjin e shtypit në Shqipëri", *Dielli*, nr. 2464, 19.6.1922; Faik Konica, "Liria e shtypit./Kufizimi i të drejtave të shtypit në Shqipëri dhe liria e shtypit shqip në Amerikë", *Dielli*, nr. 2469 (37), 24.6.1922; "Ligji i Shtypit./Shqetësim i organeve të shtypit për kufizimet nga "Ligji i Shtypit./Mbi daljen së shpejti të gazetës "Shqiptari i Amerikës", *Dielli*, nr. 2472, 28.6.1922; Faik Konica, "Sotir Peci, Refik Toptani, Xhafer Ypi, Ahmet Zogu, Hysen Vrioni./Janë ata që aprovuan ligjin për heqjen e lirisë së shtypit në Shqipëri", *Dielli*, nr. 2476 (38), 1.7.1922; "Kufizimet e Qeverisë për shtypin shqiptar", *Dielli*, nr. 2478, 5.7.1922; Faik Konica, "Emrat e pesë

një “pseudo-kanun”, sipas të cilit, tani e tutje, në Shqipëri mund të qarkullonin vetëm gazeta të shitura te policia.³⁸ Sipas tij, ata që nuk e donin lirinë e shtypit nuk u pëlqente drita dhe sigurinë kombëtare e vinin në rrezik. Kjo, sepse Faik Konica e konsideronte shtypin për një shoqëri si një mjet të domosdoshëm, të

njerëzve që propozuan ligjin për mbyajtjen e lirisë së shtypit: Sotir Peci, Refik Toptani, Xhafer Ypi, Ahmet Zogu, Hysen Vrioni”, *Dielli*, nr. 2501 (44), 5.8.1922; Faik Konica, “Sotir Peci, Refik Toptani, Xhafer Ypi, Ahmet Zogu, Hysen Vrioni: propozuan “ligjin” për heqjen e lirisë së shtypit”, *Dielli*, nr. 2502 (45), 9.8.1922; “Kanuni dhe liria e fjalës./Për lirinë e shtypit”, *Dielli*, nr. 2510 (53), 2.9.1922; Faik Konica, “Organi zyrtar i sodoimitëve./Fletorja zyrtare dhe qëndrimi i saj ndaj shtypit shqiptar në Amerikë”, *Dielli*, nr. 2534 (77), 22.11.1922.

38. Faik Konica, “Policia vendos në Shqipëri se cila gazetë duhet të qarkullojë”, *Dielli*, nr. 2463 (36), 17.6.1922, f. 8.

ngjashëm me një valvul shkarkimi (“safety valve”).³⁹ Kufizimi i lirisë së shtypit, sipas tij, ishte burim i tiranisë dhe gjeneronte dhunë.⁴⁰ Megjithatë, ky ligj nuk krijoi asnjë pengesë juridike për shtypin e kohës. Përkundrazi, gazetarët dhe intelektualët shqiptarë botuan artikuj, kritika, polemika dhe pamflete për aspekte të ndryshme social-politike. Kjo vihet re edhe nga trashëgimia e jashtëzakonshme publicistike, e cila dëshmon për një nivel të lartë profesional. Me kalimin e viteve legjislacioni mbi shtypin evoluoi në raport me zhvillimin e brendshëm të shtetit shqiptar dhe me rrethanat e reja që u krijuan brenda vendit.

39. Faik Konica, “Pse duhet liria e shtypit?/ Mbi heqjen e lirisë së shtypit në Shqipëri”, *Dielli*, nr. 2476 (38), 1.7.1922, f. 5.

40. “Kanuni dhe liria e fjalës”, *Dielli*, nr. 2512 (55), 2.9.1922, f. 3.

Mbikëqyrja fetare ose Ihtisabi ndaj prindërve - rregullat dhe etika - II

Dr. Sedat Islami
Kosovë

Abstrakt

‘Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja’ është një nga institucionet fetare më të rëndësishme. Ai garanton zbatimin e ligjit të Zotit në shoqëri dhe ruajtjen e kësaj të fundit nga dukuritë negative. Për shkak të kësaj rëndësie që ka, në Kur’an (9:71), është përshkruar edhe si detyrim që rrjedh nga vëllazëria fetare. Duke qenë se ka këtë pozitë, atëherë, si institucion, është normuar me rregulla dhe etikë përkatëse, në mënyrë që të parandalohet manifestimi i gabuar i tij, i cili mund të ketë pasojat e veta. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja ka vazhduar si organ shoqëror e shtetëror për shekuj. Me kalimin e kohës, perceptimet e mangëta përkitazi me të, si institucion, filozofi dhe botëkuptim, kanë çuar në aplikimin e gabuar të tij. Është gabuar, përveç të tjerash, edhe në raport me prindërit. Ky punim vjen për të treguar aspektet se ku është gabuar me prindërit dhe cilat janë format e miratuara, fetarisht, për ushtrim të tij në raport me ta.

Fjalët kyçe: *respektimi i prindërve, mbajtja e lidhjeve familjare, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, ihtisabi ndaj prindërve, kundërshtimi i prindërve, shpëputja e lidhjeve familjare.*

1.3. Rregulla të përgjithshme të Ihtisabit

1.3.1. Baza fetare e Ihtisabit

Ihtisabi, si organ, është konfirmuar me tekste nga Kur’ani, Suneti, konsensusi i dijetarëve myslimanë dhe arsyeja. Imam Neveviu duke folur për largimin e të keqes thotë: ‘...*Ndalimi nga e keqja është urdhër me konsensus të umetit. Kur’ani, Suneti dhe konsensusi janë unanimë sa i përket obligimit të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.*’¹

Në vazhdim disa dëshmi ilustruese për Ihtisabin dhe pozitën e tij në fe.

Sa i përket Kur’anit, si dëshmi ilustruese, do të përmendim ajetin që e cituam sipër: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** [Ali Imran: 104]

Sa i përket Sunetit, si dëshmi do të përmendim hadithin e Ebu Seid el-Hudrij: *“Kush sheh ndonjë të keqe, atëherë le ta largojë me dorën e tij, nëse nuk mundet, atëherë me gjubën e tij, e nëse as kështu nuk mundet, atëherë me zemrën e tij dhe kjo është grada më e ulët e besimit (në ndalimin/largimin e së keqes).”* [Transmeton Muslimi.]

Sa i përket konsensusit, atë e kanë

përcjellë dijetarë të shumtë, si: Imam Gazaliu, Imam Neveviu, Ibn Abdul Berr-ri, Ibn Atijje, Kurtubiu, Alusi, Sheukani, Ibn Hazmi, Xhuvejni, etj.²

Ihtisabi është konfirmuar si nevojë shoqërore edhe nëpërmjet logjikës. Nëse trupi i cili është i sëmurë ka nevojë të mjekohet, ndryshe sëmundja e përfshin tërë trupin edhe e shkatërron atë, atëherë edhe shoqëria ka nevojë të kurohet nëpërmjet urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.³

1.3.2. Norma fetare e Ihtisabit

Ihtisabi është obligim, të cilin askush prej dijetarëve myslimanë nuk e ka vënë në pikëpyetje, sepse, siç përmendëm, ai është vërtetuar me Kur’an, Sunet dhe konsensus. Ajo për çka kanë diskutuar dijetarët myslimanë dhe kanë shfaqur mendime të ndryshme ka të bëjë me llojin e këtij obligimi, respektivisht a është obligim individual (farz ajn) për secilin besimtar apo është obligim parcial (farz kifaje), që në rast se një pjesë e umetit e kryen, pjesa tjetër lirohet nga përgjegjësia. Secili nga taborët ka mbrojtur qëndrimin e vet me argumente nga Kur’ani dhe Suneti. Si argument kryesor të dyja grupet kanë ajetin: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për**

1. Shih: En-Nevevi, Jahja bin Sheref. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sahibi Muslim bin El-Haxh-xbaxh*. Bejrut: Dar ihja et-turath el-arabij. 2/22.

2. Shih: Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma’ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 27-28.

3. Shih: Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma’ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 28-29.

në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.” [Ali Imran: 104]

Grupi i parë ka nënkuptuar me këtë ajet obligimin për secilin besimtar. Sipas tyre, pjesëza ‘min’ (... **prej jush një grup...**) është për të shpjeguar llojin e jo për ta specifikuar dhe veçuar atë. Ndërsa grupi tjetër, pjesën në fjalë e kanë interpretuar si pjesëz veçuese, respektivisht kanë thënë se me të synohet vetëm një pjesë e besimtarëve dhe jo tërësia apo kolektivi. Pavarësisht këtyre interpretimeve, mospajtimi duket sikur është më shumë formal se përmbajtjesor. Kjo për shkak se që të dyja grupet mendojnë se obligimi i ihtisabit është relativ, respektivisht mund të jetë obligim individual, ashtu siç mund të jetë obligim parcial. Kjo përcaktohet nga gjendja dhe rrethanat. Në qoftë se dikush gjendet në një mjedis ku nuk ka dije për fe askush tjetër përveç tij, e ndërsa ndihet nevoja e ushtrimit të këtij organi, atëherë ai e ka obligim individual (farz ajn), ashtu siç është e tillë norma kur të jenë shtuar të këqijat, siç ndodh në kohën tonë. Ndërsa në raste të tjera kur ekziston një grup që ushtrojnë këtë funksion dhe të këqijat nuk janë të përhapura në shkallë shqetësimi, atëherë norma mbetet parciale (farz kifaje).⁴

4. Shih: En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sahibi Muslim bin El-Haxh-xhaxh*. Op. cit. 2/23.; El-Bejanuni, Muhammed Ebu-

1.3.3. Disa rregulla dhe kriteret të përgjithshme të Ihtisabit

1.3.3.1. Kush urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja?

Gjatë shtjellimit të normës së Ihtisabit, mësuam se të gjithë, në një formë ose një tjetër, janë të obliguar me të. Bazuar në këtë aspekt, Imam Gazaliu shprehet se çdokush që e sheh një të keqe dhe ka mundësi ta largojë atë, obligohet me këtë detyrë.⁵

Ky rregull është me rëndësi të veçantë, sepse, siç do të mësojmë në pjesën vijuese, ai legjitimon fëmijën që ta urdhërojë prindin për të mirë dhe ta ndalojë nga e keqja. Po kështu është edhe dëshmi se çdokush urdhëron për të mirë, duke zhvleftësuar mendimin ose idenë se me këtë detyrë merren vetëm ata që janë të ngarkuar nga shteti. Imam

1-Fet’h. (1995) *El-Mad’hal ila Ilmi-d-Da’veti – dirasetun menbexhijjetun shamiletun li-taribi-d-Da’veti ve usuliha ve menabixhiha ve esalibiha ve vesailiha ve mushkilatiha fi dav’i en-nakli ve-l-akli*. Ed. 3. Bejrut: Muessesetu-rr-rrisaleh, f. 31-35; Habeneke El-Mejdani, AbduRahman. (1996) *Fikhu-d-Da’veti ila All-llabi ve fikhu-n-nus’hi ve-l-irshad ve-l-emri bi-l-ma’ruf ve-n-nehji ani-l-munker – dirasetun istinbatijjetun teshtemil ala bejan vuxhubiha ve ususiha ve menabixhiha ve subuliha ve vesailiha ve adabiha ve nemadbi-xh min tatbikatiba*. Damask: Daru-l-kalem. 1/47-50.; Bin Baz, Abdul Aziz. (2002) *Ed-Da’vetu ila All-llabi ve ablaku-d-Duat*. Ed. 4. Rijad: Riasetu Idareti-l-Buhuthi-l-Ilmijeti ve-l-Ifta, f. 15-17.

5. El-Gazali, Ebu Hamid Muhammed bin Muhammed. (2000) *Ihjan Ulumi-d-Din*. Parathënia dhe shënimet: Muhammed Abdul Kadir Ata. Kajro: Dar et-Takva, 2/429.

Neveviu thotë: “*Kanë thënë dijetarët se urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja nuk janë të veçanta për të ngarkuarit zyrtarisht nga shteti, përkundrazi, është e drejtë edhe e çdo myslimani. Ka thënë Imamu-l-Haremejni: Dëshmi për këtë është konsensusi i myslimanëve...*”⁶

1.3.3.2. Kush urdhërohet për të mirë dhe ndalohet nga e keqja?

Parimisht, urdhërohen të gjithë, sepse tekstet fetare i përfshijnë të gjithë pa dallim.⁷ Dallimet janë më pas në format dhe mënyrat e aplikimit të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

1.3.3.3. E mira dhe e keqja përcaktohen nga feja⁸

Kriter për përcaktimin e asaj se çfarë është e mirë (ma'ruf) dhe çfarë është e keqe (munker) është feja. Kjo nuk i është lënë në dispozicion njeriut. ‘E mira’ nënkupton urdhër nga Allahu dhe çdo gjë që feja na ka nxitur ta veprojmë, ndërsa ‘e keqja’ përfshin çdo bindje, thënie, vepër që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë urryer e refuzuar.⁹

6. En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sabihi Muslim bin El-Haxh-xhaxh*. Op. cit. 2/22.

7. Imam, Muhammed Kemaluddin. (1986) *Uslu-l-Hisbeti fi-l-Islam*. Kajro: Daru-l-Hidajeh, f. 110.

8. Err-Ruhajli, Hamud bin Ahmed. (2003) *Kavaidun muhimmetun fi-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker ala dar'i-l-Kitabi ve-s-Sunneh*. Ed. 2. Medine Munevver: Mektebetu-l-Ulumi ve-l-Hikemi, f. 14.

9. Shih: El-Kasir. (1411 h.) *Tedbkiretu uli-l-gireti bi-sheireti-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 11-12.

Kjo nënkupton se njeriu duhet ta pasojë atë që urdhëron feja dhe të veprojë sipas saj, e jo sipas tekave apo qejfeve të tij.

1.3.3.4. Kushtet e ndalimit të së keqes

Që një e keqe të ndalohet ka tre gjendje kryesore:

1) Të vërtetuarit se gjëja që ndalohet është e keqe. Nuk lejohet të ndalohen gjërat që nuk janë të këqija ose për të cilat nuk ka pajtim se janë të këqija.

2) Që e keqja të ekzistojë aty për aty. Kjo ndodhë në njërën prej tre mënyrave:

a. në qoftë se pritët që e keqja të ndodhë, atëherë njeriu këshillohet dhe i kujtohet dënimi për mëkatin.

b. në qoftë se është objekt dyshimi se mund ta kryejë një të keqe, p.sh. dikush që është ulur në tavolinë dhe para ka një gotë me verë. Në këtë rast, nëse muhtesibi nuk ka frikë se mund t'i ndodhë diçka e keqe, e ndalon këtë veprim, madje edhe me dorë.

c. Në qoftë se e ka mbaruar mëkatin por i kanë ngelur gjurmët e mëkatit, si p.sh. ai ka konsumuar alkool ndërsa nga goja kundërmon. Në këtë rast nuk ka më vend për ndalim por për ndëshkim.

3) Që e keqja të kryhet haptazi. Nuk i lejohet muhtesibit të spiunojë se çfarë bëjnë njerëzit brenda shtëpive të tyre, me përjashtim nëse mëkati

kuptohet edhe nga jashtë.¹⁰

1.3.3.5. Etapat e ndalimit të së keqes dhe ndalimi me dorë

Përdorimi i forcës ose ndalimi me dorë është konfirmuar në hadithin e Ebu Seid El-Hudrijit (r.a.). Aty, në mënyrë të përgjithshme, është sistemuar si një ndër tre mënyrat e ndalimit të së keqes, megjithëse, ka detaje të tjera të rëndësishme të aplikimit të saj. Dijetarët kanë përmendur disa hapa që paraprakisht duhen ndërmarrë për të ndaluar një të keqe. Imam Gazaliu përmend pesë hapa, të cilat janë si në vijim:

1) Njoftimi (me veprën që do të duhej bërë ose mëkatën që do të duhej braktisur)

2) Këshillimi me fjalë të buta dhe të mira

3) Përdorimi i fjalorit të vrazhdë. Ky hap ndërmerret në rastet kur ndihet nevoja për të dhe jo më shumë se kaq. Pra, nuk guxon të kalojë në sharje, shfryrje, etj.¹¹

4) Përdorimi i forcës në kuptim të thyerjes së mjeteve me të cilat manifestohet e ndaluara.

10 El-Gazali, Ebu Hamid Muhammed bin Muhammed. (2000) *Ihjaw Ulumi-d-Din*. Parathënia dhe shënimet: Muhammed Abdul Kadir Ata. Kajro: Dar et-Takva. 2/442-446.; El-Maverdi. (1989) *El-Abkam es-sultaniyeh*. Op. cit. F. 330; 331. Err-Rruhajli. (2003) *Kavaidun muhimmetun fi-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 11-13.

11 Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit. 92.

5) Frikësimi, kërcënimi...¹²

Të tjerët kanë specifikuar deri në nëntë hapa, duke iu referuar këtyre pesë hapave të Imam Gazaliut dhe duke i plotësuar me hapa të tjera.¹³

Krahas këtyre, ekziston edhe një kriter me rëndësi sipas të cilit këto pika duhen përfillur deri dhe në respektimin e radhës së tyre, pra nuk kalohet në tjetrën pa u shtetur të gjitha mundësitë për të parën.¹⁴

Po kështu, ndalimi me dorë nuk duhet të dalë jashtë qëllimit edukativ që ka, ashtu siç nuk duhet të degradojë jashtë masave të caktuara. Muhtesibit (njeriut që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja) nuk i lejohet të shkelë kompetencat që ka, sikurse u përmend në pikën paraprake.

1.3.3.6. Marrja në konsideratë e dobive dhe dëmeve

Feja është e ndërtuar mbi parimin e përfitimit të të mirave dhe largimin e të këqijave. Kjo nënkupton se ai që urdhëron për të mirë dhe ndalon

12 El-Gazali. (2000) *Ihjaw Ulumi-d-Din*. Op. cit. 2/430.; Shih: El-Bilali, Abdul Hamid. (1989) *Fikhu-d-Da'veti fi inkari-l-munker*. Ed. 3. Kuvajt: Daru-d-Da'veti, f. 69-71.; Ibn Davud, Abdurrahman bin Ebi Bekr. (1996) *El-Kenzu-l-ekber fi-l-emri bi-l-ma'rufi ve-n-nehji ani-l-munker*. Verifikues shkencor: Mustafa Uthman Samideh. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh, f. 178.

13. Shih: Bint Mudif. (2007) *El-Hisbetu*. Op. cit. 128-139.; Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit. 96.

14. Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 102.

nga e keqja nuk duhet të ndikojë me veprimet e tij që të shkaktohet një e keqe më e madhe, sepse nëse e keqja bëhet më e madhe, atëherë obligimi për ta ndaluar atë pezullohet.¹⁵

Dijetarët myslimanë janë unanimë se ndalimi i të keqes pezullohet në rast se:

- Shkakton një të keqe më të madhe, sikurse u shpjegua, dhe

- Paraqet rrezik serioz për ndaluesin nga e keqja. Imam Ahmedi ishte pyetur se kur i obligohej njeriut të urdhëronte për të mirë dhe të ndalonte nga e keqja? A ka thënë: Kur nuk ka frikë shpatën dhe as kamxhikun.¹⁶ Këtë e konfirmon edhe Imam Neveviu.¹⁷

1.3.3.7. Vetëpërmbajtja gjatë urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja¹⁸

Një nga rregullat që duhet të kihet parasysh gjatë ushtrimit të hisbes është dhe vetëpërmbajtja. Kur shpjeguar definicionin e Dr.

15. Err-Rruhajli. (2003) *Kavaidun mubimmatun fi-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 47.

16. Shih: El-Hal-lal, Ebu Bekir Ahmed bin Muhammed. (1990) *El-emru bi-l-ma'ruf ve-n-nehju ani-l-munker*. Verifikues shkencor: Meshur Hasen Mahmud Selman dhe Hisham bin Ismail Es-Seka. Bejrut: El-Mekteb el-Islamijj; Amman: Dar Ammar, f. 24.

17. En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sabihi Muslim bin El-Haxh-xbaxh*. Op. cit. 2/25.

18. Err-Rruhajli. (2003) *Kavaidun mubimmatun fi-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 47.

Abdullahut, pamë se në ç'mënyrë brilante kishte përcaktuar edhe këtë element: kompetencat e muhtesibit (atij që urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja). Thirrësi nuk ka të drejtë të ekzekutojë ose të përdorë armën. Ky nivel i takon vetëm shtetit. Ja çfarë ka thënë Ibn Tejmije për këtë rast: "*Askujt nuk i takon ta largojë një të keqe me një të keqe tjetër më të madhe, si ta zëmë të marrë përsipër shkurtimin e dorës së hajnit, dënimin me kamxhik të konsumuesit të alkoolit dhe ekzekutimin e masave të tjera ndëshkuese. Kështu gjendja do të degradonte në vrasje dhe çrregullim sepse çdokush do ta ndëshkonte tjetrin me pretekstin se e ka merituar ndëshkimin. Kjo çështje (e ndëshkimeve dhe ekzekutimeve) i takon pushtetarit...*"¹⁹

1.3.3.8. Dhënia përparësi gjërave më të rëndësishme²⁰

Gjatë ushtrimit të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, doemos duhet të kihet parasysh se duhen sistemuar gjërat sipas rëndësisë së tyre. Para çdo gjëje duhet t'i jepet rëndësi besimit. Këtë e mësojmë edhe nga praktikat e

19. Ibn Tejmije, Ahmed bin Abdul Halim. (1418 h.) *El-Mustedrek ala mexhmui Fetava Shejhi-l-Islam*. Përmbledhi, klasifikoi dhe botoi: Muhamemd bin AbduRrahman bin Kasim, 3/203.; Ibn Tejmije, Ahmed bin Abdul Halim. (p.v.b.) *El-Hisbetu fi-l-Islam ev vedhifetu-l-bukumeti-islamijjeti*. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh, 1. 16; 45.

20. Err-Rruhajli. (2003) *Kavaidun mubimmatun fi-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 44.; Shih: El-Bilali, Abdul Hamid. (1989) *Fikhu-d-Da'veti fi inkari-l-munker*. Ed. 3. Kuvajt: Daru-d-Da'veti, f. 79-81.

Profetëve (a.s.) që misionin e tyre e fillonin nga besimi, duke aluduar në këtë parim, pra dhënien përparësi gjërave më të rëndësishme.

1.3.3.9. Tiparet e muhtesibit

Ai që urdhëron për të mirë ose ndalon nga e keqja duhet të ketë tri tipare:

1) Të dijë për atë që urdhëron dhe ndalon. Ka thënë Imam Nevevi: *‘Urdhëron për të mirë dhe ndalon nga e keqja ai që ka dije për atë që urdhëron ose ndalon...’*²¹

2) Të jetë i drejtë në atë që urdhëron dhe ndalon, si dhe

3) Të jetë i butë në atë që urdhëron dhe ndalon.²²

2. Rregullat dhe etika përkitazi me ihtisabin ndaj prindërve

2.1. Rregullat

2.1.1. Klasifikimi i pozitës së prindërve në Ihtisab

Ndonëse, parimisht, Ihtisabi aplikohet ndaj të gjithë njerëzve, megjithëkëtë jo të gjithë njerëzit trajtohen në të njëjtën mënyrë. Dijetarë dhe studiues myslimanë janë marrë me klasifikimin e njerëzve

ndaj të cilëve aplikohet urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja. Kjo për arsye se reagimet nuk janë të njëjta nga të gjithë. Disa mund të jenë me pasoja të mëdha, që madje mund të përcaktojnë edhe ushtrimin apo jo të urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, siç u përmend më lart. Në këtë mënyrë, për të evituar pasojat dhe për të ndihmuar që të realizohen objektivat e këtij institucioni me peshë të madhe fetare, përzgjidhen format dhe metodat se si aplikohet në masë ky institucion.

Atëherë, si ti trajtojmë prindërit dhe në cilën kategori t’i fusim ata?

Profesor Bereket i klasifikon njerëzit në tri kategori sa i përket aplikimit të këtij institucioni fetar:

1) Masa e gjerë, ku bëjnë pjesë fëmijët, të moshuarit dhe prindërit

2) Dijetarët, dhe

3) Pushtetarët.²³

Ky konstatim nuk përkon me pozitën e prindërve në ihtisab. Siç do të shohim më vonë, me prindër nuk veprohet me të gjitha mënyrat e ndalimit, që nënkupton se pozita e tyre nuk mund të jetë në asnjë mënyrë e natyrës që ka specifikuar Prof. Bereket. Imam Gazaliu²⁴ dhe Abdurrahman bin Ebi Bekr bin Davud (vetëm si shembuj për ilustrim) prindërit i klasifikon në një

21. Shih: En-Nevevi. (1392 h.) *El-minbaxh sberhu Sahibi Muslim bin El-Haxh-xbaxh*. Op. cit. 2/23. Shih edhe: El-Maverdi. (1989) *El-Ahkam es-sultaniyeh*. Op. cit., f. 316; 325.

22. Shih: El-Hal-lal. (1990) *El-emru bi-l-ma’ruf ve-n-nehju ani-l-munker*. Op. cit., f. 34.; Et-Texhibni, Muhammed bin Ahmed bin Abdun. (2009) *Risaletun fi-l-kadai ve-l-hisbeti*. Verifikues shkencor: Fatime el-Idrisi. Bejrut: Dar Ibn Hazm, f. 65.

23. Shih: Bint Mudif. (2007) *El-Hisbetu*. Op. cit., f. 69-110.

24. El-Gazali. (2000) *Ihjan Ulumi-d-Din*. Pop. cit. 2/431.

pozitë me pushtetarët, për shkak të mjeteve të njëjta që aplikohen në ndalimin e tyre nga të këqijat.²⁵

Si konstatim themi se prindërit për nga pozita bëjnë pjesë në kuadër të pushtetarëve, ndaj të cilëve, siç do të shohim ka dallime sa i përket aplikimit të këtij institucioni fetar.

2.1.2. A urdhërohen prindërit për të mirë dhe a ndalohen nga të këqijat?

Parimisht, prindërit ndalohen nga të këqijat. Në fe, askush, pavarësisht pozitës, nuk është imun nga ndalimi nga e keqja. Rrjedhimisht, as prindërit nuk përbëjnë përjashtim nga ky rregull. Dijetarët myslimanë, duke filluar me Imam Gazaliun, kanë thënë se, prindërit ndalohen nga të këqijat, por me specifika që janë të veçanta për prindërit,²⁶ e të cilat do t'i përmendim më vonë.

Dr. Fadl Ilahi ka përmbledhur një sërë argumentesh që dëshmojnë se prindërit ndalohen nga të këqijat.²⁷ Në fakt, ai ka bërë një klasifikim

25. Ibn Davud, Abdurrahman bin Ebi Bekr. (1996) *El-Kenzu-l-ekber fi-l-emri bi-l-ma'rufi ve-n-nehji ani-l-munker*. Verifikues shkencor: Mustafa Uthman Samideh. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh, f. 202-209.

26. El-Gazali. (2000) *Ihja ulumi-d-Din*. Pop. cit. 2/431.; Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. Cit., f. 84.; Es-Senami, Umer bin Muhammed bin Avad. (1986) *Nisabu-l-Ihtisab*. Verifikues shkencor: Merizin Asiri. Mekke El-Mukarrreme: Mektebetu et-talib el-, f. 196.

27. Ilahi, Fadl. (2000) *El-Ihtisabu ala-l-validejni*. Bejrut: Dar Ibn Hazm, f. 10-21.

tematik të tyre, duke i ndarë si në vijim:

1) Tekste të përgjithshme në të cilat përfshihen edhe prindërit

Ajeti kur'anor: **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun...”** [Ali Imran: 110]

Në ajet nuk ka asnjë përjashtim për ata që urdhërohen për të mirë dhe ndalohen nga e keqja.

Në hadithe besimtarit i kërkohet që karshi tjetrit, kushdo qoftë ai prej besimtarëve, të jetë këshillues dhe ta ndalojë nga e keqja. Ja disa prej këtyre haditheve:

Buhariu transmeton dy hadithe nga Ibni Abbasi dhe Xherir bin Abdullahu se ata me rastin e besatimit për fe, përveç tjerash, Profetit (a.s.) i kishin dhënë besën edhe për: *“...dhe për këshillimin e çdo besimtari.”*

Përmendim po kështu edhe hadithet se *feja është këshillë*²⁸ dhe atë të ndalimit të së keqes, të cilin e cituam më sipër.²⁹

28. Temim ed-Dari [radji All-llahu anhu] transmeton se i Dërguari i All-llahut [salla All-llahu alejbi ve sel-lem] ka thënë: *“Feja është këshillë! Themë: Për kë? Tha: Për All-llahun, për Librin e Tij, për të Dërguarin e Tij, për udhëheqësit e myslimanëve dhe për masën e gjerë të tyre.”* [Transmeton Muslimi.]

29. *“Kush sheh ndonjë të keqe, atëherë le ta largojë me dorën e tij, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij, e nëse as kështu nuk mundet, atëherë me zemrën e tij dhe kjo është grada më e ultë e besimit (në ndalimin/largimin e së keqes).”* [Transmeton Muslimi.]

Edhe në këto hadithe urdhërimi për të mirë, këshilli dhe ndalimi nga e keqja, kanë ardhur në formë të përgjithësuar, duke mos e përjashtuar askënd.

2) Tekste të veçanta për të afërmit

Ajeti kur'anor: **“Paralajmëroje farefisn tënd më të afërm.”** [Esh-Shuara: 214]

Pas këtij ajeti, Profeti (a.s.) u ngrit dhe i thirri të afërmit. Sigurisht, prindërit janë ata që thirren më së pari, sidomos nëse kihet parasysh se me këtë veprim nënkuptohet një nder i madh që i bëhet njerëzve, andaj ata janë më meritoret për nderin tonë.

Ajet tjetër me të cilin Dr. Ilahi argumenton është ajeti 6 nga kaptina Et-Tahrim: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri,...”**

Imam Gazaliu, siç e citon Dr. Ilahi, këtë ajet e sheh si pasqyrë, në të cilën më së miri reflekton urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja i prindërve dhe të afërmeve.

3) Praktikat e Profetëve (a.s.)

4) Praktikat e Sahabeve (r.a.)

2.1.3. Shkallët e ndalimit të së keqes në raport me prindin

Ajo që Imam Gazaliu dhe të tjerë³⁰ kanë nënvizuar është se, në raport me prindin, nga hapat në fjalë, përdoren vetëm dy hapat e parë, respektivisht:

30. Ilahi. (2000) *El-Ihtisabu ala-l-validejini*. Op. cit., f. 36.

1) Njoftimi me veprën që është dashur ta bëjnë, nëse nuk e kanë bërë, ose me veprën që e kanë bërë, por që nuk është dashur ta bëjnë.

2) Këshillimi me fjalë të buta dhe të mira, duke ua treguar mirësitë e veprave të mira dhe shpërblimin për to në botën tjetër, si dhe duke ua treguar pasojat e mëkateve dhe ndëshkimin për to në botën tjetër.

Këtë e shpjegon edhe Abdurrahman bin Ebi Bekr Ibn Davud. Për këtë ai bazohet në rastin e Musait dhe Harunit (a.s.) me Faraonin. Kur Allahu i dërgoi te ky i fundit, i porosi: **“Flitini atij fjalë të buta,...”** [Ta Ha: 44]

Kështu duhet të veprohet edhe me prindërit.³¹

Në fakt, Imam Gazaliu ka diskutuar edhe për ndalimin me forcë, të cilin do ta shtjellojmë në pikën në vazhdim.

2.1.4. Kriteri i përdorimit të forcës (ndalimit me dorë) ndërmjet lejimi dhe ndalimit

Imam Gazaliu, pas konfirmimit se, parimisht, janë vetëm dy hapat e parë që ndërmerren për urdhërimin e prindërve për të mirë dhe ndalimin e tyre nga e keqja, i qaset edhe çështjes së përdorimit të forcës në raport me prindërit. Mendimi i tij, i mbështetur edhe nga Dr. Ilahi, është se ndalohen

31. Ibn Davud, Abdurrahman bin Ebi Bekr. (1996) *El-Kenzu-l-ekber fi-l-emri bi-l-ma'rufi ve-n-nahji ani-l-munkar*. Verifikues shkencor: Mustafa Uthman Samideh. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijeh, f. 202-209.

edhe me dorë por sipas detajeve në vazhdim:

1) Përdorimi i forcës bëhet vetëm ndaj gjësendeve të tyre, p.sh. thyerja e enëve të alkoolit, etj. Këtë mendim e ka Kadi Ijjadi.³² Por kjo në asnjë rrethanë nuk lejon që përdorimi i forcës të kalojë në fizikun e tyre.

2) Gjatë ndalimit të së keqes me dorë, duhet të shfaqet mirësi, dashuri, butësi, jo sjellje e vrazhdë, fyerje, sharje apo ofendim. Duhet treguar për peshën e mëkatit që janë duke bërë dhe se fundi i tij është i keq tek Allahu.

3) Nëse ndalimi me dorë shkakton dëme më shumë se dobi, atëherë braktiset.³³

Në fakt, kjo pika e fundit paraqet edhe mendimin e dytë, sipas të cilit prindërit nuk ndalohen fare me dorë.³⁴ Për mëkatet që bëjnë, ne vetëm lutemi tek Allahu dhe kërkojmë falje. Këtë mendim e përfaqëson Hasan Basriu. Transmetohet të ketë thënë: “*Njeriu i urdhëron prindërit: nëse pranojnë, mirë, ndryshe, heshtë.*”³⁵ Kështu mendon

32. Shih: El-Bilali, Abdul Hamid. (1989) *Fikhu-d-Da'veti fi inkari-l-munker*. Ed. 3. Kuvajt: Daru-d-Da'veti, f. 61-71.

33. Ilahi. (2000) *El-Ihtisabu ala-l-validejni*. Op. cit., f. 51.; Abdul Muttalib. (2011) *Ehemmijetu-l-emri bi-l-ma'ruf ve-n-nehji ani-l-munker*. Op. cit., f. 84.

34. Ibn Davud. (1996) *El-Kenzu-l-ekber*. Op. cit., f. 210.

35. Ibn Ebi Ed-Dunja, Ebu Bekir Abdullah bin Muhammed. (1997) *El-emru bi-l-ma'ruf ve-n-nehju ani-l-munker*. Verifikues shkencor: Salah bin Ajid Esh-Shelahi. Saudi: Mektebetu el-gureba el-etherijeh, f. 83.

edhe Senamiu në librin e tij *Nisabu-l-Ihtisab*, ku, duke përshkruar mënyrën se si ndalohen prindërit nga të këqijat thotë: “*Fillimisht iu flasin fjalë të mira dhe i këshillojmë, e nëse prindi refuzon dhe kundërshton, atëherë me mirësjellje largohemi dhe fillojmë të kërkojmë falje te Zoti për ta.*”³⁶

Ky mendim është përkrahur edhe nga ata që ndalimin me dorë e miratojnë parimisht por që e kushtëzojnë me dëmet dhe dobitë ose lëndimin e prindërve nga këto veprime. Duke qenë se është e pamundur të ndalohen nga të këqijat e të mos lëndohen emocionalisht, atëherë mendimi i Hasan Basriut, se duhet të vazhdohet me lutje e istigfar për ta, më duket më afër të vërtetës. Allahu e di më së miri!

2.1.5. Trajtimi i prindërve jomyslimanë

Ihtisabi ushtrohet edhe ndaj prindërve jomyslimanë. Dr. Ilahi si argument për këtë sjell rrëfimin e Ibrahimit (a.s.) me të atin. Ky i fundit ishte idhujtar ndërsa i biri, Ibrahim (a.s.), monoteist, dhe përkundër këtij dallimi, ai:

- e respektonte të atin duke i thënë fjalë të mira

- e ftonte në fe, duke i treguar se ishte dërguar nga Zoti, dhe

- e ndalonte nga të këqijat, respektivisht adhurimi i idhujve.

Pak më parë cituam ajetet kur'anore [Merjem: 41-47] që na i

36. Es-Senami. (1986) *Nisabu-l-Ihtisab*. Op. cit., f. 196.

përshkruajnë këto detaje. **“Trego për Ibrahimin, kur ai i tha të atit, Azerit: “A do t’i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe.”**” [El-En’amë: 74]

Si ta interpretojmë fjalën “humbje”, si fjalë e rëndë apo jo?

Dr. Ilahi sjell dy shpjegime të bukura, të cilat na tregojnë se ndalimi i prindërve jobesimtarë nga të këqijat, madje edhe atëherë kur ata mund të jenë të ashpër në këto të këqija, p.sh. të flasin fjalë të rënda për fenë tonë, bëhet me fjalë të bukura dhe me edukatë të lartë.

1) Fjalët e vrazhda jo detyrimisht janë fjalë të pista. Ai i referohet Reshid Ridasë, i cili fjalën “humbje” e interpreton si përshkrim të realitetit dhe jo si fyerje e ofendim.

2) Fjalët e vrazhda përdoren sipas nevojës dhe në përputhje me dobritë dhe dëmet e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Nëse dobia është më e madhe, atëherë i përdor ato, ndryshe i braktis dhe vazhdon me lutje për udhëzimin e prindërve sa të jenë gjallë.³⁷

Po kështu, prindërve nuk iu imponohet feja. Ibrahim (a.s.) ia shpjegonte fenë por asnjëherë nuk tentoi t’ia impononte atë babait. Kjo ka qenë pjesë metodologjike edhe te Muhammedi (a.s.). Kushdo që mediton në misionin e tij do të gjejë se ai kurrë nuk ia imponoi askujt

37. Ilahi. (2000) *El-Ihtisabu ala-l-validejni*. Op. cit., f. 46-47.

fenë, madje as të afërmve të tij.

2.2. Etika

Prindërit dallojnë nga të tjerët për shkak se Allahu i ka veçuar. Në Kur’an, duke na folur për këtë pozitë, Allahu thotë: **“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”**” [El-Isra: 23-24]³⁸

Së këndejmi, në raport me prindërit lipsen:

1) Butësia dhe mirësjellja, të cilat janë gjërat e para që kërkohen kur të urdhërohet për të mirë dhe të ndalohet nga e keqja. Nëse kjo lipset në raport me njerëzit në përgjithësi, atëherë në raport me prindërit është edhe më e kërkuar si etikë.³⁹

2) Drejtimi në mënyrë indirekte dhe jo të drejtpërdrejtë, që të mos lëndohen emocionalisht.

3) Shfaqja e dashurisë, dashamirësisë, modestisë, në mënyrë të atillë që, në asnjë çast, ndalimi nga

38. Shih: Bint Mudif. (2007) *El-Hisbetu*. Op. cit., f. 81.

39. Ilahi. (2000) *El-Ihtisabu ala-l-validejni*. Op. cit., f. 36.; Err-Ruhajli, Hamud bin Ahmed. (2003) *Asnafu-l-medurvin ve keffijejtu da’vetihim*. Ed. 2. Damask: Dar el-ulum ve-l-hikem, f. 52-56.

e keqja të mos reflektojë si triumf ndaj tyre, sepse kjo mund të ngjallë mendjemadhësi dhe rrjedhimisht refuzim të largimit nga e keqja nga ana e tyre.

4) Tu përkujtojë meritat e tyre për edukimin e tij dhe se fakti që i biri është në rrugën e Allahut është shenjë e mirësisë së prindërve. Kjo gjë i afron zemrat, i nxit dhe i stimulon.⁴⁰

2.2.1. Prindërit nuk ndalohen në publik.⁴¹

Fetarisht, këshilla nuk jepet në publik, sepse kjo mund ta lëndojë njeriun dhe ta bëjë të ndihet i fyer para të tjerëve. Imam Neveviu citon Imam Shafiun të ketë thënë: “*Kush e këshillon vëllain e tij në vetmi, e ka këshilluar dhe vlerësuar, ndërsa kush e këshillon në publik, e ka poshtëruar dhe turpëruar.*”⁴² Nëse kjo vlen për njerëzit në përgjithësi, atëherë si të mos vlejë për prindërit, kur ata janë më meritoret për respektin dhe nderimin tonë?!

Përfundim

Në fund të këtij punimi, do të doja të përmend disa nga rezultatet e tij, që janë njëherësh edhe përgjigje për pyetjet që kemi ngritur në fillim:

40. Shih: Bint Mudif. (2007) *El-Hisbetu*. Op. cit., f. 82.

41. Shih: El-Bilali. (1989) *Fikhu-d-Da'veti fi inkari-l-munker*. Op. cit., f. 116-117.; Err-Rruhajli. (2003) *Asnafu-l-medurvin ve keifijjeitu da'vetihim*. Op. cit., f. 52-56.

42. Shih: En-Nevevi. (1392 h.) *El-minhaxh sherhu Sabihi Muslim bin El-Haxh-xhaxh*. Op. cit. 2/24.

1) Respektimi i prindërve është një ndër veprat më të rëndësishme në fe. Si vepër, është krahasuar me adhurimin ndaj Zotit.

2) Respektimi i prindërve është moral profetësh.

3) Respektimi i prindërve përfshin përkujdesjen materiale dhe shpirtërore (emocionale) ndaj tyre.

4) Respektimi i prindërve obligohet edhe kur prindërit nuk janë besimtarë.

5) Ata nuk respektohen vetëm në urdhrat apo gjërat që ndeshen me ligjet e Zotit. Megjithatë, mos përfillja e urdhrave të tyre edhe në këtë rast nuk duhet të zhvishet nga etika.

6) Prindërit nuk bëjnë përjashtim kur të jetë në pyetje urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

7) Për shkak të pozitës fetare që kanë, ndaj prindërve nuk aplikohen rregullat që aplikohen ndaj njerëzve të tjerë (masës së gjerë). Në raport me prindërit nuk dilet jashtë *njoftimit* dhe *këshillimit*, si dy hapa prej hapave të ndalimit të së keqes.

8) Ndalohet rreptësisht përdorimi i dhunës ndaj prindit gjatë urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja.

Kështu, mund të konstatojmë se interpretime të tjera të cilat justifikojnë dhunën ndaj prindërve janë të pabazuara dhe të pambështetura në Kur'an dhe Sunet, si dhe në metodologjinë e dijetarëve

të pranuar në umet. Ato nuk përfaqësojnë asnjë dijetar, e aq më tepër këtë fe madhështore. Ato janë injorancë, shthurje dhe degradim në interpretim të fesë. Së këndejmi, si *rekomandime*:

1) Do t'i bëja thirrje institucioneve fetare që të merren më shumë me përhapjen e të vërtetave rreth Islamit. Njerëzit janë viktimat të propagandave, shpesh të qëllimshme, kundër fesë, kështu që e kemi për obligim tua tregojmë të vërtetat e fesë. Në vend që t'iu flasin të tjerët, t'iu flasin ne.

2) Institucionet qendrore fetare të formojnë një ekip që do të monitoronte zhvillimet fetare dhe shoqërore në media elektronike e të shkruara, sidomos në rrjete sociale,

për t'iu sugjeruar më pas ligjëruesve fetarë se me çfarë temash duhet të merren dhe cilat dukuri duhet të trajtojnë. Në këtë mënyrë, do t'i zbusnim shumë këto dukuri dhe njerëzit do ta kuptonin të vërtetën islame pa shtrembërime.

3) Të bëhet trajtim akademik i këtyre dukurive në revista e gazeta fetare, në mënyrë që të përfitohet prej tyre edhe nga ana e intelektualëve.

4) Të përvetësohen mjetet bashkëkohore të komunikimit si mjete të përcjelljes së mesazhit fetar deri te masa, veçmas interneti.

Në mbyllje, për çdo fjalë apo shprehje të qëlluar, i detyrohem Allahut, ndërsa për çdo gabim a lëshim, i drejtohem Atij me kërkim faljeje dhe pendim.

Për fe dhe atdhe: argumentet e klerit mysliman në debatin mbi modernizimin e Shqipërisë në vitet 20-30

**Dr. Enis Sulstarova,
Universiteti i Tiranës,
Fakulteti i Shkencave Sociale**

Abstrakt

Gjatë viteve 20-30 të shekullit të kaluar, Shqipëria zyrtarisht ishte një vend laik, megjithatë në praktikë, shteti, duke vepruar si agjent i njësimi kombëtar, synonte të vinte nën kontrollin e tij organizimin e sferës fetare. Elita politike, në emër të modernizimit dhe oksidentalizimit të vendit kërkonte sidomos të reformonte organizimin dhe praktikën e bashkësisë myslimane, si më e madhja në vend. Edhe disa intelektualë laikë e problematizojnin Islamin si një fe “orientale”, që ishte e huaj për shpirtin shqiptar dhe për qytetërimin modern të Evropës. Klerikët myslimanë, duke e pranuar në përgjithësi nevojën e reformimit të organizimit dhe të disa praktikave të fesë së tyre, prapëseprapë in përgjigjën atyre argumenteve që i quanin të padrejta dhe të gabuara. Me anë të referimit të disa tekste kryesore të klerikëve myslimanë të kohës, kumtesa do të paraqesë disa linja që këta ofruan mbi përputhjen e Islamit me shtetin modern kombëtar. Këto linja ishin: (1) kleri mysliman ka kontribuar në lëvizjen kombëtare; (2) feja islame nuk është kundër kombit e njësimi kombëtar; (3) feja islame nuk është kundër qytetërimit modern dhe shkencës; dhe (4) feja islame e mbrojnë kombin shqiptar kundër efektit përçarës të komunizmit. Në shek. XXI, edhe pse konteksti ka ndryshuar, disa prej këtyre linjave të argumentimit kanë tendencë të rimerren në debatet publike shqiptare, si përgjigje ndaj të konsideruarit të Islamit si “tjetri” i Perëndimit dhe si i huaj për identitetin kombëtar shqiptar.

Hyrje

Artikulli është një shikim në debatin publik midis intelektualëve laikë dhe intelektualëve klerikë myslimanë në vitet midis dy luftërave botërore. Synimi ynë është që të paraqesim apologjinë për praninë e fesë islame në shoqërinë e re shqiptare, përballë argumenteve të atyre intelektualëve laikë, për të cilët fetë në përgjithësi, dhe ajo islame në veçanti, përbënin pengesa strukturore për “oksidantizimin” e Shqipërisë. Këto diskutime publike të intelektualëve shoqëronin politikën konstante të shtetit shqiptar të kohës, si agjent që vepronte në emër të kombit shqiptar, për të vënë në kontrollin e tij bashkësitë fetare. Prandaj, pjesa e parë e kumtesës trajton marrëdhëniet e shtetit shqiptar me klerin e bashkësisë islame dhe pozicionimin e intelektualëve laikë ndaj fesë islame. Në pjesën e dytë shqyrtojmë argumentet e disa klerikëve myslimanë, si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ali Kraja dhe Hafiz Ibrahim Dalliu, të cilët, me librat dhe artikujt e tyre, morën pjesë në debatin publik për çështjen themelore të ditës: reformimin e shoqërisë shqiptare. Pjesa e tretë e artikullit përbëhet nga përfundimi.

Islami si çështje

Megjithëse shumica e shqiptarëve ishin myslimanë, shteti

i ri shqiptar nuk miratoi asnjë fe zyrtare dhe shpalli se ndiqte një politikë afetare, ose laike në marrëdhëniet me bashkësitë dhe praktikantët fetare të popullsisë. Kjo u bë qëllimisht për të forcuar lidhjen kombëtare midis shqiptarëve të tri besimeve dhe ishte shprehje e ideve të Rilindjes Kombëtare. Për pasojë, shteti laik e shpallte veten si agjentin veprues të kombit dhe, në emër të njësimin kombëtar, ai ushtronte kontroll të rreptë mbi çështjet dhe organizatat fetare (Clayer, 2010: 2). Edhe debati publik u mbizotërua nga publicistët laikë, të cilët shpallën misionin e tyre për modernizimin e Shqipërisë. Modernizimi thirrej prej tyre edhe “evropianizim”, ose “oksidantizim”, meqenëse nënkuptonte se modeli që duhej ndjekur ofrohej tashmë nga shtetet e zhvilluara kombëtare të Evropës Perëndimore. Edhe atëherë kur intelektualët shqiptarë shpallnin se modeli që duhej ndjekur në Shqipëri ishte ai i Turqisë republikane, në fakt bëhej fjalë gjithnjë për “oksidantizimin”, të cilin Ataturku po e zbatonte me sukses në vendin e tij.

Sikurse po ndodhte në Turqi, edhe në Shqipëri, Islami në debatin publik shihej në marrëdhënie me “qytetërimin perëndimor”, “Evropën”, “modernitetin”, “reformën”, shkencën, përparimin dhe emancipimin e grave. Në këtë kuadër shteti shqiptar kërkonte

njëkohësisht që ta centralizonte organizimin e brendshëm të Bashkësisë Islame, ta kontrollonte atë dhe ta përdorte edhe si një instrument për kontrollin dhe reformën shoqërore (Clayer, 2008: 107-108). Nën shtytjen shtetërore, Bashkësia Islame ndërmoi masa ose dha pëlqimin për mbylljen e shumë xhamive¹, riorganizimin e medreseve, shkëputjen e lidhjeve institucionale me kalifatin, mbylljen e gjykatave të sheriatit, heqjen e vellos së fytyrës për gratë në mjedise publike dhe, në përgjithësi, reformimin e veprimtarisë fetare, sipas atyre që gjykoheshin si kërkesa të kohës moderne dhe të imponuara nga pozicioni i Shqipërisë në Evropë. Në statutin e Bashkësisë Islame përmendej “inkurajimi i myslimanëve për t’iu konformuar qytetërimit modern” dhe ndihmesa që ajo duhej të jepte për të “zhvilluar vëllazërimin kombëtar ndërmjet shqiptarëve të çdo besimi” (cit. te Morozzo della Rocca, 1994: 33).

Përveç institucioneve shtetërore, trysnia për të reformuar praktikat dhe institucionet myslimane vinte edhe nga intelektualët laikë, të cilët, përmes shtypit, paraqisnin vizionet e tyre të Shqipërisë “oksidentale” dhe kritikoni tiparet “orientale” të shoqërisë. Sipas tyre, shqiptarët duhej që të kapërcenin pasojat negative të

pushtimit shekullor osman, midis të cilave në vend të parë ishin mendësia dhe zakonet “aziatike” që po pengonin përparimin e shpejtë të kombit drejt qytetërimit modern evropian (Sulstarova, 2007: kap. 3-4). Edhe pse “zgjedha” osmane kishte mbaruar, problematik për ta mbetej vazhdimi i ndikimit të “Orientit” përmes fesë islame, diçka që nuk mund të tolerohej, ndërkohë që Shqipëria kërkonte të bënte pjesë në kulturën dhe qytetërimin evropian. Për intelektualët laikë, laicizmi ishte baras me “çosmanizimin”, gjë që do të thoshte se feja islame përçmohej për faktin se kishte lidhje me shekujt e pushtimit turk. Për pasojë u morën masa që simbolika e Islamit të përjashtohej nga sfera publike, veçanërisht në shkolla dhe institucione shtetërore (Clayer, 2008: 124).

Në shtypin e kohës, herë pas here, Islami në përgjithësi, varianti i tij synit, apo kleri mysliman shqiptar, akuzoheshin se ishin faktorë që po pengonin evropianizimin e Shqipërisë. Mehdi Frashëri, një ndër politikanët dhe intelektualët më të shquar, theksonte papajtueshmërinë e Islamit synit me modernitetin. Në librin e tij mbi historinë e Shqipërisë, të botuar për herë të parë në vitin 1928, Frashëri shkruante se Islami synit dhe ortodoksizmi e kanë penguar përpjekjen kombëtare shqiptare, ndryshe nga bektashizmi dhe katolicizmi që e kanë përkrahur

1. Xhami që ishin pothuajse jashtë funksionit, si pasojë e amortizimit të tyre (shënim i redaksisë).

atë (Frashëri, 2000: 44-47). Sipas tij, ishte e nevojshme që Islami në Shqipërinë e pavarur të reformohej thellësisht, përndryshe ai do të zhdukej. Ai rekomandonte që të ndalohej mbulimi i grave dhe që klerikët myslimanë të shkolloheshin në Perëndim. Askush nuk mund të emërohej myfti ose myderriz pa kryer më parë studimet universitare. Këto ide ai i shprehu në mënyrë konstante në një sërë botimesh deri në vitet 1940. Në mesin e Luftës së Dytë Botërore, te libri *Problemet shqiptare*, Frashëri sugjeronte që edhe kleri i bektashinjve, i konsideruar më liberal se sa klerikët synitë, të hiqte “kijafetin [veshjen] aziatik” dhe të martohej (Frashëri, 2006: 115).

Edhe intelektualë të tjerë shpreheshin se zakone të caktuara të imponuara nga feja islame nuk pajtoheshin me qytetërimin modern dhe me misionin e përparimit të kombit shqiptar. Polemikët e tyre me intelektualët klerikë myslimanë ashpërsoheshin sidomos kur diskutohej zbulimi i fytyrës së grave myslimane në publik. Shamia, apo velloja, me të cilën vajzat dhe gratë besimtare myslimane mbulojnë fytyrën dhe/apo kokën, është ndoshta çështja më e nxehtë e debateve mbi përputhshmërinë e fesë islame me modernitetin dhe qytetërimin perëndimor. Ajo trajtohet edhe në ditët tona si një vijë demarkacioni që dallon Perëndimin laik ndaj botës myslimane, duke u

bërë madje objekt i rregullimeve ligjore në disa shtete të Evropës. Siç shkruajnë lidhur me këtë dy studiues bashkëkohorë nga Britania e Madhe, në Perëndim “është bërë e pamundur të flasësh për Islamin pa përmendur gratë dhe është e pamundur të flasësh për gratë myslimane pa përmendur vellon” (Williamson & Khiabany, 2010: 93). Prandaj duhet kuptuar se rëndësia që mori gjatë viteve ‘30 debati mbi mbulimin-zbulimin e fytyrës së grave myslimane në publik, buronte nga çështja thelbësore e “oksidentalizimit” të kombit shqiptar (Clayer, 2008). Kështu Selim Shpuza në shkrimin “Modernizma dhe çarçafi”, botuar në vitin 1936, kërkonte që velloja e fytyrës të hiqej sepse është çnjerëzor, pengon zhvillimin e femrës myslimane, forcon konservatorizmin edhe ndër të krishterët, pengon zhvillimin e fshatit, i turpëron shqiptarët në sytë e të huajve (perëndimorëve). Ai e përfundonte artikullin duke shkruar se “ndodhemi në mes të Evropës dhe kështu anakronikë siç jemi, pa bamë reformat e duhuna, nuk kemi të drejtë të marrim pjesë në kolektivitetin e popujve të qytetnuem” (Shpuza, 1999: 123). Një vit më vonë në vazhden e polemikës për vellon, te artikulli “*Zani i Naltë kundra Qytetnimit*”, i njëjti autor shkruante se ndryshe nga porositë që shqiptarëve u lanë Naimi, Vreto apo Pashko Vasa, *Zani i Naltë*, organi qendror i shtypit të

Bashkësisë Islame, po përpiquej “të imponojë pikëpamjet orientale të vet në drejtimin që duhet të marrë problemi shqiptar” dhe se me frymëzimin e ideve konservatore e kundërkombëtare, po kërkonte që në Shqipëri të “përvetësohet primitiviteti i trashëguem nga sundimi turk e që Shqipëria të mos arrijë kurrë në gradën e popujve të lirë e të qytetnuem” (po aty: 149). Për temën tonë është me interes të citojmë një artikull që gazetari Tajar Zavalani botoi më 1936 lidhur me çështjen në fjalë:

Një nga mbeturinat më të shëmtuara të botës së vjetër është pa dyshim ferexheja që mbulon gruan myslimane.... S’na shkonte nga mendja se ka burra që i thonë vehtes të dijshëm dhe duan të ecin me hap me kohën dhe guxojnë të dalin publikisht e të përlligjin me argumenta gjoja serioze, mshehjen e gruas myslimane mrapa një perde të zezë. Por ja ku duallën zotërinjtë e *Zanit të Naltë* dhe deshën të na provojnë pa qeshur se ferexheja nuk e pengon qytetërimin e gruas myslimane (Zavalani, 1998: 269).

Në citatin e mësipërm nuk merret fare në konsideratë fakti se përdorimi i vellos është ose jo një normë fetare për besimtarin, por gjykohet si pjesë e kohës së shkuar të pushtimit turk. Perdja e zezë e ferexhesë për gruan shqiptare është pjesë e errësirës totale ku ndodhej kombi shqiptar nën sundimin e

huaj. Koha e tanishme ku shqiptarët kanë fituar lirinë kërkon edhe që gruaja myslimane të heqë perden e ferexhesë. Prandaj, Zavalani mendonte se çdokush që mbron vellon në publik është jashtë kohe dhe kundërshtar i përparimit e evropianizimit të kombit. Kompromis nuk mund të ketë dhe për intelektualin laik formula e betejës është e thjeshtë dhe e qartë: “Jo myslimanizmit dhe Orientit, po shqiptarizmit dhe Oksidentit”. Me këto fjalë do t’i përgjigjej Safet Butka (2003: 790-791) klerikut Hafiz Ali Korça në një letër të hapur më 1924.

Vetë Bashkësia Islame mbante një qëndrim të luhatshëm për çështjen e vellos. Ndërsa udhëheqësit e Bashkësisë e justifikuan vendimin që morën autoritetet shtetërore mbi ndalimin e vellos (perçes) në publik, duke vënë në dukje se në Kur’an nuk ekzistonte ndonjë detyrim apo udhëzim i posaçëm fetar për mbajtjen e vellos, në krahun tjetër disa intelektualë myslimanë me shkrimet e tyre në *Zanin e Naltë* e mbronin përdorimin e vellos, si duke iu referuar traditës fetare, si duke iu referuar mbrojtjes së moralit të gruas. Sidoqoftë, udhëheqësit e bashkësisë islame deri diku e miratuan dhe e adoptuan vetë argumentin e intelektualëve laikë mbi nevojën që Shqipëria të integrohej me vlerat dhe zakonet e mira të kombeve të Evropës. Në këtë këndvështrim, ata e shikonin si të nevojshëm zbulimin

e fytyrës së gruas myslimane në publik, sepse kjo “masë sociale” do ta ndalte keqpërdorimin e vellos dhe do të shfaqte natyrën e vërtetë e të ndriçuar të Islamit. Jo më pak i rëndësishëm ishte edhe argumenti se pas kësaj mase turistëve të huaj do t’u hiqej mundësia për ta paraqitur Islamin si barbar (Clayer, 2008: 118-120). Megjithatë debati publik mbi vellon ishte më i mprehti midis intelektualëve laikë dhe klerikëve myslimanë, këta të fundit, rolin publik të fesë islame, e mbrojtën duke iu referuar dobisë që fetë në përgjithësi, dhe midis tyre Islami, kishin për kombin dhe njësimin kombëtar. Pjesa e mëposhtme e artikullit i kushtohet analizimit të disa teksteve me autorë Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Korçën dhe Hafiz Ali Krajën.

Kombi, islami dhe modernizimi në shkrimet e klerikëve myslimanë

Disa klerikë myslimanë spikatën si pjesëmarrës në debatet publike në shtypin shqiptar dhe si autorë të librave me tema kombëtare, shoqërore përveç atyre fetare. Me hulumtimin e disa prej këtyre teksteve me autorë Hafiz Ali Korçën, Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Hafiz Ali Krajën, mund të themi se apologjia publike që këta autorë i bënë Islamit dhe klerit mysliman në Shqipëri kategorizohet në katër argumente kryesore:

(1) kleri mysliman ka dhënë ndihmesën e tij në lëvizjen kombëtare;

(2) feja islame nuk është kundër kombit dhe njësimin kombëtar;

(3) feja islame nuk e kundërshton shkencën dhe qytetërimin modern; dhe

(4) feja islame e mbron kombin shqiptar prej komunizmit.

Argumenti i parë është tema e dy librave, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë* me autor Hafiz Ali Korçën, botuar së pari më 1924 dhe *Patriotizmi në Tiranë* me autor Hafiz Ibrahim Dalliu, botuar më 1930. Të dy librat janë autobiografikë dhe tregojnë përpjekjet e autorëve të tyre për lëvrimin e gjuhës shqipe dhe pavarësinë e Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Korça e hap rrëfimin e tij me arrestimin dhe burgosjen në vitin 1894 në Stamboll për shkakun se mbante me vete libra në gjuhën shqipe, midis tyre edhe *Historinë e Skënderbeut* të Naim Frashërit. Më pas vijon me pjesëmarrjen e tij në çetat e kryengritësve shqiptarë, fjalimin që mbajti në Korçë për shpalljen e kushtetutës dhe me hapjen e Klubit Shqip në Korçë. Ai ndalet gjatë në rolin parësor që ka luajtur në Kongresin e Dibrës për gjuhën shqipe dhe nuk harron të përmendë, midis patriotëve të tjerë, edhe emrat e klerikëve myslimanë që ishin pjesëmarrës në atë kongres. Autobiografia vijon me persekutimin

që përkrahësit e qeverisë osmane i shkaktonin në Korçë, si përkrahës i arsimimit në gjuhën shqipe. Të drejtën e arsimit në gjuhën shqipe Korça e mbrojti me guxim dhe zgjuarsia edhe përpara Talat Pashës, njërit prej krerëve të xhonturqve në Stamboll, edhe pse rrezikonte dënimin me vdekje (Korça, 2006 a: 86-91). Një tjetër pikë kulmore e kujtimeve të Korçës është edhe burgosja e tij prej rebelëve në vitin 1914. Sërish ai shpëton për fije të perit prej ekzekutimit, falë ndërhyrjes së miqve të tij. Gjithashtu ai përmend edhe punën që ka bërë për ngritjen e institucioneve të arsimit shqiptar, përkrah arsimtarëve të shquar si Aleksandër Xhuvani, etj. Në mesin e paraqitjes së vuajtjeve të tij për gjuhën shqipe dhe pavarësinë e Shqipërisë, Korça me pezmatim vëren se në shtetin shqiptar atë e mbajnë për fanatik e të prapambetur dhe nuk ia përkrahin planet për reformimin e bashkësisë e klerit mysliman:

Çudi, në kohën e rinisë kur luftonja për shkronjat e gjuhës përbuzesha dhe dënohesha me vdekje dhe quhesha latinxhi e pa fe, por tashti q'u formua një Shqipëri dhe për të përmbajtur fenë islame në gjirin e saj u mundova, çela një medrese, filluan të më thonë fanatik (po aty: 60).

Ngjashëm me Korçën, edhe Dalli në qendër të librit *Patriotizmi në Tiranë* vendos kujtimet e tij nga përpjekja për gjuhën shqipe

dhe pavarësinë e shqiptarëve prej Perandorisë Osmane. Interesant është fakti se jeta e Dalliut përshkon pothuaj po atë trajektore me atë të Korçës. Dalli ishte mësues i gjuhës shqipe dhe themelues i Klubit Bashkimi në Tiranë. Ai mori pjesë në çetat e patriotëve shqiptarë në kohën e revolucionit xhonturk. Ai u torturua dhe u burgos si nga turqit, po ashtu edhe nga rebelët e Haxhi Qamilit (Balla, 2008: 14-15). Arsyeja pse ai vendosi të shkruajë kujtimet e tij mbi lëvizjen kombëtare në Tiranë në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX, ishte për të shpërndarë opinionin e pabazë, në Shqipërinë e pavarur, se populli i Tiranës ishte kundër pavarësisë së Shqipërisë dhe përkrahu rebelizmin e Musa Qazimit dhe Haxhi Qamilit. Mbështetja më e fortë që mund të gjente ky paragjykim ishte mbizotërimi i fesë islame në Tiranë dhe rrethinat e qytetit, prandaj, qëllimisht, Dalli në listën e tij të patriotëve tiranas shënon emrat e atyre hoxhallarëve dhe shehlerëve, që u burgosën dhe u persekutuan prej turqve dhe prej rebelëve për shkakun e vetëm se ishin pjesëmarrës ose përkrahës të lëvizjes kombëtare. Në fund të listës ai shkruan:

Sikundër që shihet, numri i shqiptarëve [nacionalistëve] të Tiranës kapet deri në njëqind e pesëdhjetë dhe numri i hoxhallarëve

shqiptarë [nacionalistë] deri në pesëdhjetë. Pra në krahasim me ato qytete që kishin një sasi frymësh baras me Tiranën a nuk ka pas ma shumë Tiranë se qytetet e tjera? Sidomos hoxhallarë!... Përse, pra, të akuzohen tiranasit si antikombëtarë pa ekseption? (Dalliu, 1995: 7).

Edhe të kujtimet e Dalliut, pjesët kulmore janë burgosjet, rrahjet dhe dëbimet e nacionalistëve shqiptarë. Vetë Dalliu rrezikoi të humbiste jetën më shumë se një herë për shkak të bindjeve dhe veprimtarisë së tij. Të dy librat me kujtime të klerikëve në kohën kur u botuan rrekeshin të dëshmonin se, në vetvete, Islami nuk i kundërvihet identitetit kombëtar dhe se një pjesë e mirë e klerikëve myslimanë shqiptarë janë përpjekur e kanë luftuar përkrah shqiptarëve të besimeve të tjera për lirinë e atdheut dhe për mësimin e gjuhës shqipe.

Argumenti i dytë që ofruan klerikët myslimanë në shkrimet e tyre është se feja islame nuk e përçan, por e bashkon kombin shqiptar. Hafiz Ali Kraja, nga Shkodra, në vitin 1934, botoi një broshurë pikërisht me titullin *A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar?* Në parathënie Kraja e shpreh qartë, se libri i drejtohet atyre “pseudo-intelektualëve”, që mendojnë se feja nuk nevojitet më në kohën moderne ngaqë përhap fanatizëm dhe urrejtje për besimet e tjera. Një ndër pohimet që ai paraqet në broshurë është se Islami nuk i njeh për kundërshtarë

të krishterët, prandaj nuk ka arsye përse Islami të pengojë vëllazërimin e shqiptarëve myslimanë me ata të krishterë. Gjithashtu me interes është mendimi i Krajës se feja e pajis njeriun me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj detyrave dhe përgjegjësiwe shoqërore. Gjithashtu, kombi është një bashkësi vëllazërore, anëtarët e së cilës kanë detyrime të përbashkëta: “Do të ishte gabim të paramendohet kombi si një shoqërim ndërmjet individëve, të cilët nuk kanë ndjenjat e përgjegjësisë e të detyrimit” (Kraja, 2010: 63). Si rrjedhim, feja jo vetëm që nuk mund të dilte kundër bashkimit kombëtar, por e përçonte këtë të fundit.

Meqenëse kombi përfytyrohet si një bashkësi horizontale e individëve me të drejta dhe detyrime të barabarta, Kraja ofron edhe mbështetje teologjike për idenë e demokracisë. Sipas interpretimit që ai i bën disa haditheve, rezulton se Islami e përkrah idenë e demokracisë, duke lejuar vetëm pabarazinë morale dhe intelektuale (po aty: 67). Në vitin 1924, edhe Korça (2006 b: 35) kishte shkruar te *Zani i Naltë* se “në myslimanizëm aristokraci s’ka fare, gjithë myslimanët janë demokrat”. Sipas tij, çdo mysliman ngarkohet me përgjegjësi për të vepruar mirë dhe kësaj ideje Evropë moderne po i afrohet me anë të së drejtës së votës për të gjithë qytetarët. Jo vetëm kaq, por Islami barazinë dhe demokracinë nuk e shikon të

kufizuar vetëm te shteti kombëtar, por si parime të zbatueshme në të gjithë botën: “Në gjuhë të Kur’anit jo vetëm ne nënshtetasit e një shteti po edhe gjithë bota janë vllazën, demokrata e jo aristokrata” (po aty: 37). Duhet të kemi parasysh se, në vitet 20-30, intelektualët laikë që kërkonin reforma shoqërore në favor të shtresave të ulëta të popullit dhe kritiknin pabarazinë ekonomike, vetëquheshin demokratë. Duke gjetur mbështetje për demokracinë në traditën fetare islame, klerikët myslimanë kërkonin jo thjesht që të legjitimonin rolin e fesë në sferën publike, por edhe të shpallnin si të panevojshëm idetë “demokratike” dhe socialiste që shprehnin në shtyp intelektualët e majtë. Më 1937 Bashkësia Islame u kërkoi myslimanëve të pasur që të dhuronin diçka nga pasuria e tyre për të varfrit e papunë, në mënyrë që të dëshmohej se socializmi dhe komunizmi ishin të panevojshëm në Shqipëri. Autoritetet shtetërore po e shikonin dobinë e përdorimit të fesë islame kundër ideve komuniste që kishin filluar të gjenin terren te të rinjtë dhe më 1937 mësimi fetar u lejua në shkollat shtetërore (Clayer, 2008: 109).

Argumenti i tretë i klerikëve myslimanë në vitet 20-30 ishte se Islami nuk e kundërshton modernizimin dhe evropianizimin. Në debatin mbi modernitetin, edhe

klerikët myslimanë i referoheshin Evropës në shkrimet e tyre, por përdorimi i tyre ishte i ndryshëm nga ai i intelektualëve laikë. Ndërsa për të dytët, në çështjen e Islamit përballë Evropës, Evropa ishte gjithmonë pozitive, për intelektualët myslimanë Evropa mund të ishte pozitive ose negative. Ajo ishte pozitive atëherë kur ata pranonin nevojën që Islami të përshtatej me qytetërimin evropian, ose kur u kujtonin funksionarëve shtetërorë dhe intelektualëve laikë mbështetjen që shtetet perëndimore u jepnin institucioneve dhe shkollave fetare. Evropa mund të ishte edhe referencë negative për klerikët myslimanë atëherë kur ata e quanin atë “materialiste”, ateiste apo sipërfaqësore (po aty: 127). Në këtë aspekt, ligjërimi publik i klerikëve myslimanë ishte i ngjashëm me atë të klerikëve katolikë. Këta ndërsa e mburrnin praninë e katolicizmit në Shqipëri si një faktor oksidental në një vend gjysmë-oriental, në krahun tjetër kritiknin materializmin, individualizmin, kulturën e masave dhe humbjen e Zotit të qytetërimit modern perëndimor, dukuri që, sipas tyre, shqiptarët duhej t’i shmangnin duke kultivuar kulturën e tyre origjinale (shih Sulstarova, 2012: 217-223).

Lidhur me reformimin e Islamit, spikasin shkrimet e Ali Korçës të botuar te *Zani i Naltë* më 1924. Ai shprehej se “myslimanizma është një fe moderne, një fe shëndetësije

që i përshtatet shqencës... një fe qytetërimi... Dihet mirë se feja t'onë nga përparimi kurrë s'na ndalon" (Korça, 2006 b: 22, 43). Me këtë ai pranonte idenë e reformimit të fesë në kushtet e reja të Evropës, por ai mendonte se reformimi i Islamit, duhej t'i referohej traditës së vet dhe jo referencave jashtëfetare: "Faji është i neve muslimanëve që nuk jemi muslimanë si duhet" (po aty: 49). Sipas tij, Islami është fe e dijes dhe ai e kishte provuar këtë përballë gjendjes së Evropës mesjetare: "Ndë një kohë kurë ndë perëndimi, ingjizisjonet [inkuizicionet] përbytnin botën, renonin shtetet, çpiknin rrebeshet, myslimanizmi përhapte shkëndijat e çkëlqyeshme në të gjithë anën e botës" (po aty: 17-18). Korça qytetërimin e ndan në dy pjesë, në qytetërimin lindor shpirtëror, të cilin ai e quan "qytetërimin e vërtetë" dhe në qytetërimin teknik të Perëndimit modern. Gjatë dy-tri shekujve Evropa dhe Amerika kanë përparuar shumë në lëmin e qytetërimit teknik dhe Lindja, që të jetojë në kohën e sotme, duhet të përfshijë teknikën e Perëndimit. Mirëpo, ndërkohë, njeriu perëndimor ka humbur shumë nga bota e tij shpirtërore, diçka që nuk ka ndodhur në Lindje. Lindja përfaqëson qytetërimin e vërtetë, sepse ajo është djepi i feve monoteiste. Në këtë kuptim, edhe Perëndimi e ka në shpirt Lindjen. Për më tepër, ishte dija që Lindja ruajti në Mesjetë ajo që i dha shtysë

përparimit teknik të Perëndimit (po aty: 74-75). Perëndimi vërtetë tani është në një shkallë më të lartë se sa Lindja, për sa i përket teknikës, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sa i përket botës shpirtërore, sepse Perëndimi po i largohet besimit të Zotit. Prandaj, vendet e Lindjes nuk kanë përse të marrin shembull për gjithçka Perëndimin, por vetëm aspektin teknik të tij. Korça përmend Japoninë e kohës, e cila, sipas interpretimit të tij, e ka huazuar teknikën e Perëndimit, por ka ruajtur qytetërimin e vet lindor. Të njëjtën metodë Korça e rekomandon për shqiptarët: "Ne nga perëndimi mundim të marim vetëm qytetërimin mjeshëtor [teknik] edhe të mbajmë qytetërimin të vërtetë bashkë me disa zakone të bukura ashtu si i kemi trashëguar nga prindit t'onë... Ne për shembëll përparimi të kemi pasqyrë Japonëzët" (po aty: 41).

Për këto ide, Korça tërhoqi pas vetes sulmet e disa intelektualëve laikë, të cilët gjetën në personin e tij një mbrojtës aq shumë të kërkuar të "Orientit", kundër të cilit ata po zhvillonin misionin e tyre qytetëruar në Shqipëri dhe betejën e "të rinjve" ndaj "të vjetërve". Sado që Korça modernitetin teknik të Perëndimit e vlerëson më poshtë se sa qytetërimin shpirtëror, duke nënkuptuar Islamin si pjesë të këtij të fundit, ka gjasë që ai të jetë ndikuar sadopak edhe nga fryma e zhgënjimit ndaj idesë së përparimit të pandalshëm të njeriut

përmes teknologjisë, që përshkoi Evropën pas Luftës së Parë Botërore. Optimizmi mbi natyrën njerëzore dhe mbi të ardhmen e lavdishme u rrënuar para kasaphanës që i shkaktuan njëritjetrit popujt, që mbaheshin si model i qytetërimit. Menjëherë pas lufte, u shfaqën shumë libra apo artikuj, titujt e të cilëve përmbanin fjalë si “rënie”, “degradim”, “katastrofë”, “sëmundje” etj. Në vitet ‘20, libri *Rënia e Perëndimit* i Oswald Shpenglerit [Oswald Spengler], po korrtë sukses të jashtëzakonshëm në publikun evropian, pikërisht në sajë të tezës së tij se kulturës perëndimore i ishte shterur fuqia shpirtërore, se dominimit material të Perëndimit në botë po i afrohej fundi dhe se vendin e tij do ta zinte një kulturë më vitale (Spengler, 1962). Ishte po Shpengleri, ai që më 1931 do të shkruante te libri tjetër, *Njeriu dhe teknika*, se “popujt me ngjyrë” po e huazojnë teknikën e Perëndimit dhe do ta përdorin për t’i dhënë fund vetë Perëndimit (Spengler, 2011). Edhe në kritikën e tij ndaj qytetërimit teknik të Perëndimit, Korça, qoftë edhe padashur, po ndiqte tendencat e kohës në mendimin perëndimor. Gjithashtu, siç e vumë në dukje më sipër, kritikën ndaj materializmit, ateizmit dhe humbjes së vlerave shpirtërore të Perëndimit, gjendeshin te shkrimet e klerikëve katolikë shqiptarë, sikurse edhe te shkrimet e disa intelektualë laikë.

Argumenti i katërt i klerikëve shqiptarë në vitet 20-30 ishte se

Islami i shërbente kombit shqiptar, sepse mbante larg prej tij doktrinën komuniste. Klerikët myslimanë u angazhuan në luftën kundër ndikimit komunist në Shqipëri. Sërish, Hafiz Ali Korça u shqua në këtë drejtim me librin e tij *Bolshevizma, a çkatërimi i njerëzimit*, botuar më 1925, vit i restaurimit të sundimit të Zogut, pas shtypjes së asaj që regjimi e quante si kryengritje me orientim bolshevik. Qysh në krye autori e bën të qartë se qëllimi i shkrimit të librit është që t’i shërbejë atdheut dhe bashkatdhetarëve me anë të tregimit të natyrës së vërtetë të bolshevizmit. Sipas Korçës, bolshevizmi është më i vjetër se sa Lenini dhe Marksi, ai burimin e ka te armiqësia që çifutët kanë ndaj myslimanëve dhe të krishterëve. Çifutët dhe idetë e tyre për gjoja barazinë, kanë qenë shkaktarët e përcarjeve të hershme në gjirin e Islamit dhe më në fund ata arritën sukses në botën moderne, duke shtënë në dorë fuqinë ekonomike të botës. Çifuti Marks kishte për qëllim që të rrëronte fetë monoteiste dhe të rrëzonte qeveritë e mbarë botës dhe Lenini ishte nxënësi i tij. Duke përshkruar se çfarë po ndodh në Rusi, Korça përmend edhe se komunizmi nuk e njeh familjen dhe as patriotizmin. Çifutët e sundojnë Rusinë përmes bolshevizmit, por edhe Perëndimin e dominojnë me anë të kontrollit mbi ekonominë. Vetëm në shtetet myslimane nuk ka depërtuar dot bolshevizmi, gjë që

nënkupton se prania e Islamit në Shqipëri është një digë e fuqishme për të ndaluar ndikimin e çifutëve përmes doktrinë komuniste (Korça, 2006 c).

Përfundim

Në Shqipërinë e viteve 20-30 të shekullit të kaluar, zyrtarët e shtetit dhe intelektualët laikë e shihnin veten si agjentë të modernizimit dhe reformimit nga lart-poshtë të shoqërisë shqiptare. Edhe pse zyrtarisht shteti i përmbahej formulës së laicizmit, në praktikë kjo do të thoshte kontroll dhe dominim të shtetit mbi pavarësinë e institucioneve fetare, sepse shteti e shihte veten si mbrojtësin e njësisë kombëtare ndaj elementeve përçarëse. Autoritetet politike, luajtën një rol aktiv në riorganizimin e Bashkësisë Islame. Në këtë drejtim ndikuan edhe disa intelektualë laikë, që shihnin te Islami strehën kryesore të ndikimeve të dëmshme “orientale” pas pavarësisht të Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Në shtypin e kohës nuk mungonin akuza ndaj Islamit si burim i prapambetjes, fanatizmit, injorancës etj.

Disa klerikë myslimanë, duke e pranuar idenë e një reformimi të Islamit në Shqipëri, njëkohësisht bënë edhe apologjinë e Islamit, duke përmendur nevojën që kombi dhe

shoqëria shqiptare kishin për fetë në përgjithësi dhe për Islam në veçanti. Argumentet e tyre kryesore ishin katër. Së pari, se kleri mysliman kishte kontribuar në lëvizjen kombëtare dhe se dëshmia më e mirë për këtë ishin kujtimet e vetë protagonistëve, siç ishin Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Hafiz Ali Korça. Së dyti, se feja islame nuk ishte kundër njësisht kombëtar e idesë së demokracisë, siç synonte të shpjegonte libri i Hafiz Ali Krajës, apo artikujt e Hafiz Ali Korçës. Së treti, se feja islame nuk shkonte kundër qytetërimit modern dhe shkencës. Në këtë drejtim, Hafiz Ali Korça u përpoq që ta paraqiste Islam si fe moderne, dhe në pajtim me shkencën dhe reformën e institucioneve myslimane në Shqipëri, ta orientonte për nga vetë tradita e Islamit. Së fundi, se feja islame ishte mburojë e kombit kundër efektit përçarës së komunizmit.

Në shek. XXI, edhe pse konteksti shqiptar ka pësuar mjaft ndryshime që nga koha midis dy luftërave botërore, është interesante të vëresh shfaqjen e argumenteve të ngjashëm në shtypin shqiptar në mbrojtje të fesë islame. Sikurse atëherë, edhe tani, apologjitë për ekzistencën e Islamit ndër shqiptarët, shpeshherë janë si përgjigje ndaj përpjekjeve për ta konsideruar Islam si “tjetrin” e Perëndimit dhe si të huaj, apo rrezik për identitetin kombëtar shqiptar.

Burimet

- Balla, Xh., (2008) *Hafiz Ibrahim Dalliu: jeta dhe vepra*. Tiranë: ACFOS.
- Clayer, N., (2008) "Behind the Veil: The Reform of Islam in Inter-War Albania, or the Search for a 'Modern' and 'European' Islam". Internet: <http://hal.archives-ouvertes.fr/docs/00/57/59/56/PDF/clayer-behindtheveil.pdf> (vizituar së fundi më 25.09.2012).
- Clayer, N., (2010) "Adapting Islam to Europe: The Albanian Example". Internet: <http://hal.archives-ouvertes.fr/docs/00/57/87/57/PDF/clayer-adaptislam-final.pdf> (vizituar së fundi më 25.09.2012).
- Frashëri, M. (2000 [1928]) *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*. Tiranë: Phoenix.
- Frashëri, M., (2006) *Problemet shqiptare*. Tiranë: Plejad.
- Korça, A., (2006 a) *Vepra 2: Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*. Shkup: Logos-A.
- Korça, A., (2006 b) *Vepra 12: Publicistikë dhe shkrime të tjera*. Shkup: Logos-A.
- Korça, A., (2006 c) *Vepra 9: Bolshevizma*. Shkup: Logos-A.
- Kraja, A., (2010 [1934]) *A dubet feja, a e pengon bashkëmin kombëtar?* Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë.
- Morozzo della Rocca, R., (1994) *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: Elena Gjika.
- Spengler, O., (1962) *The Decline of the West*. New York: The Modern Library.
- Spengler, O., (2011 [1931]) *Njeriu dhe teknika*. Tiranë: Helga's Secrets.
- Sulstarova, E., (2007) *Arratisje nga Lindja: orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Bot. 2, Tiranë: Dudaj.
- Sulstarova, E., (2012) *Jam Evropë! Intelektualët dhe ideja e Evropës në vitet 1918-1939 dhe 1989-2006*. Shkup: Logos-A.
- Shpuza, S., (1999) *Vitet 20-30 në publicistikë dhe histori*. Tiranë: Toena.
- Williamson, M. & Khiabany, G., (2010) "UK: the Veil and the Politics of Racism", *Race & Class*, 52 (2): 85-96.
- Zavalani, T., (1998) *Misioni i shekullit XX*. Tiranë: Phoenix.

Sheuqet Muka (1887-1967)

“Mësuesi i Popullit” Intelektual i shquar Islam

Abstrakt

Sheuqet Muka ishte një patriot i flaktë dhe për të Atdheu ishte mbi të gjitha. Vija politike që predikonte ai ishte për një bashkim e vëllazërim, si një trup i vetëm, pse jemi shqiptarë, në radhë të parë, të një gjaku e të një gjuhe.

Ai nuk pati arsim fetar, nuk kreu detyra funksionale klerikale, nuk shërbeu në institucione e objekte kulti, nuk kishte petk fetar, megjithatë u formua si intelektual mysliman, si misionar i palodhur i Fesë islame.

Kontributi i tij në dobi të fesë islame në ato kushte e rrethana është i rrallë, i madh, i efektshëm, i gjithanshëm, sepse ai qe burim dije e edukimi, arsimi e kulture islame.

Në tërë veprimtarinë e tij në dobi të fesë, ai pati gjithmonë parasysh bashkëpunimin ndërfaqet, edukimin për bashkëjetesë, për paqe, harmoni e miqësi mes besimtarëve të tre besimeve fetare. Në shkrimet, ligjëratat e bisedat me tematikë të ndryshme Sheuqet Muka gjithnjë kishte parasysh gërshtetimin e anës fetare me atë atdhetare e anasjelltas.

Sheuqet Muka edukimin fillestar e mori në mejtep e më vonë tek intelektual i shquar islam Haxhi Ibrahim Kaduku, te myderrizët e hoxhallarët me zë, si: H. Hafiz Sali Myftia, Muhamed Bekteshi

etj, si dhe nga një studim intensiv individual i pandërprerë. Mësimi i gjuhës arabe dhe i shumë gjuhëve të tjera lindore e perëndimore, si poliglot, studimi i vëmendshëm dhe i kujdesshëm i Kur'anit, i haditheve profetike dhe i historisë islame,



krijimi i një biblioteke të pasur e të rrallë, bashkëpunimi i vazhdueshëm me personalitetet fetare të të gjithë vendit, njohja e gjendjes dhe e nevojave të objekteve të kultit, të institucioneve fetare, kontaktet me besimtarët myslimanë, në përgjithësi dhe veçanërisht të rinisë, dëshira për emancipimin e besimtarëve e kanë angazhuar atë për t'u marrë paralelisht me detyrat zyrtare dhe me problemet fetare. Kontributi fetar i Sheuqet Mukës ka pasur një grafik në rritje, ka qenë gjithnjë më i dukshëm, më frytdhënës në përputhje me rritjen e tij intelektuale, me afirmimin e tij në mjedisin e opinionin qytetar shkodran.

Përkushtimi i tij për fenë në përgjithësi e për disa probleme të saj në veçanti ranë në sy të organeve drejtuese arsimore fetare, që krijuan idenë e formimit të perspektivës

së këtij të riu aktiv e të papërtuar. Prania e tij si përfaqësues i Inspektorisë së Arsimit në provimet vjetore të Medresesë së Epërme në pazar të Shkodrës në vitin shkollor 1926-1927, konkluzionet e nxjerra dhe propozimet e bëra në raportin përkatës ndikuan që të emërohet mësues i jashtëm i Medresesë së Re në vitin 1927-1928.

Nxënësit e kësaj shkolle nuk gjenin fjalë për të lavdëruar mësuesin e tyre të ri. Ata thonin se krahas drejtuesve e profesorëve të përmendur fetarë, kishin pasur edhe mësues të kulturës së përgjithshme, po aq kompetentë e të paharruar si Sheuqet Mukën, Hasan Tahsinin e të tjerë. Ata tregonin për aftësitë e tyre shkencore, pedagogjike, didaktike e komunikuese, si edhe për interpretimin e drejtë të lëndës në përputhje me parimet e fesë islame. Me përgatitjen e përvojën që fitoi, Sheuqet Muka mori nismën dhe ia arriti qëllimit, duke bërë një punë të lavdërueshme për hartimin e teksteve mësimore për mësimin e besimit dhe përkthimin e "Jasinës".

Në vitin 1923 ndodhën ngjarje të rëndësishme për besimtarët myslimanë shqiptarë: u zhvilluan Kongresi Mysliman, në të cilin ai qe pjesëmarrës aktiv si përfaqësues i prefekturës së Shkodrës. Në këtë kohë lindi nevoja e hartimit të teksteve të mësimin të besimit për nxënësit e shkollave fillore. Kësaj detyre të vështirë, por me vlera të

mëdha edukative, iu përgjigj i pari Sheuqet Muka. Ai hartoi njërin pas tjetrit 3 libra të tillë (ilmihal) që në vitin 1923, të cilët u miratuan nga Këshilli i Naltë i Xhema'ati Islamijes dhe Ministria e Arsimit.

Duke u ndalur vetëm te libri i parë rezulton se autori e ka përgatitur atë me një aftësi të rrallë, me një kujdes të madh, me saktësi fetare, me kompetencë pedagogjike e metodike. Libri përbëhet nga 27 mësimë të veçanta, të cilat përmbajnë paraqitjen e temës me hollësi në bazë çështjesh.

Në këtë kuadër, duke përgjithësuar përvojën e grumbulluar më vonë, në vitin 1927 botoi librin “Dijeni praktike besimtare” për shkollat fillore e mbarëshkollore, që është fillimi i botimeve të Këshillit të Naltë të Sheriatit me nr. 1. Ai është punuar në një formë të mirë paraqitëse, ka zhvillimin e temës hollësisht, e cila vazhdohet me përmbledhje, me tregues historik e praktik dhe në fund ka shpjegim fjalori. Meritat e Sheuqet Mukës për botimin e kësaj literature qenë të pakrahasueshme. Ai që i pari që dha shembullin e mirë, që siguroi një seri librash fetarë të kësaj natyre, aq të domosdoshme për plotësimin e nevojave të fëmijëve, të rinisë e të besimtarëve. Vlera e këtyre shtohet edhe për faktin se ata ishin në gjuhë amtare, të kuptueshëm, të qartë e konkretë, me një stil të bukur e me një fjalor të zgjedhur.

Në krijimtarinë origjinale të autorit bëjnë pjesë edhe disa krijime në poezi, ilahi e kaside, që shprehin ndjesi të holla fetare, përkushtim e vlerësim të ngjarjeve historike nga Feja islame.

Është për të ardhur keq që ky kontribut me vlerë, ndër të parët përkthyes, shoqëruar me shpjegime, nuk është njohur nga studiues të ndryshëm nga Shqipëria dhe trevat shqiptare.

Lidhur ngushtë me krijimtarinë origjinale e përkthimet janë shkrimet e tij të shumta me karakter fetar. Sheuqet Muka zakonisht ka shkruar me pseudonime, për shkak të pozitës së tij zyrtare laike. Artikuj të shumtë publicistikë të firmosur me pseudonimet “Shkodrani”, “Arsyeja”, “Erzeni” etj, në revistat “Zani i Naltë” e “Kultura Islame” janë një tjetër kontribut i vlefshëm i Sheuqet Mukës për zgjidhjen e problemeve shqetësuese të Fesë islame për vendin e të gjitha trojet shqiptare.

Tematika e këtyre shkrimeve është e larmishme në përmbajtje e në formë, ajo përmbledh përkujtime personalitetesh, rrahje problemesh fetare, arsimore, kulturore, emancipuese, tolerancë ndërfitare, edukim atdhetar, diskutime, replika, propozime e kritika.

Këto botime origjinale e shkrime patën një efekt të madh pozitiv te lexuesit. Ata u vunë në dijeni me realizëm e objektivitet për gjendjen

e mjaft problemeve shqetësuese për kohën, u edukuan me ndjenjat fetare e atdhetare, u bënë më të vetëdijshëm për përgjegjësinë e organeve drejtuese dhe për rolin e tyre në zgjidhjen e detyrave të mprehta në qarqet e në kryesinë e Komunitetit Mysliman, qenë pjesëmarrje aktive e autorit të tyre për zgjidhje të shpejta, të drejta, përparimtare e bashkëkohore, qenë ide për përmirësime, për reformime, për kthesa që diktonte zhvillimi fetar e kombëtar.

Në shumë shkrime ai ka trajtuar tema të rëndësishme e të mprehta të ditës e të perspektivës. Ato janë interesante, të hartuara me kulturë, të zhvilluara me synime të caktuara, të përshkuara nga dëshira për të zgjidhur probleme të vështira e të ndërlikuara. Të tilla janë shkrimet: “E vërteta s’vdes kurrë!”, “Reforma dhe shpirti i myslimanizmit”, “Të gjith kemi një dert”, “Nji përgjigje që s’përgjigje”, “Ndrejt pështimit”.

Disa shkrime kanë pasur karakter historik islam, si: “Të dalunit e të përhapunit e Islamijetit”, “Detyra e ynë ndaj Sahabeve” etj. Këto kanë pasur elemente përkthimi, përshtatjeje e gjurmimi të literaturës botërore.

Në vargun e krijimtarisë së Sheuqet Mukës është për t’u shënuar angazhimi i tij si ligjërues në tubime me besimtarët dhe në ndihmë të hoxhallarëve për predikime, në të cilat ka mbajtur tema interesante fetare, që shquheshin për thellësinë

e përmbajtjes, qartësinë e trajtimit, bukurinë e natyrshmërinë e paraqitjes së fakteve e të argumenteve, pasurinë e gjuhës e stilin elokuent prej oratori. Ligjërata të tilla kanë qenë “Shfaqja e Muhamedit (a.s.) në skenën njerëzore”, “Feja islame, fe e natyrshme” etj. Në arkivin familjar gjenden të dhëna të tjera interesante në dorëshkrime për krijimtarinë fetare. Ndër to një abetare arabisht me një metodikë moderne të mësuarit, me qëllim që besimtarët e çdo moshe të aftësoheshin për të lexuar Kur’anin dhe studime të shumta, si “Shkronjat e Kur’anit”, “Rëndësia e mevludit”, etj.

Për problemin e arsimimit të fëmijëve myslimanë ai ka zhvilluar një veprimtari të gjerë edhe në drejtime të tjera. Ai ka ngulmuar që në hapjen e shkollave të para laike më 1913 e më tej, si edhe në vitet shkollore 1921-1922 e 1922-1923 e në vazhdim të hapeshin shkolla fillore atje ku mungonin, që fëmijët myslimanë të mos mbeteshin analfabetë, që në to të vendoseshin mësues myslimanë, që krahas mësimave zyrtarë ata mund të zhvillonin edhe mësimet e besimit për mungesë të kuadrit fetar.

Për arsimimin e të rinjve myslimanë ai ngriti probleme për përmirësimin e punës në Medresenë e Përgjithshme, për gjallërimin e konsolidimin e medreseve të qarqeve e për ngritjen e një medreseje të re, pas suprimimit të tyre në qytetin e Shkodrës, duke e argumentuar këtë

me fakte bindëse e me përvojën e këtij qyteti fetar.

Sheuqet Muka nuk u kursye për të dhënë ndihmesën e vet edhe në drejtime të tjera: si aktivist i Myftinisë, si bashkëpunëtor i Këshillit të Naltë të Sheriatit, si këshilltar i Komunitetit Mysliman, si anëtar i kryesisë së Degës Kulturele të Komunitetit Mysliman, me kryetar personalitetin e shquar Mehdi Frashërin etj.

Në tërë veprimtarinë e tij në dobi të fesë, ai pati gjithmonë parasysh bashkëpunimin ndër fetar, edukimin për bashkëjetesë, për paqe, harmoni e miqësi mes besimtarëve të tre besimeve fetare. Në shkrimet, ligjëratat e bisedat me tematikë të ndryshme Sheuqet Muka gjithnjë kishte parasysh gërshetimin e anës fetare me atë atdhetare e anasjelltas.

Veprimtarinë fetare Sheuqet Muka nuk e ndërpreu edhe kur qe i burgosur, edhe në kampet e punës i dënuar nga diktatura komuniste. Me gjithë vështirësitë, pengesat e pasojat e rrezikshme, ai mbeti veprimtar i palodhur i edukimit të të burgosurve me mësimet fetare, u mësonte atyre pjesë kur'anore, u fliste për ngjarje të historisë islame, i nxiste t'i shtonin përpjekjet për edukimin shpirtëror, u forconte durimin e u ngjallte shpresën për jetën, për të ardhmen, për lirinë e demokracinë. E bashkëvuajtësit përfitonin nga formimi, përvoja, karakteri, besimi e shembulli i tij personal.

Për figurën, personalitetin e karakterin e Sheuqet Mukës janë dhënë vlerësime të shumta gjatë viteve të fundit nga studiues të ndryshëm. Përveç dekorimit me titullin e lartë “Mësues i Popullit” nga ana e presidentit të Republikës për kontributin e tij të shquar në lëmin e arsimit, janë vënë në dukje meritat e tij edhe në aspektin fetar.

Besimtarë të moshuar përcjellin se në Shkodër në vitet 1920 kishte “Dy bilbila, që mbanin predikime e biseda, që shkruanin libra e botonin në revista, ata ishin Hafiz Ali Korça e Sheuqet Muka”.

Vlerësime për rolin atdhetarofetar të Sheuqet Mukës ka dhënë edhe rapsodi Dede Shyti në veprën e tij “Rapsodi të përgjakuna” e “Kronikë rapsodike”. Ky autor shprehet kështu:

“Hallall’ kjoftë e Shqipnisë buka,
Xhemal Naipi e Sheuqet Muka,
Patriotë fetarë e atdhetarë,
Egër i shtypi diktatura”.

“Me Xhemal Naip, Sheuqet Mukë shkodran

E sa e sa tjer’nga Jugu e Tiranë,
Projekte andrrojshin, për
Shqipnin’ nanë,

Se në çfarë kthetrash e kishin
lanë”.

Ai ishte një patriot i flaktë dhe për të Atdheu ishte mbi të gjitha. Vija politike që predikonte ai ishte për një bashkim e vëllazërim, si një

trup i vetëm, pse jemi shqiptarë, në radhë të parë, të një gjaku e të një gjuhe.

Ai shoqërohej me të burgosur me bindje të ndryshme politike, diskutonte me ta me zemër të hapur dhe vlerësonte kontributin dhe gatishmërinë për t'i shërbyer atdheut me alternativat e tij.

Ai nuk pati arsim fetar, nuk kreu detyra funksionale klerikale, nuk shërbeu në institucione e objekte kulti, nuk kishte petk fetar, megjithatë u formua si intelektual mysliman, si misionar i palodhur i fesë islame.

Kontributi i tij në dobi të fesë islame në ato kushte e rrethana është i rrallë, i madh, i efektshëm, i gjithanshëm, sepse ai që burim dije e edukimi, arsimi e kulture islame.

Me këtë veprimtari e krijimtari të pakrahasueshme Sheuqet Muka e ka vendosur veten në radhën e parë të intelektualëve të shquar myslimanë, si shembull i bukur dhe model frymëzimi, që do të kujtohet gjithmonë nga brezat me nderim e vlerësim, me dashamirësi e mirënjohje të përhershme.¹

1. Për më tepër shih artikullin e botuar nga Dok. Honoris Causa Faik Luli, gazeta "Drita Islame", nr. 127, 1997: 3-4;

Përse studjuesit e dituris e formojnë shumicen e atyne që dyshojnë dhe hezitojnë në çashtje fetare?

Hafiz Ismet Dibra

Abstrakt

Idea e frazës së mäsipërme shkakton një turbullim në besimin e kullue të disa njerëzve të zgjue të klasës së popullit.

Verevërtë, në pjesën më të madhe të atyne që janë tue studjue dituri gjejmë asish që në çashtje fetare dyshojnë e hezitojnë e asish që fyejnë feën e një pjesë që deklaroun afetarizmin e vet e që tallet me fetarët. Kesi farë njerzish më fort i gjejmë ndër studentët e shkollave e sidomos më fort ndër ata që studiojnë në Europë. Atakimi i kësaj kategorije aqë largë ka shkue sa që sulmojnë edhe objektet më të shenjta të prindenvet të tyre tue shpërda dyshime. Efekti i kësaj gjendjeje tue përjashtue elitën që din me çmue vlerën e shkencës e të dituris – ka shkaktrue një besim në opinionin publik se gjoja shkenca dhe diturija prishin feën, propagandon afetarizmin dhe i bënë njerzit atheista.

Idea e frazës së mäsipërme shkakton një turbullim në besimin e kullue të disa njerëzve të zgjue të klasës së popullit.

Verevërtë, në pjesën më të madhe të atyne që janë tue studjue dituri gjejmë asish që në çashtje fetare dyshojnë e hezitojnë e asish që fyejnë feën e një pjesë që deklaroun

afetarizmin e vet e që tallet me fetarët. Kesi farë njerzish më fort i gjejmë ndër studentët e shkollave e sidomos më fort ndër ata që studiojnë në Europë. Atakimi i kësaj kategorije aqë largë ka shkue sa që sulmojnë edhe objektet më të shenjta të prindenvet të tyre tue shpërda dyshime. Efekti i kësaj gjendjeje tue përjashtue elitën

qi din me çmue vlerën e shkencës e të dituris – ka shkaktue një besim në opinionin publik se gjoja shkenca dhe diturija prishin feën, propagandon afetarizmin dhe i bân njerzit atheista.

Në për të çdukë këtë illusion edhe për të fitue njohuni mbi shkakun e parë të prirjes fetare po e marrim nëpër dorë këtë themë edhe thomi:

Njeriu si mbas natyrës morale qi ka nuk mundet me ndjetë indiferent përpara çdo të panjohurës. Edhe ato mâ injorantët bile janë nën influencën e dëshirës për me kërkue e me nxanë me mjetet qi disponojnë çdo ngjarje e çdo fenomen qi i u prek ndjenjat e mendjen.

Njeriu, porsa doli në sheshin e jetës i mundun prej natyrës së tij i shtiu në punë cilësit mendore dhe filloi me hetue botën, me veshtue qiellnat e tokën e me persjatë mbi çdo fenomen të natyrës. Nga këjo përpjekje njeriu formoi konceptet e tija të përshtatuna me gjendjen e tij të thjeshtë e fillestare, e me këtë mënyrë, tue mos pasë asnjë ide mbi ligjet e natyrës qi ka vendosë Pushteti i Amshuëm të gjitha fenomenet qi j'a panë sytë i mbështeti në shkaqe shpirtnore.

Mirëpo njeriu është një krijesë qi nuk mundet me numrue në vend, nuk mjaftohet me gjendjen e tashme, por hidhet për tej; turret mbas të panjoftunash dhe kërkon me zbulue të vërtetën. Në fund të këtyne kërkimeve një disa shkaqe natyrale

edhe çdo shkak e lidh me gjaën e shkaktueme e me këtë mënyrë të gjitha shkaqet shpirtnore i ngriti edhe mbajti vetëm shkakun e parë.

Mendja e njeriut nuk e ka natyrën e saj me ndejtë e ngrime përpara gjanave të pa njoftuna qi i takon. Ajo kërkon shkakun e parë edhe kurrë s'perkulet e s'beson se mendja njerzore s'ka fuqi me e kuptua shkakun e parë.

Me gjithë këtë njeriu në kuptimin e së vërtetës nuk bân asnjë hap; sepse po shifet çiltazi se me gjithë madhësitin e pushtetit intelektual qi zoton njeriu, nuk mundi me analizue asgjë në këtë pikpamje: qendroi aty ku kje përpara pikëpyetjeve:

Qysh është eterniteti i këtij realiteti?

Ç'bante ky pushted përpara se të krijonte botën?

Ky pushted si mundet t'a përshijë me diturin e tij çdo gja?

Vullnetit të këtij pushtedi qysh i bindet çdo gjë në botë?

Përpara këtyne problemave abstrakte asgjë s'mundi me vendosë njeriu. Kje punë e pamundur t'i zgjidhte sa problema qi j'u paraqitën në këtë botë; sepse njeriu i gjeti keto problema shumë të nalta e të pa krahasueshme me formulat materjale qi janë të kufizume. Njeriu i dalldisun në keto studime qi s'i kap materia u mbulue prej një ndjenje të habitëshme e të pa shoqñueshme me qetsin e zemrës e shumë herë kejo ndjenjë e hutoi të

zotin dhe i dha shkak qi të mohonte cilësit hyjnore, t'a humbiste rrugën në veprimet hyjnore e së fundit t'a deklaronte edhe mosbesimin e tij në qenjen e Pushtetit Hyjnor qi është shkaku i parë.

Mirëpo njeriu në këtë periudhë kritike po t'i drejtohesh arsyes së plotë, tejqyra e kësaj arsye do t'ja kallzonte çiltaz se parimi i tij shkencuër, ka dalë vetëm nga bota landore, e se ky parim është i kufizuem e i kuptuem me shkísá; kurse studimi i shkakat të parë është i kullue nga konditat e materies së verbët dhe është thjesht një botë absolute, ku s'mund të mbrinë dispozitat e botës landore.

Njeriu qi ndjek rrugën e porositon më sipër e kupton se studimi i problemave të holla të botës supreme mund të realizohet vetëm me shqyrtimet e imta qi i përshtaten naltësis së panakatosun me maskat e materies. Gjithashtu ky njeri kupton se pse s'ju shtrohet mjeteve landore studimi i këtyne problemave të nalta e pse me keto mjete nuk mund të zbërthehen keto problema, nuk don me thanë se keto problema të tejnatyrëshme nuk ekzistojnë. Pse dikuer s'kishte formue ndonji ide edhe s'i kuptonte njerzija elektrikun, magnetin e mjetet tjera landore të dritës, qi u zbuluën rasesisht, a na provon se atëhere keta gjana nuk ishin? Sa sende të mshefta ka në botë qi ende nuk janë zbulue; dhe mos zbulimi i ketyne sendeve

nuk na dishmon mosqenëjen e tyne dhe s'mund t'a pretendojë askush këtë dishmi. Sepse:

«Medlulën vuxhudi delili istilzam etmez.»¹

«Vuxhudul - medluli la jestelzimud - delile.»²

- është një rregull e pranue me prej gjith dijetarëve të urtë.

Plotsimi i mendes pergjithësisht është një gjâ e re në jetën e njeriut. Shum gjana ishin mohue, mirpo më vonë është vërtetue qenëja e tyne e kështu u provue se mendja zhvillohet e plotsohet. Asht një histori plot me çudira jeta e njeriut qi është ngutë me mohue eksistencat. Armikët më të mëdhenj të shkencës, kur sjellin ndërmend atë epokë, skuqen e turperohen edhe diçka i u therr ndërgjegjen.

Kamel Flamarjon-i, qi është një filosof i madh, në librin e tij «E panjoftuna» përmend se «qenëja e shum sendeve është vërtetue, sado qi më përpara shkencëtarët e filosofët i kanë mohue rrebtësisht keta sende» e pastaj thotë: «I çquari filosof, Galileu, u dogj në zjarr, pse guxoi me thanë se Dheu është një lashm i vogël qi vozit në hapësirë,

1. Ekzistenca e diçkaje të kuptuar nuk ka nevojë për argument (Turqisht - Shënim i redaksisë).

2. Ekzistenca e diçkaje të kuptuar nuk ka nevojë për argument (Arabisht - Shënim i redaksisë).

gjâ qi sod është e vërtetueme dhe e pakundërshtueme.»

Gjithashtu Flamarjon-i po në atë libër thotë: «Më 11 të Marsit 1878 ishja gati në një mbledhje akademike shkencore ku u paraqit zbulesa e Edisonit, gramafoni. Me t'u kurdisur e me të fillue të flasi gramafoni kërceu nga vendi Z. Buijo, një nga dijetarët e mëdhenj e kapi për fyti atë qi e ngrefi tue i thanë:

“Jazik bre, qi na ke marrë për aqë naiva sa don me na e mbushë menden se kejo vegël flet vetë, kurse ti je aj qi flet.” Gjâja mâ e çudiçme është se Z. Buijo gjasht muaj mbas kësaj ngjarje me 30 shtatuer përpara një grupi dijetarësh bân një studim të imët e në studim e sipër thotë se gramafoni është një spekulim, një dallavere; melodija qi ndëgjohet nuk është zani i gramafonit por i atij qi e rregullon gramafonin; sepse s'ta merr mendja qi një copë metal të ketë organe zani si ata të njeriut. »

Pra gramafoni për Buijen ishte një imagjinatë e jo një realitet.

Flamarjoni në librin e tij vazhdon tue thanë: «Kur, qimisti i famshëm, Lavuazije, analizoi ajrin dhe zbuloi se ishte i përbamun prej Oksigjenit e Azotit, një shkencëtar, zbuluesi i Arometrës, Baumé, e kundërshtoi rreptësishtë tue thanë se elementet e para, me të cilët formohen trupat, janë të njoftun prej dijetarëve të çdo populli. Pra një trup i njoftun qysh prej dy mij vjetesh si element i thjeshtë nuk është e mundun qi

sod të numërohet trup i përngjitun. Prandaj sikurse është e pa mundun qi elementet e thjeshta të konsiderohen të përngjitun, ashtu është e pamundur të pranohen argumentat absurde e mjetet e caktueme për të zbërthye ujët e ajrin. Nuk do t'u them mâ tepër as atyne qi mund të mohojnë se zjari e dheja janë elementa të thjeshtë, – thotë, e në fund shton – kompetentët i kanë pranue këta elemente, në të cilët kanë lidhje njohurit qimike e natyrale të derisotme. Këta elemente janë themeli i theorive e i zbulimeve të panumërta. Në qoftë se të katër elementet e para, zjarin, dheun, ujët e ajrin nuk do t'i pranojmë për elemente të thjeshta, atëherë duhet të mos besojmë mâ në theorit e në mbulesat e dersoçme.»

Z. Flamarjoni pastaj në librin e tij vijon gjykimin e vet e thotë: «Sod e dinë të gjithë se katër elementet e mbrojtun me aqë nxehtësi të madhe nuk kanë asnjë mbështetje. Qimistët e shekullit të soçëm, qi analizuën ujët edhe ajrin kanë të drejte. Pretendimi i Baumé me shokë, qi htonë se zjarri është burrimi i natyrës e i jetës, është një krijesë e fantazis së tyne.» Këtu merr fund fjala e Flamarjonit.

Shembullave qi na solli Z. Kamel Flamarjoni ne j'a shtojmë edhe këto:

Mendja njerzore në qoftë se edhe në shekullin modernë ngul kambë edhe mohon methudhat e botës së dukun, me të cilat është stërvitë, asht e natyrëshme që përpara botës supreme qi asht shumë ma e naltë

se këjo botë, do të jetë edhe ma shumë kryeneçe. Por se duhet ditur që dyshimet e mendës nuk i sjell dituria por këto dyshime janë një ndjenjë e gabueshme që ndodhet në vetë natyrën njerzore. Këjo ndjenjë e gabuara i jep njeriut iden se me mjetet e ulta që disponon asht i zoti të kuptojë çdo gjë e ata që s'i kupton nuk ekzistojnë fare për të. Mirpo historia e inteligjencës njerzore na dishmon se është punë ma e urtë ma e rezervume përpara çdo gjaje që nuk dijmë. Me gjithë këtë dituria gjysmake e ka rritë mendën e njeriut dhe e ka bërë që të ngulet rreth asaj që din e nuk i jep mundësi me kaluar as sa një flok përtej kufinit të diturisë që zotën. Këjo dorë njerzish beson se me njohurit që zotojnë munden me zbërthyer të gjitha problemat që j'u paraqiten e pandehin se dituria e tyre është e zonja me përfshi edhe sferat e tejnatyrsme.

Mirpo eruditët e çmojnë se rezultatet e fitues me njoftonit e soçme duhet të vihen në peshën e arsyes. Edhe sistemet që kanë marrëdhënje me matematikë e mekanikë duhet të përshkohen sa të jetë e mundun nëpër një kritikë të imët. Letratyra e dijetarëve kompetent asht dishmitarja e thezës s'onë.

Asht influenca e agjentave të sipërdiftuëm që shumë zotni të diplomuam i bënë të pandehin se sasija e studimit të tyre asht kulmi i diturisë ku mundet me mbri njeriu. Ata

kujtojnë se masat e kriteret që kanë në dorë janë të mjafta për me marrë vesh të qenunin e të paqenunin, të mundëshmin e të pamundëshmin.

Kur grishen me bisedue mbi problema të nalta ata dëshirojnë që të masin vetëm me pashin e vet e kur kriteri i tyre s'ka fuqi me matë problemin që u paraqitet ndjekin rrugën e mohimit. Një kundërshtar mund të na thotë: Na i gjykojmë gjanat si mbas kriterëve që zotojmë, e në qoftë se ju keni në dorë ndonjë kriter menduer e gustuër na e thoni. Kritikë e gjyrmimet të bame në shekujt e fundit i kanë çvleftësue të gjithë kriteret mendore e gustore; provat t'uaja mund të bindshin shekujt e kaluëm e neve që me anë të principeve të shkencës eksperimentale jemi në gjendje me i dallue këto gjana, provat t'uaja s'mund të na bëjnë asnjë efekt.

Kësaj kritike i përgjigjemi kështu: I madhi Zot ka krijuar një tendencë të re shkencore të mjaftueshme për t'u bërë ball nevojave të kohës. Dijetarët kompetent nëpër mjet të njohunivët që kanë fitue me shqisat e me të pa kanë zbulue disa porta të reja nën titullin «Studime psikologjike» ku rrifën do problema që s'mund të zbërthehen kurrse me mjetet e shkencës fizike. Veçse shumë të ri nuk kënaqen nga studimet e tilla e, kur i u propozohen, i u shtëmangen tue thanë se këto janë fantazina të njerëzve të gabuëm, kurse në realitet këto studime janë fryti i provave

qi kanë ba savantët e pjestarët e akademive.

Kritikuesit e kësaj kategorije po të ngulin kambë e të numërojnë në vend, duhet t'a dijnë se përgjegjsija nuk i takon mungesës së kriterit, por neglizhencës së atyne qi s'e zbatuën këtë kriter.

Shkaku i atheizmit të të rive t'onë të diplomuëm është pse ata nuk interesohen për çashtjet immaterjale. Nga sa spjeguëm deri këtu kuptohet se dekadencia e rinis s'onë rrjedh pse

e tanë kultura e tyne është materiale. Perëndija po na i dhuron të gjitha mjetet për t'u naltësuar njeriu në botën e dukun e të padukun si mbas nevojës së kohës.

Të gjitha zbulimet e dijetarëve të mëdhej qi shembën fund e majë theorit materiale të deritashme janë përkrahja dhe hira hyjnore qi na mbrriini në kohën ma të ngushtë e ma të nevojshme.³

3. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 12, viti XI, 1936, f. 357 – 364.

Abstracts in English

Islamic Sciences

1. Tradition of Mawlud to the Muslims

Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovo

Abstract

It is an undeniable reality that Mawlud celebration - the Prophet (AS) birthday - did not happen during Prophet (AS) lifetime. In fact, such a celebration has neither occurred during the period of the Companions, nor during that of the Tabi'un, or Tabi-Tabiun. Therefore, Mawlud celebration in the past was never made in the format we now see and today's Muslims throughout the world practice.

Muslim scholars are of the opinion that: On this night it is pleasing that God be glorified, prayers be chanted, alms be given, good deeds be done etc. If all these works are done for the sake of Allah, then the reward is great.

The message of this celebration regarding the Memorial of Last Prophet's - Muhammad (PBUH) - birth would be: 'Return to your religion, its basic sources, the Qur'an, the hadith of Muhammad (PBUH), but also have a glance at our glorious tradition, as long as it is not in a substantial conflict with Islamic principles, because there is our salvation; there is the future for this people, and there is the happiness.

2. Meditation – the illuminating path of faith in God MA. Dorian Demetja, Muslim Community of Albania

Abstract

Meditation on God's creatures is a ritual that removes worries and concerns, for after this process one feels that this world - with all its troubles - is very small compared to the universe; he feels that all problems and sufferings are too small compared to the grandeur of the universe and the Creator.

In his inner world, man is a creature that needs to be excited every day, nay several times a day. From this perspective, our task in this regard is not avoiding the good friends, for a good friend - at any time - with his useful advice and instructions may awaken emotions and excite our hearts.

At any time, our prayer - by which we turn to God - must be made in order to protect us from the evil of his own self and the devil, in order to enable us continuing our life in an atmosphere of the divine grace. At the same time we pray Allah (SWT) - through meditation - to better understand and comprehend in a multidimensional view the messages of Islam and by representing them in a dignified manner, to gain the pleasure of our Creator.

Studies

3. The crown on the humbled head

Fatos A. Kopliku, MS/MA
Washington, DC

Abstract

In this article we will make an essential comparison between Islam and Christianity, the religion which more than anything has shaped, if not created, the West. The comparison is between Saint Mary and Prophet Muhammad ﷺ and it is our belief that will help the mutual understanding between the two religions since it is of an essential character, and as such it avoids the danger of dwelling on the superficial, a natural consequence of emphasis on formal comparisons. In Islam the Qur'an, the Word of God, comes as a book, while in Christianity the Word of God is Christ who "was made flesh and dwelt among us". From this point of view it follows naturally the comparison between Prophet Muhammad ﷺ and the Saint Mary as the recipients of the Divine Word. We point here that the comparison is not in the role of the Prophet as legislator, statesman, or military strategist, roles these of outer nature - not inner - similar to those of the prophets of the Old Testament, or the avatar Krishna in Hinduism.

4. Christians! Reflection of a Muslim in troubled times!

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

University Hospital Center, “Mother Teresa”, Statistics Department

Abstract

My neighbor Christian! This expression may have been something unusual to the greatest part of Muslims for centuries. Homogeneity within the provinces has been common, even within the so-called neighborhoods in Ottoman millet system, while the geographical lines of separation between Islam and Christianity has been dynamic and very often it has been used as a real war front. In such a situation, the interaction at the individual level of Muslims with Christians has been - to some extent - limited. The increase in communication opportunities and traffic speed along with several decades of relative peace after the Second World War, has brought ease in overcoming long distances and increasing the number of contacts between the people of the whole planet. Muslims and Christians living and working together in the same environment and cyberspace - this phenomenon is unprecedented in human history. Differences in the choice of religious affiliation in a civilized environment are impossible to overlook while global situations are not very peaceful. The mutual respect for each-other beliefs requires a minimum of mutual recognition and therefore one should also know some limits to be respected and surely, many other limits that are a subject of ongoing discussion. Interfaith discussions are somehow necessary, because the closure itself and parallel existence without communication can lead to misunderstandings, which would be resolved immediately through the recognition of the others. This discussion is very present in the global, religious leaders and definitely at individual level in our daily lives.

5. Extremism between prejudice and stigmatization

Doc. Dr. Faredin Ebibi

Dean of the Faculty of Islamic Sciences – Skopje, Macedonia

Abstract

Extremism as a phenomenon has accompanied humans throughout all periods. As a phenomenon it has can be found everywhere in the pores of life, in the political sphere, as well as in the economic, ideological, religious, sports areas and elsewhere.

As a result of global changes, the most questionable of them - on which many debates have arisen - is the so-called violent religious extremism with a large extent of the tendency of attributing this phenomenon, to a certain religion – Islam to be precise - as if all the other ideologies, religions or other structures are immune from this phenomenon.

Keywords: extremism, Islam, ideology, prejudice, stigmatization, the Qur'an, Sunnah, trend, regulation, standard.

Language and literature

6. Some topics and dilemmas about the translation of the Quran in Albanian language

Mr. Elez Ismaili

“Isa Bey” Madrasa, Skopje

Abstract

It is an undeniable fact that the issue of the Quran translation has involved most of the prominent scholars of Islamic provenience, and all of them have given their opinion regarding it. By analyzing their statements, we can conclude that interpreters of all time have been categorical in their opinion that the Qur'an should not be translated, but they agreed that this divine treasure be offered to the peoples of the whole world. And finally we have to agree with the following two statements that can be used as a motto. The first is that of Imam Vehbi Dibra, drawn from his speech on the occasion of the publication of some Quran excerpts in Turkish and Albanian. He says: "Since the Qur'an is the glorious word of the Creator of universe, it therefore must be translated magnificently, and this is not work to be done by the torpid pen of parochial people." Whereas for errors in translations he says: "Reading such books full of noticeable errors in translation may distort the belief, therefore we advise not giving them importance and furthermore, nor reading them at all." Another finding is that of Enes Kariqi, who says: "The Quran is not possible to be fully translated, but it absolutely must be translated."

History

7. The relationship between press and government in Albania:

The approval of the Ottoman press law in 1922

Dr. Hasan Bello, Institute of History, QSA

Abstract

Studying the relationship between the press and government is an interesting aspect in the history of the Albanian journalism. It is a clear indication of the path the battle for freedom of speech has followed. Therefore, to illustrate this issue we have chosen only a short segment of history, but which contains in itself a complete mosaic.

This article addresses the debate on the press and freedom of speech in 1922 and the discussions that took place in this period regarding the approval of the Ottoman press law.

The draft of this press law - taking as model the Ottoman legislation, - was not welcomed by some intellectual circles. In the vanguard of the struggle in defense of press

freedom was Faik Konica with his newspaper "Dielli". He called the decision a "pseudo-canon", according to which, henceforth, in Albania could circulate only newspapers sold to the police.

According to him, those who do not like the press freedom don't like the light too and therefore, they jeopardize the national security. This, because Faik Konica considered the press as a necessary tool in benefit of a society, exactly like a discharge valve ("safety valve"). Restricting the press freedom - according to him - comprises a source of tyranny and generates violence.

This law did not create any legal or factual impediment to the press of that time. Rather, journalists and intellectuals published articles, criticism, controversy and pamphlets on various aspects of social and political life. This is also observed in the extraordinary publicistic legacy, which is an indicator of a high professional level. Over the years press legislation evolved in compliance to the internal development of the Albanian state and the new circumstances that were created within the country.

Islamic jurisprudence

8. Religious supervision to parents or Ihtisab – the rules and ethics Dr. Sedat Islami, Kosovo

Abstract

'Commanding the good and forbidding the evil' is one of the most important religious institutions. It ensures the implementation of the law of God in society and the preservation of the latter by any negative phenomena. Because of this importance it has, it is described in the *Qur'an* (9:71) as an obligation that derives from religious brotherhood. Because of having such a status, it is regulated as an institution with the relevant rules and ethics in order to prevent any case of its wrong manifestation, which may have ramifications. Commanding the good and forbidding the evil continued as a state and social organ for centuries. Over time, deficient perceptions in this respect, as an institution, philosophy and worldview, have led to its erroneous application. There have been made errors - inter alia - in relation to parents. This paper aims to represent the aspects where it was wrongly applied regarding the parents and what are the religiously adopted forms for its application in relation to them.

Sociology

9. For religion and homeland: Muslim clergy arguments in the debate on the modernization of Albania in 20-30 the years of the past century

Dr. Enis Sulstarova, Tirana University

Abstract

During the years 20-30 of last century Albania was officially a secular country, but in practice the State, acting as an agent of national unity, aimed to put under its control the organization of the religious sphere and activities. The country's political elite in the name of modernization and Occidentalism sought especially to reform the organization and practices of the Muslim community, as the largest in the country. Even some secular intellectuals labeled Islam as an "Oriental" religion which was alien to the Albanian soul and modern European civilization. Muslim clerics, generally accepting the need of reforming the organization and some of their religious practices, yet reacted to those arguments that they considered as unfair and wrong. Through reference to certain texts of the main Muslim clerics of the time, this paper will present some aspects provided by them on the compatibility of Islam with modern national state. These aspects were: (1) Muslim clergy has contributed to the national movement; (2) Islam is not against the nation and national unity; (3) Islam is not against modern civilization and science; and (4) Islam protects Albanian nation against disruptive effects of communism. In the XXI century - although the context has changed - some of the abovementioned argumental aspects tend to reverse in the Albanian public debate, in response to considering Islam as "the other" of the West and as alienated to the Albanian national identity.

Personalities

10. Sheuqet Muka (1887-1967)

Abstract

Sheuqet Muka was an ardent patriot and for him, homeland was above everything. The political line he was preaching was for unity and brotherhood - as a single body – for we primarily are all Albanians of the same blood and language.

He neither had a formal religious education, nor performed clerical functional tasks; he didn't serve at institutions of worship and hadn't any religious garment, however, it was formed as a Muslim intellectual, tireless missionary of Islam.

His contribution to the benefit of Islam in those conditions and circumstances is rare, big, efficient and versatile, because he was a source of Islamic knowledge and education, instruction and culture.

In all his activity in benefit of religion, he kept always in mind the interfaith cooperation, education for coexistence, peace, harmony and friendship among believers of the three religions. In all his writings, lectures and conversations of different thematic Sheuqet Muka always had in mind a combination of religious and patriotic aspects and vice versa.

Retrospective

11. Why the knowledge researchers form the majority of those who doubt and hesitate in religious matters?

H. Ismet Dibra

Abstract

The idea of the abovementioned phrase causes a disturbance in the pure faith of some smart people. In fact, in the largest part of those who study knowledge one can find people who are suspicious and reluctant in religious matters and who insult the religion or furthermore, a part that openly declare their own atheism and who mocks religious people. These kinds of people are mostly found among school students, especially among those who study in Europe. Attacking of this category has gone so far as to attack the sacred objects of their parents to disseminate doubts. The effect of this situation - except elite which knows to appreciate the value of science and knowledge - has led to a belief in the public that science and knowledge allegedly corrupt religion, propagate atheism and turn people into atheists.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.